



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës
Nr. 001-060-86443
Më: 20 korrik 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 paragrafit 1 dhe nenit 35 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras mbledhjen e VI/2026 (e gjashtë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më: **30 korrik 2026 (e enjte)**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 10:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 30 prill 2026 (e rregullt) dhe 02 qershor 2026 (e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërtimin e Bibliotekës Komunale të Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit për fshatin Zym i Hasit;
7. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2026;
8. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026;
9. Raport i punës së Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) për periudhën janar-qershor 2026;
10. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit për vitin 2025 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2025;



Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Skupština Opštine Prizren
Br. 001-060-86443
Dana: 20 jul 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 43 Zakona br. 04/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, člana 30 stav 1 i člana 35 stav 2, Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dt. 15 oktobra 2008 godine, sazivam VI/2026 (šestu) redovnu sednicu Skupštine opštine Prizren, koja će se održati **30 jula 2026 (četvrtak)**, u sali za sastanke Skupštine opštine Prizren, u "Beloj Kući", sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga ste pozvani da u svojstvu odbornika Skupštine opštine učestvujete u radu ove sednice pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ove sednice predlažem sljedeći:

DNEVNI RED

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa redovne sjednice od dana 30 april 2026 (redovne) i 02 jun 2026 (redovne);
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Pitanja odbornika;
4. Razmatranje i usvajanje prijedloga odluke o imenovanju Opštinske biblioteke Prizren;
5. Razmatranje i usvajanje prijedloga odluke o imenovanju članova Saveta za kulturnu baštinu Historijskog centra Prizrena;
6. Razmatranje i usvajanje prijedloga odluke o osnivanju i imenovanju članova Saveta za selo Zym i Hasit;
7. Izvještaj o radu gradonačelnika za period januar-juni 2026 godine;
8. Finansijski izvještaj za period januar-juni 2026 godine;
9. Izvještaj o radu Opštinskog direktorijata za obrazovanje (ODO) za period januar-juni 2026 godine;
10. Diskusija o izvještaju Nacionalne revizorske kancelarije (NRK) o godišnjim finansijskim izvještajima Opštine Prizren za 2025 godinu i akcionom planu za implementaciju preporuka za 2025 godinu;



Predsjedavajući Skupštine
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediye Meclisi
No. 001-060-86443
Tarih: 20 Temmuz 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Yerel Özyönetim Kanun'un 43.maddesi, 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 30. Maddesi, 1. Fıkrası, 35. Maddesi, 2. Fıkrası gereğince **30 Temmuz 2026 tarihinde (Perşembe günü)** saat **10.00'dan** başlayarak **"Beyaz Evde"** Prizren Belediye Meclisi oturum salonunda düzenlenecek olan Prizren Belediye Meclisinin VI./2026 (altıncı) düzenli oturumunu çağırıyorum. Belediye Meclisi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmaları için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz:

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir:

GÜNDEM

1. 30 Nisan 2026 (düzenli) ve 02 Haziran 2026 (düzenli) toplantıların tutanaklarının görüşülmesi ve onaylanması;
2. Gündemin görüşülmesi ve onaylanması;
3. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların dile getirilmesi;
4. Prizren Belediye Kütüphanesinin adlandırılması ile ilgili öneri – kararın görüşülmesi ve onaylanması;
5. Prizren Tarihi Merkezin Kültürel Miras Kurul üyelerinin atanmasına ilişkin öneri-kararın görüşülmesi ve onaylanması;
6. Zym i Hasit köy Kurul üyelerinin oluşturulması ve adlandırılması için öneri-kararın görüşülmesi ve onaylanması;
7. 2026 Ocak –Haziran dönemine ilişkin Belediye Başkan'ın çalışma raporu;
8. 2026 Ocak –Haziran dönemine ilişkin mali rapor;
9. 2026 Ocak –Haziran dönemine ilişkin Belediye Eğitim Müdürlüğü'nün (BEM) çalışma raporu;
10. Prizren Belediyesi'nin 2025 yılına ait yıllık mali tablolarına ilişkin Ulusal Denetleme Ofisi (UDO) raporu ve 2025 yılı için önerilerin uygulanmasına yönelik eylem planı hakkında tartışma.



Meclis Başkanı
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katër e Rregullt e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Datë: 30 prill 2026.

Filloi në ora: 10:00.

Vendi: Salla për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në “Shtëpinë e Bardhë” - Prizren.

Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë të Kuvendit të Komunës: Simir Krasniqi – Kryesues, Adem Shabanaj, Adrit Krasniqi, Agim Muqaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj, Alban Bislimaj, Albulena Balaj Halimaj, Arianit Berisha, Astrit Temaj, Dafina Alishani, Daut Panikaj, Dea Gavazaj, Drita Qenaj, Driton Sallauka, Dzengis Saliji, Eldis Abazi, Endrit Zogaj, Haziz Hodaj, Ilir Gashi, Liridona Veçgishti, Mergiton Gavazaj, Mimoza Memaj, Nazife Kokollari, Onur Kovaçi, Petrit Hoxhaj, Qemal Krasniqi, Sefidin Islamaj, Selman Sokolaj, Sevil Kazazi, Sevilay Igci Hapçi, Shqipe Shatri Çoçaj, Shukri Quni, Sulltan Badalli, Tefik Tarashaj, Trëndelina Kastrati, Ymran Fusha, Zgjim Kryeziu, Zikreta Aliti.

Munguan: Karanfil Haxhillari dhe Nerimane Pllana Gashi.

Pjesëmarrës të tjerë ishin: Nënkryetari i Komunës z.Bexhat Bytyqi, drejtorët e Drejtorive komunale, zyrtarë komunal, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Simir Krasniqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përshëndetje të nderuar anëtarë të kuvendit, i nderuar nënkryetar i komunës zoti Behxhat Bytyqi, e nderuara zëvendëskryesues, të nderuar drejtorë të ekzekutivit, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile dhe ju të pranishëm, përshëndetje për të gjithë. Para se të fillojmë me këtë seancë kisha kërkuar nga të gjithë një minutë heshtje për ndarjen nga jeta të ish-kryetarit të OVL UÇK-së dhe komandantit të UÇK-së Selim Krasniqi. Gjithashtu edhe ndarjen nga jeta të punëtorit shumëvjeçar Bashkim Krasniqi dhe ish ushtarit të UÇK-së. Kërkoj një minutë heshtje nga të gjithë. Lavdi jetës dhe veprës.

Për sot është thirrur mbledhja e (4) katërt e rregullt e Kuvendit të Komunës. Konfirmoj se të pranishëm jemi 35 anëtarë të Kuvendit dhe konstatoj se kemi kuorumin e nevojshëm për të filluar punën e kësaj mbledhje. Para se të filloj me leximin e rendit të ditës që parashihet për këtë seancë, dua t'ju informoj se projekti Demos në vazhdimësi ka ofruar përkrahje për kuvendarët komunal me qëllim të forcimit, për rolin e tyre përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës. Projekti Demos planifikon të vazhdojë me monitorimin e anëtarëve të kuvendit komunal në të gjithë Republikën e Kosovës, duke u bazuar në një aktivitet të ngjajshëm të zbatuar gjatë vitit 2023-2024, periudha kohore maj 2023-shkurt 2024, ku janë identifikuar dhe nominuar anëtarët më aktiv të kuvendeve komunale në disa kategori. Për të vazhduar me këtë aktivitet, na nevojitet pëlqimi juaj kuvendar që t'ia konfirmojmë Demosit që a ta vazhdon përsëri. Duhet ta marrë pëlqimin e juaj që t'ia konfirmoj. E hedhim në votim që a jeni të pajtimit që ta vazhdojmë monitorimin e tyre. Po Dafina fjala për ju.

Dafina Alishani (LVV): Meqë me vlerësime nuk kemi qenë të kënaqur secili asamblesitë, sepse ka pasur një diskrepancë edhe vlerësimi nuk ka qenë adekuat. Ne mendojmë ose rekomandojmë Demosi këtë herë t'i monitorojë drejtorët sa po na kthejnë përgjigje. Sepse qytetarët po munden pak a shumë me i vlerësu kuvendarët edhe me i votu. Ta shohim sa po kemi përgjigje prej ekzekutivit mbasi paskan buxhet. Rekomandimi jonë është që monitorimi të bëhet me ekzekutiv.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Dafina, po ata e kanë në plan të punës që monitorimin e kuvendeve komunale, nuk e kanë ekzekutivin është e drejta juaj që ta konfirmoni a të, vazhdon me komunën e Prizrenit, me komuna të tjera veç që është konfirmuar që është duke vazhduar. Tash, ajo është çështje e tyre, unë nuk mund të përzihem në punën e tyre. Po fjala për ju, Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. A do të jetë forma si herën e kaluar? Do të thotë do të jenë në garë vetëm kuvendarët dhe jo shefët e grupit? A është ai format?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, e njëjta procedurë si herën e kaluar. Atëherë e hedhim në votim. Sa jemi për pra që për të vazhduar këtë aktivitet Demosi për monitorimin e kuvendarëve? 21 Për, kundër? 1 Nuk ka abstenim? 4 abstenim.

Dafina Alishani (LVV): Më fal, a është kjo pikë në rend të ditës që po hynë në votë?

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo, nuk është pikë po ata kanë lypur konfirmim nga ju. Unë duhet ta marr pëlqimin e juaj, nuk mund t'ia konfirmoj unë si kryesues. Për me qenë më transparent me gjithë kuvendarët që nesër ku të bëhet vlerësimi, ju të jeni të informuar që unë duhet t'ju informojnë në kuvendin komunal.

Dafina Alishani (LVV): Kryesues, e udhës është Demosi me i mbledh kuvendarët, me i marr komentet e kuvendarëve, meqë po dojnë me i monitoru kuvendarët, me i informu, sepse këtu kemi asambleistë që janë për herë të parë edhe nuk e dinë as çka është, çka përmban projekti, çka janë përgjegjësitë e projektit, ne nuk mundemi me votu diçka pa u informu, edhe nuk mundemi me votu jashtë rendit të ditës. Unë se di qysh po e merrni.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ky është veç një për pëlqim që t'ia konfirmojmë Demosit, të vazhdoj me projektin. Unë kam mund t'ia konfirmoj sikurse komuna të tjera, por me qenë më transparent që kur ta shihni vlerësimin të jeni të informuar në kuvend këtu. Nuk ka diçka të keqe, atëherë konfirmohet që të vazhdojë projekti i Demosit. Materialin ata ju sjellin për çdo detaj mund të kontaktoni me ta. Ju faleminderit.

Fillojmë me leximin e pikave të rendit të ditës që kemi përgatitur për ditën e sotme, të cilat pika të rendit të ditës janë shqyrtuar dhe rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa për seancën e rregullt për këtë mbledhje. Rendi i ditës është ky: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 26 shkurt, vazhduar me 27 shkurt 2026 dhe mbledhjes solemne të datës 05 mars 2026. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës, pyetje e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme, shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashfrytëzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026, shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban, shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001-011-25151 të datës 26.02.2026 për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2026, sipas kërkesës së MAPL-së. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit përzgjedhjes të drejtorisë Komunale të Arsimit, këtu bëhet fjalë për zgjedhjen e drejtorave dhe zëvendës drejtorave të shkollave të mesme dhe fillore. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2026, shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për transparencë 2026-2030 sipas kërkesës së MAPL-së. Në këtë seancë kemi edhe dy pika shtesë sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë që janë shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku nga KPF-ja është dhënë rekomandimi që këto dy pika të shqyrtohen dhe miratohen nga kuvendi në mbledhjen e sotme. Këto janë pikat e rendit të ditës. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale, stacioni i autobusave, shoqëria aksionare Prizren. Dhe pika tjetër, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike, kompania regjionale e mbeturinave Ekoregjoni, shoqëria aksionare Prizren. Materialet për këto dy pika i keni pranuar me kohë përmes emailit së bashku me rekomandimet e KPF-së dhe shkresën përcjellëse të Ministrisë së Ekonomisë. Po ashtu kemi edhe një pikë shtesë e cila duhet të hyjë sot në rend të ditës për shkak të rëndësisë urgjente. Është fjala për shqyrtimin dhe miratimin i propozim vendimit për formimin dhe caktimin e komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e Këshillit për trashëgiminë kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit. Ky komision përbëhet nga pesë anëtarë, tre anëtarë nga shoqëria civile dhe dy nga anëtarët e kuvendit. Ne kemi bërë kërkesë shoqërisë civile që të propozojë tre emra para dy muajve, kur e kemi miratuar vendimin për themelimin e Këshillit për trashëgiminë kulturore të qendrës historike të Prizrenit dhe iniciimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit. Mirëpo, në fillim vetëm një organizatë joqeveritare ka deleguar një anëtar dhe organizatat tjera nuk kanë pranuar që të vijnë dhe të

kontribojnë për të bërë përzgjedhjen e këshillit për arsye të ndryshme. Mirëpo pas kontakteve me organizata të ndryshme dhe me akterë të ndryshëm të shoqërisë civile, dje përmes e-mailit kemi pranuar edhe dy anëtarë të tjerë që dëshirojnë të bëhen pjesë e këtij komisioni. Meqë tani janë plotësuar kushtet dhe kemi tre anëtarë nga shoqëria civile, mendoj që duhet të jetë në rend dite kjo pikë për shkak që të bëjmë përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit sa më shpejt që është e mundur, sepse sipas informacioneve që kemi, ka shumë lëndë të pashqyrtuara për qendrën historike për shkak të kësaj vonese. Propozim vendimin dhe CV apo emailt me emrat e të dërguarve nga shoqëria civile do t'i merrnin në kopje fizike gjatë seancës së sotme.

Kalojmë pra tek procesverbalet.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 26 shkurt vazhduar me datën 27 shkurt 2026 dhe mbledhjes solemne të datës 5 mars 2026.

Dua t'ju sqaroj edhe këtë se ende nuk i kemi pranuar fjalimet e anëtarëve të komunitetit boshnjak nga zyra e përkthimeve, fjalimet e komunitetit turk i kemi pranuar. Në momentin që i pranojmë ato fjalimet, do t'ia bashkangjesim procesverbaleve. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth procesverbaleve, e hapim debatin. Atëherë, e hedhim në votim procesverbalet me fjalimet komuniteteve jo shumicë, kur t'i pranojmë ato. Sa anëtarë jemi të pranishëm? 36 anëtarë të kuvendit jemi të pranishëm. Kemi kuorum. Kush është për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 26 shkurt, vazhduar me datën 27 shkurt 2026 dhe mbledhjes solemne të datës 5 mars 2026. 34 Për. Kundër? 0. Abstenim? 1. Atëherë miratohen procesverbalet.

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

Ashtu siç u sqarova që kemi tre propozime shtesë për mbledhjen e sotme, për shkak të rëndësisë urgjente, këto propozime paraprakisht do të kalojnë në votim që të hyjnë si pika shtesë në rend të ditës në mbledhjen e sotme. A kemi ndonjë propozim tjetër? I lexova dy të aksionarëve dhe një për përzgjedhjen e komisionit. Po, fjala për ju Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Kryesues, këto dy pika të aksionarëve me sa e di unë kanë kaluar në KPF. Nuk ka nevojë me u votuar tash.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ka nevojë.

Dafina Alishani (LVV): Pse?

Simir Krasniqi (Kryesues): Ka nevojë që duhet të votohen edhe në Kuvend.

Dafina Alishani (LVV): Jo në rend dite kanë hyrë ato.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, KPF-ja i ka rekomanduar kuvendit edhe dy pika shtesë edhe këtë pikën për komisionin që sot e propozova ti propozojmë kuvendit dhe duhet të votohen këto të tri pika dhe në tërësi i gjithë rendi i ditës me këto pika tre pika shtesë duhet të votohen në kuvend nga kuvendarët.

Dafina Alishani (LVV): Pika e fundit për trashëgimi kulturore po, votohet në kuvend. Pika e tjera janë votuar në KPF-në, në rend dite janë. Nuk e di pse ka nevojë me bë kësi lloj votime dyfishta.

Simir Krasniqi (Kryesues): Duhet të votohet pra, janë rekomandimet e MAPL-së. Fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, përshëndetje nënkryetar, urime, inshallah të hec mbarë e mirë. Kryesues, për këto dy pika që i ceku edhe kolegja, unë nuk e di atëherë çfarë roli ka komiteti për politikë e financa kur ato votohen. Edhe megjithëse nuk i kam votuar unë ato, po i ka votuar komiteti për politikë e financa dhe kanë hyrë ato si rend dite. Ndërsa për pikën e tretë, unë e kisha thënë që kjo mos me hy sot, sepse material nuk na ka ardhur. Na duhet gjithnjë me i kundërshtu këto të cilat hyjnë ad-hoc në kuvend për rend dite, të cilat janë pika të papërgatitura. Ato të cilat i përgadisim ose edhe s'jam unë e kundra atyre, kur i voton komiteti, ato pika hyjnë në rendin e ditës. Andaj, pikën e tretë është mirë që kolegët mos ta pranojnë, sepse ku ka ndenjur deri tani le të rrinë edhe ta shohim kush janë ata persona që do t'i votojmë ne, edhe a ja vlen me i votu apo ndoshta dikush nuk pendohet pse e ka kryer një punë të cilën s'e ka lexuar fare materialin. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, po unë e thashë shumë mirë që ne, anëtarët nga Ojq-të i kemi pranuar dhe edhe për shkak të mos interes të tyre, ju është e drejta juaj që doni ta futni në rend ditë këtë pikë mirë, që nuk doni, ne s'kemi, do të thotë, e hedhim në votim, nuk i merr votat edhe vazhdojmë për seancën tjetër. Por edhe këto dy pikat që mos t'i fusim në rend dite, që këta duhet të futen në rend dite si pika të reja që nuk i është përcjellur materiali, materiali i është përcjellur këtyre me nëntë pika të rendit të ditës, plus tre pika dy që kanë qenë në KPF, i propozohen kuvendit votohen dhe si tërësi i gjithë rendi i ditës votohet edhe fillojmë me pikat me radhë si janë të renditura.

Atëherë, e hedhim në votim propozimin e parë shtesë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. Prizren, sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, që të hyjë në rend të ditës. 37 jemi prezent. Sa jemi për? 25 për. kundër? 11 kundër. abstenim? 0. Atëherë, kjo pikë pra futet në rendin e ditës.

E hedhim në votim propozimin e dytë shtesë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale Kompania Regjionale e Mbeturinave “Eko Regjioni” Sh.A. Prizren, sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, që të hyjë në rend të ditës. Konstatoj se të pranishëm jemi 37. Sa jemi për? 24 për. Kundër? 11 kundër. Abstenim. 0. Atëherë edhe kjo pikë futet në rendin e ditës.

E hedhim në votim propozimin e tretë shtesë të rendit të ditës. Shqyrtimin dhe miratimin i propozim-vendimit për formimin dhe caktimin e komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e Këshillit për trashëgiminë kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, që të hyjë në rend të ditës. 37 jemi prezent. Sa jemi për? 25 për. Kundër? 9 kundër. Abstenim? 1 abstenim. Atëherë edhe kjo pikë futet në rendin e ditës.

Atëherë e hedhim në votim rendin e ditës me pikat shtesë, si pika e 10, 11 dhe 12, në tërësi rendin e ditës. Konstatoj se të pranishëm jemi 37 anëtarë të kuvendit. Kush është për? 25 për. Kundër? 6 kundër. Abstenim. 0. Miratohet rendi i ditës me pikat shtesë, pikën e 10, 11 dhe 12.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 26 shkurt vazhduar më 27 shkurt 2026 dhe mbledhjes solemne të datës 05 mars 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.001-011-25151 të datës 26.02.2026 për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026, sipas kërkesës së MAPL-së;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës (DKA);
8. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit të veprimit për transparencë 2026-2030, sipas kërkesës së MAPL-së;
9. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2026;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. Prizren, sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale KRM “Eko Regjioni” Sh.A. Prizren, sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë;
12. Shqyrtimin dhe miratimin i propozim-vendimit për formimin dhe caktimin e komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e Këshillit për trashëgiminë kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit.

Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës,

Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.

E hapim debatin, kush do ta merr fjalën? Fjala për ju, shefi i grupit të LDK-së, zoti Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Përshëndetje për të gjithë. I kam dy-tre çështje që do t'i ngrisni këtu. Ato kanë të bëjnë me kërkesat, nevojat, por edhe vërejtjet nga qytetarët, kryesisht nga rajoni prej nga vij. Çështja e parë ka të bëjë në lidhje me një prockë në fshatin Randobravë, e cila ka muaj po dhe vite që është projektu, mirëpo me u realizu, nuk po realizohet. Unë e di çështjen e buxhetit, e di situata se qysh është. Mirëpo, banorët e kanë nevojë dhe si të tillë vazhdimisht po kërkojnë që kjo prockë të rregullohet në mes fshatit, sepse nga ujërat dhe nga vërshimet shumë familje po dëmtohen në amvisëri. Prandaj ju bëj thirrje, i nderuari drejtor, që të merrni parasysh ndërtimin e prockës në Randobravë, është urgjente ajo. Çështja e dytë ka të bëjë në lidhje me familjen Bytyqi të fshatit Zojz. Ajo familje është e ardhur në atë fshat nga një fshat i komunës së Malishevës para 50 vite. Mirëpo problemi ku qëndron? Është çështja sepse pas luftës ndryshimet kadastrale që kanë ndodhur të zonave kadastrale në mes fshatrave ajo familje ka mbetë në zonën kadastrale të Medvecit. Mirëpo ajo zakonisht, jo zakonisht por gjithmonë ka qenë familje që ka

jetuar në fshatin apo në vendbanimin e fshatit Zojz. Tash, ka shumë telashe në ndërrimin e dokumentacioneve që 50 vjet. Ai faktikisht figuron në zonë kadastrale të Medvecit, a janë banorë të fshatit Zojz. Kërkoj nga ju kryesues që personat kompetent në kuadër të komunës të merren me këtë çështje, sepse njerëzit vuajnë për dokumente. Ndryshimi i dokumenteve sepse ata nuk janë katër-pesë anëtarë, por janë mbi 50 anëtarë të cilët kanë probleme me dokumentacion. Dhe çështja e tretë ka të bëjë me pollazën apo kulmin e shkollës Brigada 125 në Medvecë. Drejtoreshë, nuk jeni fajtor ju sepse ai kulm është dëmtuar para dy-tri vite, po sidomos këtë vit tjegullat komplet thuajse gati janë shkatërruar. Dhe si të tilla uji po bjen brenda në shkollë. Kështu që ju kisha bërë thirrje mbas mundësive që keni të paktën bile një riparim që domethënë gjatë dimrit atë shkollë mos ta zë me atë pëllazë të dëmtuar. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Qemal, për ju fjala Shqipe Shatri.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit i nderuar kryesues, zotëri Krasniqi. Sot ju drejtohem drejtorisë së emergjencave dhe të sigurisë. I nderuar drejtor, zotëri Arifi. Ka rreth dy vite që kryetari i komunës zotëri Totaj ka nënshkruar një marrëveshje shumë të rëndësishme me Policinë e Kosovës lidhur me përcaktimin e lokacioneve për vendosjen e kamerave të sigurisë. Në këtë drejtim kërkoj nga Drejtoria e Emergjencave dhe Sigurisë që të planifikojë dhe të realizojë vendosjen e kamerave të sigurisë edhe në hyrje të rajonit të Hasit, përkatësisht në hyrje dhe dalje të fshatrave të këtij rajoni si dhe pranë shkollave. Vendosja e këtyre kamerave do të ndikoj drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të sigurisë dhe duke përfshirë parandalimin e vjedhjeve dhe veprave të tjera kriminale, identifikimin e tyre dhe akteve të tjera të jashtëligjshme. Po ashtu kjo do të kontribuojë edhe në rritjen e sigurisë në komunikacion. Faleminderit nëse e ke marrë në konsideratë. Në mungesë të drejtoreshës së kulturës, meqë kemi dhe nënkryetarin këtu i merr shënimet. E kam temën lidhur me bibliotekën e qytetit. Biblioteka e qytetit të Prizrenit me një histori që daton që nga viti 1513, përfaqëson një ndër institucionet më të rëndësishme kulturore dhe arsimore në vendin tonë. Deri vonë kjo bibliotekë ka funksionuar me orar të zgjatur nga ora 8:00 deri në orën 19:00, duke u shërbyer nxënësve, studentëve dhe qytetarëve. Megjithatë, me ardhjen e drejtoreshës në këtë detyrë, ndër vendimet e para ka qenë shkurtimi i orarit të punës deri në ora 16:00. I nderuar kryetar, ky ndryshim vërtet ndikon drejtpërdrejtë në mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës, veçanërisht për nxënësit dhe studentët, të cilët pas përfundimit të mësimet e kanë të pamundur ta përdorin atë. Prandaj kisha kërkuar sqarim nga drejtoresha lidhur me arsyet e këtij vendimi dhe njëkohësisht konsiderojmë të domosdoshëm rishikimin e tij me qëllim rikthimin e orarit të mëparshëm për funksionalitetin e plotë të bibliotekës. Ju faleminderit për vëmendje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit, zonja Shqipe. Fjalën e ka Mergiton Gavazaj.

Mergiton Gavazaj (LVV): Faleminderit kryesues. Sot kam një kërkesë që lidhet me fshatin Zhur dhe që ka të bëjë drejtpërdrejtë me kulturën dhe jetën rinore aty. Në Zhur shtëpia e Kulturës ka mbetur e mbyllur po më shumë se 10 vite. Një objekt i ndërtuar për qytetarë, rininë dhe aktivitetet kulturore. Sot është jashtë funksionit dhe i lënë në harresë. Gjithashtu në Zhur vepron edhe ansambli i valleve Emin Duraku, një aset i rëndësishëm kulturor që përfaqëson traditën dhe identitetin tonë. Sot ky ansambël nuk ka një hapësirë ku ta ushtrojë aktivitetin e vet. Prandaj është e papranueshme që një grup i tillë të lihet pa përkrahje komunale. Kjo nuk është vetëm çështje objekti, është çështje e mbështetjes së kulturës, e rinisë dhe identitetit tonë. Prandaj, kërkoj nga

drejtoria e kulturës që të na sqaroj qartë. A ekziston ndonjë plan konkret për hapjen dhe funksionalizimin e shtëpisë së kulturës? Dhe nëse po, kur pritet të ndodhë kjo dhe në çfarë faze është aktualisht? Po ashtu, kam edhe një çështje shumë të rëndësishme që lidhet me sigurinë e qytetarëve në fshatrat Vërmicë, Zhur, Vllashne dhe të gjithë fshatrat të tjerë përreth. Në vitin 2021 është bërë përrurimi i nën stacionit të njësisë së zjarrfikësve në Zhur. Pra, po flasim për një objekt që është prezantuar si i ndërtuar dhe i gatshëm për funksionim me të gjitha mjetet e nevojshme. Sot disa vite më pas kjo njësi nuk është funksionale. Prandaj kërkoj nga drejtoria e emergjencës, që të na sqaroj qartë. Pse kjo njësi ende nuk është funksionalizuar dhe ku ka mbetur procesi deri më tani? Po ashtu, kërkoj të dihet nëse ekziston një plan konkret për funksionalizimin e saj dhe në çfarë afati pritet të vihet në shërbim të qytetarëve? Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Mergiton. Fjalën e ka zoti Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. Përsëritet ekzekutiv, të nderuar koleg. Drejtor i shërbimeve publike, kam një kërkesë nga fshati Landovic. Qytetarët që kyçen në rrugën kryesore Gjakov-Prizren, kjo rrugë është shumë e rrezikshme dhe sjell shumë problematika në kyçje, në qasje për me ardhë në qytet, mundësisht të bëhet kyçja në atë rrugë me një nënkallim. Sigurisht që keni rastisur edhe ju me kyç në atë rrugë dhe e shihni se është rrugë shumë e rrezikshme. Një kërkesë tjetër shqetësuese dhe shumë e bezdisshme është bërë edhe rritja e lypsarëve tani qytetarë të huaj, shumica deklarohen si palestinez. Është mirë të merren masa që të mos bëhet e tepërt dhe penguese për të gjithë kalimtarët e rastit. Dua të përsëris një kërkesë nga seanca e kaluar. Tani po i drejtohem drejtorisë së inspektoriatit. Në lidhje me shumë hapësira brenda qytetit që po ja humbin pamjen dhe duken të pahijshme. Ju lutem të merrni masa që qoftë organizimet e bizneseve ose edhe hapësira të tjera, kryesisht përreth përgjatë hekurudhës, duken pamjet jo të mira, është mirë me marrë masa që ato hapësira të rregullohen, qofshin private ose edhe publike dhe t'i jepet një pamje tjetër qytetit. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Bajram. Fjala për ju Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (GUXO): Faleminderit kryesues të nderuar të pranishëm. Njëra ndër pyetjet që e kam edhe unë, është për drejtorinë e mirëqenies sociale, lidhur me çështjen e lypsarëve, të cilat veçse fliten se janë nga Palestina. A ka komuna e Prizrenit ose drejtoria e mirëqenies sociale, ndonjë informatë apo edhe organe të tjera të policisë se ku rrinë këto gjatë ditës, sepse këto janë vetëm gjatë kohës së mbrëmjes dalin dhe kryesisht janë nga galeria deri tek premium parki, janë në mënyrë të organizuar, grupe do të thotë në mënyrë të organizuar dhe shqetësimi i qytetarëve është se kur rrinë këta gjatë ditës, a kanë ndonjë strehimore dhe a kanë leje qëndrim që rrinë në Kosovë. Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë me drejtorinë e shërbimeve publike. Drejtor, është hera e tretë brenda këtij mandati që e bëj pyetjen rreth çështjes së rrugës Tahir Sinani apo rreth tregut Fatoni mbrapa. Ku është problemi që nuk është tu u bë, që nuk është shtruar rreth 150m rrugë? Me të vërtetë është bërë e pakaluar dhe banorët kanë pyetje të vazhdueshme se pse komuna nuk po rregullon këtë rrugë. Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë drejtor përsëri të shërbimeve publike. Banorët e fshatit Vllashne kërkojnë një pengesë në rrugë, veçse kemi bërë kërkesat në komunë për arsye sepse kamionët me pesha të rënda për çdo ditë janë duke kaluar në atë dhe ka filluar të bëhet edhe dëmtimi i asfaltit. E di që do të thoni që komuna nuk vendos pengesa në rrugë, mirëpo një pengesë veç është vendosur nga komuna në rrugën e Nashecit dhe banorët e shohin për çdo ditë, sepse në

rrugën Nashecit vendoset një pengesë, ndërsa në rrugën e Vljashnës nuk vendoset, kur rruga e Nashecit veç se është e dëmtume, rreth 30-40 prerje i ka, veç është e dëmtume kjo. Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë me drejtorinë e bujqësisë, por drejtori nuk qenka këtu, është nënkryetari dhe ish-drejtori i bujqësisë. Qytetarët të cilët dalin në Marash, janë të shqetësuar për disa pronarë të cilët dalin dhe i shëtisin kafshët e tyre, sidomos qentë në Marash. Janë të shqetësuar se a janë të vaksionuar këto qen? Dhe me sa di unë, më herët komuna e Prizrenit ka nxjerrë një vendim ku të gjithë pronarët që dalin dhe i shëtisin kafshët e tyre, të kenë me veti së paku librezën që është i vaksionuar kafsha e tyre dhe sidomos qentë të racës pitbullit që janë të kenë edhe maskën në kokë sepse vetë forma e këtij qeni do thotë e krijon një frikë sidomos tek fëmijët. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Agim Muqaj e ka fjalën.

Agim Muqaj (AAK): Faleminderit kryesues, përshëndetje ekzekutiv, kuvendarë të nderuar, qytetarë të nderuar. Kam një pyetje për kryetarin Totaj gjergjesisht edhe drejtorinë e financave. Është një shqetësim që ndër vite, kategoritë e dala prej luftës sidomos invalidë dhe familjet e dëshmorëve i kemi marrë të gjitha shërbimet ndaj kuvendit komunal. Mirëpo ajo çka është më e keqja është se jemi të ngarkuar me borxhe, ku sipas ligjit, disa taksa në nivel Kosovë janë të privilegjuar invalidë dhe familjet e dëshmorëve. Siç e thashë, shërbimet i kemi marrë ndër vite, thuajse 20 vite mirëpo borxhi është akumuluar. Desha të marr një përgjigje nga kryetari Totaj dhe gjegjësisht drejtori në ditët në vazhdim. A jemi të liruar apo s'jemi të liruar? Së paku ta dimë që mos të ngarkohemi me borxh sepse gjithë këta shokë, edhe në kohë kur kam udhëhequr vetë me kategoritë e dala prej luftës, i kam njoftuar se nga kjo taksë jemi të liruar nga kuvendi komunal. Kështu që kanë kaluar shumë vite shërbimet i kemi marrë, faleminderit nga çdo qeverisje, mirëpo borxhi është akumuluar. Kështu që kisha dashur një përgjigje të saktë, në qoftë se jemi të liruar, të bëhet shlyerja e atij borxhi deri më tash, apo do t'i kryej secili në mënyrë personale obligimin që e kanë ndaj këtij digasteri dhe të vazhdojnë të paguajnë, ama s'paku ta dimë që nuk jemi të liruar. Kurse për drejtorinë e inspektoriatit, kam një shqetësim për banorët e fshatit Lubizhdë e qytetit, gjegjësisht të xhamia e vjetër, kur një shtyllë elektrike thuaja se është e rrëzuar dhe kisha kërkuar që në mënyrë urgjente në bashkëpunim me policinë, që të merrni edhe bashkëpunim me Kekun, që ajo shtyllë aty së pari njëherë të izohet vendi dhe urgjentisht të bëhet riparimi i asaj shtylle të ngritet dhe të sigurohet, sepse me të vërtetë janë në gjendje rrezikut të jetës. Faleminderit. Për kryetarin Totaj dhe drejtorin e mjekësisë, në organizatën Kosova Med të cilën e ka pasur të lidhur një kontratë së fundmi, pak e kanë përmirësuar gjendjen do thotë në kohët e fundit kishin qenë duke pa paga do thotë mbi tre muj ditë, kisha dashur që kjo gjendje të sanohet që mos të përsëritet që ata punëtorë që të kalojnë tre muj ditë pa paga siç kanë kaluar 3 muaj ditë deri tash. Drejtori i nderuar Islam Ukimeri, faleminderit që je këtu. Kisha kërkuar edhe kam thënë edhe disa herë më herët, besoj që të gjithë pajtohem me këtë se kemi shumë kompani dhe firma të cilët i marrin punimet për t'i kryer dhe me të vërtetë nganjëherë e bëjnë gjendjen më keq se që ka qenë. Sidomos të prerjet e asfalteve, ndoshta edhe ti vetë je për çdo ditë duke kaluar në rrugën ku kaloj unë dhe shumë qytetarë në pjesën e Jaglenicës e keni vërejtur edhe vetë se prerja e asfaltit dhe ajo rrugë më nuk po kthehet në vendin e duhur dhe sigurisht se shumë qytetarë kanë dëmtime në makinat e tyre edhe kisha dashur përveç se aty, kudo që të punohet në prerje të asfaltit apo kanalizime të caktuara, që të merren masa të rrepta dhe rigorozë për firma të cilat i punojnë ato, që t'i ndëshkoni besa-besa dhe me pagesat në afate të caktuara, por me të vërtetë është pa përgjegjësi dhe shumë

qytetarë janë të zhgënjyer. I nderuar drejtori Islam Ukimeri kam edhe një shqetësim tjetër. Ky sigurisht që lidhet me vendbanimin tim dhe tëndin. Kam kërkuar edhe gjatë mandatit të kaluar për një trafo në lagjen e Drumit të vjetër, e dini edhe vetë se është me të vërtetë stërngarkuar dhe shpeshherë jemi edhe pa rrymë në atë lagje, kisha kërkuar dhe kanë shprehur disa banorë aty pari më herët është cek se ka problem me pronën. Ka hapësirë dhe pronë e cila do të lirohet, në bashkëpunim me ju, kishim dashur ta zgjidhim këtë problem. Tu kisha lutur edhe shqetësimin tjetër, e dini edhe vetë që gjatë sezonës së verës, banorët e fshatit Korishë kemi probleme të mëdha të ujit. Kam kërkuar disa herë një buxheti cili është i potencuar, që mendoj se do të jetë edhe i mjaftueshëm. Mendoj se nuk është shumë ajo tepër e madhe që nuk mund ta mbulon komuna që ta zgjidhni problemin e banorëve, ku edhe gjatë verës shtohet edhe dyfishi i banorëve të fshatit, kur vijnë edhe mërgimtarët. Një shumë 200.000 euro mendoj se nuk është shumë e madhe dhe mendoj që për një dekadë apo së paku 20 vite për banorët e fshatit Korishë do të jetë që zgjidhja ideale. Në bazë të gjithë ekspertëve, të cilët kanë bashkëpunuar dhe kanë ndërvepruar, na kanë garantuar që me atë sasi të mjeteve, kur isha për së paku 10 deri në 20 vite bën zgjidhjen e problemeve të ujit. Kisha dashur mundësisht në rast se ka mundësi që kjo punë në qoftë se dedikohen mjetet mund të rregullohet edhe para sezonës së verës. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues. Kam një kërkesë për drejtorin e shërbimeve publike. Drejtor, ngecja dhe mos kryerja e punimeve në infrastrukturë në fshatin Nashec, punimet kanë filluar diku mbi tri vite dhe nuk janë kryer ende. Po ashtu është edhe ndriçimi në fshatin Nashec që ka filluar edhe ai mbi tri vite dhe nuk është kryer domethënë përfundimisht, disa lagje janë kryer ndërsa disa lagje të tjera janë ende pa ndriçim. Rruga që lidh fshatin Nashec dhe Tupec është dëmtuar shumë një pjesë diku nga 900 m është me kubëza. Kërkoj që ose të shtrohet me asfalt edhe kjo pjesë pasi që lidh dy fshatra, është fjala Nashec edhe Tupec, mirë është me u shtrur edhe kjo pjesë se gjysma është me asfalt edhe gjysma me u shtrur kishte qenë më mirë me asfalt. Po ashtu kërkoj edhe nga rruga domethënë është fjala që shkon deri te ura e Nashecit dhe vazhdon për Kojush e Mazrek, po deri te ura e Nashecit është dëmtuar asfalti, është vetëm një shtresë edhe aty kërkoj që t'i shtohet edhe një shtresë domethënë t'i shtrohet edhe një shtresë me asfalt kësaj rruge, sepse është dëmtuar jashtëzakonisht. Kam një rikërkesë, i kam bërë edhe ish-drejtorit Çel Lamaj, është fjala për fshatin Mazrek edhe Kojushë, atje ekziston një gurrë, të cilën janë furnizuar fshati Mazrek, Kojushë dhe lagjia Duraj. Ata kanë një bazen aty, rezervuar të ujit, por ai është dëmtuar jashtëzakonisht edhe nuk funksionon. Kanë kërkuar që ose të ndërtohet një bazen i ri apo rezervuar i ujit i ri, ose të riparohet ai rezervuar sepse ka vlerë jashtëzakonisht të madhe. Uji aty vjen me ramje të lirë domethënë është shumë një punë e mirë në rast se e kryeni një rezervuar të ujit në fshatin te Gurra e Mazrekut pra në fshatin Mazrek. Kërkoj drejtor që të vendosen pengesa para shkollës fillore të fshatit Nashec. E ceku dhe kolegu më herët po nuk janë vendosur kolegë pengesat ku kam kërkuar unë para shkollës. Është rrugë kryqi aty dhe të vendosen pengesa për ndalimin e shpejtësisë nga shofer të pa pandërgjegjshëm. Drejtoria e turizmit rregullimi i shtratit të parkut te gurrat e Suzisë në Nashec. Edhe ky projekt që tri vjet u bë, u bë sikur ura fshejtë këto punimet, s'kanë mendjen me u krye. Drejtoria e Bujqësisë, se po më duket kaluan minutat, po i graj pak më shpejt. Drejtoria e Bujqësisë, kërkoj shtrimin e disa rrugëve fushore me zhavor në fshatin Nashec. Edhe një rregullimin e një prockë, diku nga 900m me vendos në betan atë prockën.

Drejtoria e Arsimit, kërkesë kanë banorët e lagjeve në Nashec që udhëtojnë fëmijët diku me një largësi mbi 3 km, eventualisht edhe katër deri në shkollë, domethënë ju siguru transporti. Tash nuk po di këtu kuj me ju drejtu, për riparimin, mirëmbajtjen edhe rregullimin e lapidarëve përmendorëve, cila drejtori merret? Kam dëshirë me na u përgjigj këtu parapara nesh. Se e kam bërë disa herë këtë kërkesë edhe prapë po e bëj, po e përsëris. Drejtoria e inspektoriatit. Nëse nuk më kuptoni, mirë është me i vendos ato të përkthimit. Drejtoreshë, a ka mundësi me u ndal ndërtimet në atë pjesë ka jam unë, ka shkoj për Nashec sepse e keni bërë, fushën e kanë mbushur krejt beton. As nuk kanë kanalizim, as nuk kanë rrugë, as nuk kanë rrymë, as nuk kanë ujë. Kanalizimet tash kanë filluar me na i hudhë, e kam bërë këtë ankesë edhe në drejtori, me i hudhë në rrugë. I merr me pompë prej atyne gropave edhe e gjuan në rrugë. Domethënë banorët i kanë fotografuar, ja u kanë dërguar, i kanë inçizuar, kurrëfarë masa nuk janë marrë. Aman ju lutem se na kërbulën prej asaj ere. Ju lutem.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit fjala për ju, Onur Kovaçi.

Onur Kovaçi (KDTP): Saygıdeğer prizrenliler, Sayın Meclis Başkanı, Belediye Başkan yardımcılarım, saygıdeğer müdürlerimiz, meclis üyesi arkadaşlarım ve basın mensupları hepinizi öncelikle saygıyla selamlıyorum.

Belediyemizin bu yıl bütçe konusunda yaşadığı sıkıntılar hepimizin malumu, umarım bu sorunların en kısa zamanda çözülerek vatandaşlarımıza en iyi şekilde hizmet etmeye devam edilir. Ancak bütçe sıkıntısından bağımsız olarak ben belediyemizin herhangi bir ek maliyet gerektirmeden yerine getirebileceği önemli bir yükümlülüğe dikkat çekmek istiyorum. Bilindiği üzere Türkçe Prizren’de resmi dil statüsüne sahiptir ve bu hak Diller Kanunu ve Diller Yasası ile ve Dillerin Kullanım Yasası ile güvence altına alınmıştır. Bu kapsamda Türkçemizin kamu kurumlarında, iletişimde, resmi belgelerde, başvurularda ve kurumsal adlandırmalarda diğer resmi dillerle eşit bir şekilde kullanılması yasal bir zorunluluktur. Diller Yasası çok nettir, birkaç maddeyi de kısaca özetlemek istiyorum 2. ve 4. maddelerde: “Resmi Diller Kamu kurumlarında eşit statüde kullanılmak zorundadır”; 7.maddede: “Vatandaşlar kamu kurumlarıyla resmi dillerden herhangi biriyle iletişim kurma hakkına sahiptir ve aynı dilde cevap alma hakkına sahiptir”; 8.maddede “Tüm resmi belgeler, formlar ve başvurular resmi dillerde erişebilir olmalıdır”; 4.6.maddede “Kamu kurumlarına ait tüm tabela ve işaretlerde resmi diller eşit şekilde yer almalı. Yazıların büyüklüğü, karakteri ve düzeni aynı olmalıdır. Bu Yasanın sadece birkaç maddesinin özetiydi. Bu konuyla ilgili somut örnekler vermek gerekirse, vatandaşlarımızdan aldığımız şikâyetler doğrultusunda bazı okullarımızda duyuru ve ilanların Türkçe dilinde hazırlanmaması, belediye hizmetlerini vatandaşlarımızın Türkçe başvuru yapmakta zorlanması ve Türkçe cevap verilmesi, Belediye başvuru formlarının Türkçe olmaması, dilekçe süreçlerinde Türkçe evrakların yeterince dikkate alınmaması gibi sorunlar vatandaşlarımız tarafından bizlere iletilmiştir. Bu durum açıkça Diller Yasasının kullanılmadığını ve Diller Yasasına aykırı durumlar olduğunu göstermektedir. Bunun yanı sıra tabelalarla ilgili konuda da çok kısa bir örnek vermek gerekirse “Xhemajli Berisha” Kültür Evi biliyorsunuz tadilattan çıktı ve tadilattan çıktıktan sonra tabelasında Türkçe ibareler yer almıyordu ancak KDTP resmi başvuruları sonucunda tabelaya Türkçe ibareler de eklendi ancak Diller Yasasına uygun olarak değil Türkçe ibareler normal ibarelerden daha küçük puntuyla yazılmıştı bu durum da Diller Yasasının 4.6.maddesine aykırıdır

çünkü Yasa dilin sadece varlığını değil eșitliğini de zorunlu kılmaktadır. Bu gibi bir sűrű  rneklerimiz vardır. Aynı sorunların űimdiden sonra da tadilattan olan  rneęin otobűs istasyonu baēta olmak űzere belediyeye baęlı dięer kurumlarda da yaēanmaması i in űimdiden gerekli  nlemlerin alınması bűyűk  nem taēıtmaktadır. Biz de Tűrk toplumunun Prizren Belediyesi temsilcileri olarak bu kapsamda ilgili eksikliklerin tek tek tespit edilerek Műdűrlűklerimize resmi yazıyla baēvurarak gerekli iēlemleri baēlatacaęız aynı zamanda mevcut eksikliklerin tespiti ve giderilmesi i in de bu sűrecin takip isi olacaęız. Bu durumda sayın műdűrlerimizden de son derece  nemli olan bu Yasanın kullanımı konusunda ivedilikle  alıēmalarını talep ediyorum. Buradan bir kez daha a ık a ifade etmek istiyorum bu bir tercih meselesi deęil bu bir Yasal zorunluluk ve bu zorunluluęun eksiksiz bir űekilde uygulanması da hepimizin ortak sorumluluęudur. Tűm Műdűrlerimizi ve ilgili birimleri Diller Yasasına tam uyum konusunda daha hassas ve sorumlu davranmaya davet ediyorum. Teēekkűr ederim

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala p r ju Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. N j ra nga   shtjet t  cil n do ta ngris ka t  b j  me sht pin  p r t  moshuar n  lagjen Dardania. Kryetari i komun s ka premtuar qysh n  shtator t  vitit 2024 q  kjo sht pi do t  p rurohet, mir po ende nuk ka ndodhur n j  gj  e till . N  2023- n  sht  rekrutuar stafi, dometh n  ka tre vite q  ky objekt ka staf, mir po nuk e ushtron funksionin. Dometh n  jan  jo n j  po 13 t  pun suar t  cil t marrin pag . Pyetja ime  sht  ku punojn  k ta persona edhe pse nuk po funksionalizohet sht pia p r t  moshuar n  lagjen Dardania. N j   shtje tjet r ka t  b j  me n j  k rkes  t  cil n kryetari i K shillit lokal t  fshatrave Mazrek, Kojush, Planej, Milaj, Gorozhup, me 26 shkurt k tij viti ja ka drejtuar drejtorit t  sh rbimeve publike. Mbase e kan  ngritur edhe t  tjer t, mbase jan  interesuar edhe banor t, edhe kryetari i k tyre fshatrave. Dashta me pyet n  at  k rkes  q  k rkohet rregullimi i infrastruktur s n  ato fshatra, duke p rfshir  edhe ndri imin. A e keni marr ? A keni n j  plan t  intervenimit apo a parashihni buxhet ose projekte p r me realizuar at  k rkes , apo ato k rkesa q  ju kan  ardh  n  em r t  bashk sis  s  k tyre fshatrave t  cilat i ceka m  lart. Kryetari i bashk sis  lokale t  fshatrave, Mazrek, Kujush, Planej, Milaj, Gorozhdup. P r shkak se tash shum  fshatra i kemi b r  bashk  n  n j  bashk si lokale. N j   shtje tjet r ka t  b j , jo pyetje p r drejtoresh n, mir po shum  prind, shum  arsimtar , madje madje edhe drejtor. Nuk e di pse nuk guxojn  me th n  publikisht, kan  ankesa t  m dh a p r humbjen e or ve m simore n  rajonin e Hasit. K shtu q , un  jo q  ta pyes drejtoresh n se nuk kam pasur gatishm ri p r me t  kthy p rgjigje sinqerisht se le m  me marr  masa. Mir po po ju drejtohem k shillave t  prind rve n  shkollat e Hasit sidomos, arsimtar ve, drejtor ve t  shkoll ve q  t  marrin masa p rmes ankesave, p rmes k rkeseve, p rmes formave t  ndryshme t  b jn  t  mundur q  t  ulin humbjen enorme t  or ve m simore n  rajonin e Hasit, t  cil t mbase tash me digjitalizimin q  do t  na b j  drejtoresha e kuptojm  n  koh  reale sa or  po humbin, se besoj edhe humbja e or ve aty do t  evidentohet. K shtu q  sinqerisht prap  po them e kam n j  k rkes  p r k shillat e prind rve, t  shkollave t  Hasit, q  t  jen  m  t  guximsh m, pasi q  po kan  guxim ato me mi drejtu mua me i ngrit k to, t  jen  m  t  guximsh m n  k rkesa ndaj drejtoris , p r shkak se n  fund t  fundit jan  humbje t  or ve edhe  mimin n  fund do ta paguajn  edhe prind rit mir po nx n sit, p r shkak se n j  or  humbur  sht  shum  se le m  me qindra t  tilla. Kryesues, n se e kujtojm  raportin e auditorit financiar t  auditorit t  Kosov s p r komun n e Prizrenit. Shohim q  aty ka vazhdimisht rekomandime t  ndryshme. K t   shtje po e ngris p r

shkak se kryetari i komunës nuk qenka këtu. Edhe vazhdimisht kryetari po thirret që përmbaruesi apo jo përmbaruesi, qeveria po thotë i ka marrë mjetet. Edhe shumë njerëz po habiten qysh qeveria mundet me i marrë mjetet. Profesionistët po habiten në naivitetin e kryetarit. Kështu që qeveria nuk merr mjete. Qeveria ekzekuton vendime të gjykatave edhe në këtë rast përmbarimore. Njërin nga rekomandimet raportit të auditorit, është rekomandimi numër 13 për vitin 2024 thotë, obligimet e papaguara kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin fondeve për të siguruar që obligimet financiare të kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditësh. Duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat e pagesave të faturave. Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk janë marrë vendime të nevojshme, konstaton auditori i përgjithshëm i Kosovës. Rekomandimi nuk ka filluar zbatimin. Kështu që edhe kryetari i komunës, edhe drejtori i financave, edhe drejtorët e koalicionit të LDK-së që kanë filluar me u anku për përmbaruesin, këta kanë qenë në dijeni para se me lidh koalicionin për dëmet e mëdha buxhetore që i ka shkaktuar Shaqir Totaj, duke hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë. Duhet ta gjejnë përgjigjen këtu. Domethënë auditori po i merr mjetet për shkak se komuna ka hyrë në obligime pa mbulesë edhe kryetari i komunës së Prizrenit ka hapur kodet të ndryshme buxhetore pa e siguruar paraprakisht financimin. Kështu që kjo nuk ka të bëjë fare me qeverinë në nivel qendror. Këto ishin kryesues. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Albulena Balaj Halimaj.

Albulena Balaj Halimaj (NISMA): Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar drejtor, të nderuar anëtar të kuvendit e shumë të respektuar qytetarë të Prizrenit. E di që shumë herë është ngritur kjo çështje për të cilën unë po dua me fol, edhe e di që është diskutuar, por megjithatë po e shoh të arsyeshme me bë një pyetje jo vetëm unë, por nëpërmjet qytetarëve po e bëj këtë pyetje, sepse atyre po u intereson. Është fjala për memorialin e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Arbanë. E di se është në agjendën e kryetarit Totaj për ta renovuar atë, por ajo që i intereson secilit qytetar aty edhe mua, besoj edhe juve, e sidomos familjeve të atyre dëshmorëve aty, është kur do të fillojnë punimet aty. Kur do të fillojë renovimi i memorialit të dëshmorëve në Arbanë. Për shkak se ata emra aty janë shlyer, ata emra e kanë krijuar historinë, këtë histori të cilën e ka Kosova dhe asnjë projekt tjetër nuk do të mund të investojë në të nëse ata emra nuk do të ekzistojnë. Prandaj e kemi shumë të rëndësishme. Është prioritet mbi prioritetin. Ne duhet t'i ndajmë prioritetet. Ne secili këtu e kemi obligim që të bëjmë presion pozitiv ndaj atyre të cilët mund ta realizojnë këtë projekt. Po e përsëris, e di se ka qenë premtimi i kryetarit e di se e ka në agjendë, por ata janë të interesuar ta dinë kur do të fillon ky renovim, kur do të fillojnë punimet. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Atëherë, diskutuesit tjerë? Po, Dafina Alishani fjala për ju.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Edhe pse është për të ardhur keq që kryetari nuk është këtu, është për të ardhur keq edhe që ju si kryesues nuk i informoni kuvendarët së paku prezencën e tij apo mosprezencën. Kur keni çështje për votim, zakonisht ka agjendë të ngjeshur ku na bëni sqarime, po është dashur së paku me na informu mungesën e tij, po sidoqë të jetë, kjo tregon edhe seriozitetin e kryesuesit edhe respektin e kryetarit për kuvendarët. Çështja e cila do t'i ngrisë është çështja e parkingut pas kuvendit komunal. Mendoj që duhet të trajtohet nga drejtoritë

përkatëse, sepse ka shumë vetura që janë jo funksionale dhe bllokojnë diku 10-15 vendparkingje pa nevojë. Aty ka edhe veturë të komunës, e cila ka muaj të tërë që qëndron aty i palëvizur dhe kjo shkakton pakënaqësi edhe për banorët. Ju bëj thirrje që të merreni me këtë çështje dhe të lirohen këto hapësira, sepse shumë nga qytetarët e shfrytëzojnë atë parking edhe meqë është pa pagesë, t'i lirojmë ato hapësira të uzurpuara. Po ashtu kam një shqetësim në lidhje me hapësirën pas tregut të gjelbërt, ku është vendosur një rampë është shndërruar një parking dhe inkasohen para aty. Unë kam pasur një konflikt verbal me një përgjegjës i cili thotë që është shfrytëzues. Po me sa e di unë, aty ajo pronë ka kontest gjyqësor me komunën edhe nuk mund dikush me ardhë aty edhe me inkasuar para pa u kry kontesti gjyqësor. Lus inspektoratin që të merr masa, por janë edhe disa parkingje të cilët domethënë shfrytëzohen, inkasojnë para, po me dijeninë tonë nuk kanë ndonjë kontratë me komunën. Mendoj që duhet ta bëni një kontrollim të gjithë qytetin dhe t'i shikoni këto parkingje, se tash është periudha e verës dhe të kemi me pas shumë vizitorë të cilët nuk e kanë informatën se a ka kontratë ose a është e uzurpuar ajo pronë. Pavarësisht reklamave tuaja në lidhje me punimet në Shadërvan, unë sot po flas në emër të disa banorëve që jetojnë në Shadërvan e të cilët nuk konsiderohen nga komunat që jetojnë aty. Punimet në rrugën Marin Barleti, pse janë ndaluar edhe ju kisha lut që të mundoheni me i përfundu para se t'ia filloj sezona verore, sepse veç tash ka filluar me u bë një rrugë unike ajo, qoftë me ndërtimet aty domethënë banim, këto objektet për trashëgimi kulturore që janë mbrojtur, qoftë edhe me rrugë. Ndoshta përshpejtimi i punimeve para verës do të ishte shumë e mirë edhe për secilin vizitor që vjen aty. Po ashtu rruga e Zita Bashota, në Shadrvan ka nevojë për punime dhe mirëmbajtje. Pra kërkesa konkrete e banorëve aty është që punimet duhet të zgjerohen edhe tek rrugët ku jetojnë njerëzit, jo vetëm në pjesë të caktuar të Shadrvanit. Zita Bashota edhe njëherë ta përsëris. E kam një çështje për drejtorinë e shëndetësisë edhe pse nuk është këtu, po kjo ka ardh një shqetësim nga banorët me informatën që e kemi marrë është që kryeshefja e mjekëve ka hapur barnatore afër QMF-së në Arbanë. Edhe shumë interesant që bash ajo QMF nuk po furnizohet me materiale. Domethënë QMF-të tjera nuk kanë probleme me ato materiale ku Arbana ka mungesë. Edhe sinjalizimi është që a mos kjo mungesa e furnizimit po bëhet e qëllimshëm në mënyrë që t'i shërbejë asaj baratore aty e cila i takon dikujt që ka ndikim në menaxhment edhe në kërkesa që bëhen për QMF. Ju kisha lut drejtorit që të mirret seriozisht me këtë çështje, se kjo është edhe keqpërdorim i detyrës për favore të veta personale. Bombolat e gazit në QKMF i ka kaluar afati dhe kjo paraqet rrezik për qytetarët. Ta paraprijmë fatkeqësinë e mundshme në institucionet tona, mos të bëhet vonë pastaj e të reagojmë pasi që ndodh diçka. Drejtoria e Shërbimeve Publike edhe pse u ngrit si shqetësim, por e kam për obligim prej banorëve të cilët më kanë kontaktuar, kjo prerja e asfaltit në Dardani, ka shumë ankesa edhe prej banorëve por edhe prej kalimtarëve aty. Pyetja për drejtorinë e mirëqenies sociale, drejtor qëndrimi ditor i pleqëve e cila gjendet në bashkësinë lokale tek vëllezërit Stavileci. A mundet dikush me na informu, çka është çështja e atij objekti? Domethënë, është bërë një investim edhe mbetet i mbyllur, a nuk ka kod buxhetor për staf, a kemi problem me e menaxhu atë hapësirë sepse është për të ardhur keq, bash përballë objektit të qëndrimit ditor ke plot pleq të cilët luajnë shah ose sorollatën aty në çajto, kurse e kanë vendin e mbyllur me çelës. A mundeni me na informu çka është problemi? Edhe pyetja ime e fundit është, nuk e di cila drejtori merret me këtë çështje, tregu i Qylhanit a ka kontratë për shfrytëzim? Nëse ka, sa vite është ajo kontratë dhe është valide, si dhe mirëmbajtja e këtij tregut përgjegjësi e kujt është? A ka plan komuna me bë ndonjë investim aty apo shfrytëzuesi i ka komplet obligimet për investime e mirëmbajtje në këtë treg? Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Dafina. Fjala për ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zotri kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. I kam disa çështje për drejtorinë e shërbimeve publike, për drejtorin zotëri Islam Ukimeri. Pyetja e parë në lidhje me Ekoregjionin. Disa herë gjatë seancave, po edhe gjatë mandatit të kaluar është ngritur kjo çështje. A do të bëhet së shpejti dislokimi i Ekoregjionit? Sepse e dini që tash fillon sezoni veror, i nxehti dhe kutërbimi i erës përshkakton shumë shqetësim te banorët. A ka ndonjë zgjidhje shpejt që mund të ndodh, që mund të presim, së paku largimi i kamionëve për bartjen e mbeturinave diku tjetër në ndonjë hapësirë tjetër? Çështja e varrezave që është stërzgatur jashtëzakonisht shumë. Tanimë të gjithë e dimë problemin që ballafaqohen qytetarët tek varrezat ekzistuese. Ne si komunë kemi përfunduar të gjitha procedurat. A janë gati? A kemi ndonjë datë të saktë kur mund të fillojnë procedurat e para të varimit në varrezat e reja në Landovic? Çështja tjetër ka të bëjë me qasjen me veturë në Shadërvan, për banorët që kanë leje për me qarkullu. A mund të bëhet ndryshimi i lëvizjes së mjeteve, jo nga ura e Arastës, po nga Qafa e kishës dhe pastaj kthesa e parë në djathtë e para te Hotel Tifani. Do të thotë ata që banojnë dhe kanë leje për vozitje në Shadërvan, Marin Baleti, Vajzat e Sulit, Berati, të gjitha këto rrugë, a mund të ndryshohet kahja e lëvizjes? Besoj edhe për banorët është shumë më e përshtatshme, por edhe për qytetarët bëhet shumë më pak pengesa nëse ndalojmë qarkullimi nga ura e Arastës. Dhe çështja e fundit, rrugët në lagjen Bajram Curi, në anën e majtë të lagjes Bajram Curi, në drejtim të Zhurit të rrethi i parë, ish-fabrika e Farmakosit, mos gabofsha beteja e Vrnit thirret rruga. Janë gati të pakalueshme nuk ka as kupëza as asfalt, janë të dëmtuara plotësisht. A mund të ndërhyhet, të rregullohen ato rrugë dhe të shtrohen me asfalt? Faleminderit për dëgjimin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Ilir. Fjala për ju Alban Bislimaj.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë kolegë kuvendar, drejtor, media, qytetarë. Dua ta ngrejë një shqetësim që mendoj është serioz në lidhje me Ekoregjionin, me mbeturinat të cilat mendoj që në qytet është gjendja e mirë dhe respekt për të gjithë punëtorët e Ekoregjionit që bëjnë një punë shumë të mirë në terren. Mirëpo mendoj që në shumë lagje edhe në fshatra fare nuk ka pastërti sa i përket hedhjes së mbeturinave nëpër rrugë. Domethënë gjithandë shohim kanaqe, shohim najllona rrugës dhe nuk ka ndonjë punëtor që e shoh ndonjëherë që del dhe i heq ata mbeturina përgjatë rrugës. Më ka ndodhur shpesh herë që ta kontaktoj Ekoregjionin dhe përgjigja e tyre ka qenë që nuk kemi punëtorë të mjaftueshëm për me rrit domethënë rrjetën e punëtorëve edhe nëpër fshatra. Prandaj kërkesa ime është shumë konkrete. Me këtë i drejtohem shërbimeve publike dhe menaxhmentit të ekoregjionit, që të bëjnë një vlerësim të gjendjes reale në terren dhe të rrit numrin e punëtorëve në mënyrë që të bëhet pastrimi i mbeturinave në gjithë regjionin e Prizrenit. Dua ta theksoj se kjo duhet të thotë që pastërtia nuk është fare në nivel, nuk do të them që nuk është fare në nivel. Problemi kryesor është se domethënë nuk ka punëtorë të mjaftueshëm për të jenë në nivel në të gjithë territorin e Prizrenit. Kështu që kjo është kërkesa ime, domethënë të analizohet mirë dhe të bëhet pastërtia në të gjithë territorin e Prizrenit dhe jo nëpër qendër të Prizrenit por edhe nëpër fshatra edhe lagje që mendoj nuk është gjendja e mirë. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Alban, fjala për ju Liridona Veçgishi.

Liridona Veçgishti (BDP): Përshëndetje kryesues, të nderuar ekzekutiv, ju kolegë asambleistë. Kërkesa ime e parë shkon për drejtoreshën e inspektoriateve. Drejtoreshë, kam një kërkesë për një banesë kolektive e cila gjendet në rrugën Ajdin Ramanaj, ku mbi 50 familje janë detyruar të dalin në banesat e tyre, e cila banesë akoma nuk e ka të finalizuar si ndërtim. Mungesa kryesore në atë bllok, në atë ndërtesë është se të gjitha ato familje jetojnë pa trafo elektrike, vetëm me dy orë matëse. Kërkoj nga ju që të dërgoni një ekip nga inspektoriat për ta parë çështjen dhe gjendjen nga afër të asaj ndërtese, e cila kishte me qenë mirë dhe është shumë urgjente për arsye derisa nuk është bërë vonë, se 50 familje jetojnë vetëm me dy aparat matës elektrik dhe për ta parë se në çfarë gjendje është uzurpuar prona e gjithë nga 14 familje sa e kanë dhënë atë ndërtim, për të bërë atë ndërtim, është uzurpuar prona e përbashkët nga investitori. Është shumë urgjente drejtoreshë. Faleminderit. Pyetja e dytë shkon për drejtoreshën e arsimit, e cila për momentin nuk është këtu. Në fshatin Zhur, është projekt për renovimin e shkollë, a mund të dimë se kur do të fillon renovimi dhe çka do të renovohet në atë shkollë? Në vitin 2025 kam qenë në projekt, kryesuesi ka qenë drejtor dhe kam qenë në projekt në vizita sistematike dhe mbi 70% të shkollave i kemi vizituar. Shkolla në fshatin Zhur është mjeruse! Ku neve si staf mjekësor, unë jam e lindur në atë fshat, kur kam shkuar në vizita, kolegët e mi më kanë thënë: ‘Donë, nuk e di se si mbahet mësimi në këtë shkollë’. Ajo shkollë këmbon një erë që është tmerr. Nuk e di, besoj që drejtoresha ka qenë, drejtoresha në fshatin Zhur i qet do postime, do lula të mbjellura. Para se t’i mbjell ata lula për të bërë foto për Facebook, duhet e para ta shoh gjendjen e në çfarë gjendje janë VC-të në atë shkollë. Në shkollë ku ka nxënës më së shumti, fshati më i madh që ka nxënës më së shumti. Është më se urgjente që të fillojë renovimin në atë shkollë por desha të di nga drejtoresha se çka do të bëhet renovim, se dhe para disa viteve është bërë renovimi, por prapë se prapë gjendja është tmerr në atë shkollë. Besoj që drejtoresha do të më përgjigjet për këtë gjë. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Atëherë që nuk ka diskutues të tjerë prej kuvendarëve, fjalën ia japim drejtorave që t’ju përgjigjen pra në pyetjet e juaja, të gjithë drejtorat një nga një. Fjala për ju, drejtori i shërbimeve publike, zoteri Islam Ukimeri.

Islam Ukimeri: Faleminderit kryesues, të nderuar drejtor, të nderuar asambleist, të nderuar qytetarët e Prizrenit. Pasi që kam shumë pyetje që më janë bërë nga asambleistë dhe dua me ato një mundësi që i kam dhe ato informatat që i kam, t’ju kthej përgjigje. Në ato përgjigje që s’i kam do t’i kthej me email. Pyetjes së parë më është bërë nga Qemali po s’qenka Qemali këtu për shkak të prockës në Randobravë është kontrata është e nënshkruar në Randobravë për implimentimin e asaj procke. Po për shkak që përmbaruesi i ka marrë dhe gjithë buxheti që ka qenë i paraparë për këtë vit, për atë prock, nuk kemi dhe jemi duke këqyr, duke shikuar mundësinë se çka duhet me bë, që së paku të intervenojmë, çka është më e rëndësishme në atë prock. Bajram Kastrati, është bërë pyetja në lidhje me kyçin e rrugës Landovic dhe është kërkuar një nënkalim. Ne do t’i qesim ekspertët tonë që i kemi në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ta shohim çfarë mundësie kemi dhe në qoftë se do të ketë mundësi, e di atë rrugë kam kaluar disa herë dhe disa herë e kemi diskutuar për atë çështjen e asaj rrugës nënkalimit dhe çdo mundësi që kemi do të intervenojmë çfarë hapësira do të ketë për nënkalim apo mbikalim, por besoj ta shohim edhe pak gjendja faktike si do e japë mundësinë. Po besoj që javën tjetër mbas festës, zyrtarët e drejtorisë shërbime publike dalin në teren dhe të konstatojnë gjendjen atje në atë në atë rrugë. Petrit Hoxhaj, rruga të Tahir Sinani mbrapa tregut Fatoni është dhënë kompanisë Urdhëresa për t’u shtruar me asfalt. Edhe pse ana

financiare se po më vjen disa herë me përsëritur anën financiare për shkak të marrjes së mjeteve të përmbaruesit. Nuk po dua me u arsyetu për shkak se kush është fajtor për çka janë marrë. A është qeveria, a është komuna, a është kontrata kolektive? Por ne për shkak anës financiare dhe operator për shkak që s'kemi mundur me ju bë kryerjen e obligimet që janë kryer, që janë kryer punimet. Jemi duke biseduar me kompanitë që të na kreditojnë, që t'i kryejmë se është shumë shumë e nevojshme ajo rrugë dhe besoj që do të kryhet edhe ajo rrugë se nuk është shumë e gjatë. E kemi biseduar edhe herët të tjera dhe besojmë që shumë shpejt do të intervenohet. Është kërkuar edhe një pengesë në rrugën e Vlashnjës. Ne sa i përket pengesave, kohët e fundit apo vitet e fundit nuk i kemi shtruar. Ne, jo vetëm në Vlashnjë, por në asnjë fshat edhe në qytet. Do të mundohemi të bëjmë shenjëzimin apo shenjat e komunikacionit që t'i edukojmë, por ne do nuk mundemi me i ndalur edhe me ato pengesat që qiten në tokë praktikisht. Në qoftë se bëhen pengesat në tokë. Po do ta shohim mundësinë me shenjat e shëndetësisë, sa kemi mundësi, shenjat e komunikacionit që t'i edukojmë së paku që mos të vozitem, se është shumë e vërtetë që ka edhe nxënës, edhe fëmijë, edhe banorë aty, edhe kalohen pesha të rënda, por ta shohim çfarë mundësie kemi ose ta shohim edhe me asfalt do të kemi mundësi ta bëjmë atë pjesë, ta bëjmë një farë barriere me asfalt, një pengesë së paku. Agim Muçaj, në lidhje me punimet që nuk po kryhen si duhet, Agim, ne i kemi menaxherët e kontratës dhe të gjitha ato punime që nuk kryhen nga operatorët sipas cilësisë dhe sipas kontratës, ne nuk i bëjmë pagesën atyre faturat. Dhe shumë herë i kemi detyruar operatorët që të kryejnë punimet edhe dy herë. Domethënë nuk kemi bë pagesë. Nuk u bë pranimi atyre punimeve dhe i kanë kthyer edhe njëherë i kanë punuar. PAGESA nuk bëhet në qoftë se kryhen punime sipas kontratës dhe marrëveshjes. Kemi hasur asnjë raste, është e vërtetë që kemi hasur, por nuk kemi bërë pagesë. Dhe se sa i përket trafës te duri i vjetër, është e vërtetë që edhe kryetari i komunës, edhe unë, po edhe ti, kemi kemi diskutuar sa i përket trafës që është mungesa edhe është tensioni shumë i ulët. Dhe unë me kryetarin personalisht kemi diskutuar me një ekip të Keds-it dhe na kanë premtuar këtu që dy vite që do të vjen, jo vetëm në Korishë por edhe në dy fshatra të tjerë, që është bërë kërkesa për tre fshatra që të bëhet një trafa e re. Edhe na kanë premtuar që këtë vit do ta bëjnë trafën për shkak se e kanë planifikuar investimet në pjesën faktikisht në komunën e Prizrenit, disa fshatra që këtë vit të bëjnë investimet, na kanë premtuar, por premtimet nuk e di sa do t'i mbajnë, se e dini se disa herë kanë shumë çështje atyre sa i përket largimeve, qoftë në një shtyllës elektrike e bëjnë me vite, por ne sa here e kemi takuar, kemi diskutuar çështjen e trafes në Korishë dhe dy fshatra tjera na kanë premtuar që këtë vit do ta rregullojnë. Besojmë dhe shpresojmë që do të kryhet ajo trafë që është shumë e nevojshme. Sa i përket ujit, ne kemi biseduar punën e ujit në Korishë, është se menaxhimi i ujit në Korishë nuk bëhet nga Hidroregjioni, por bëhet nga vetë qytetarët. Dhe në qoftë se nuk është nën kompetenca e Hidroregjionit, komuna e ka vështirë që të investojë në ato pjesë, sepse i përket anës së infrastrukturës. Do ta shohim mundësinë çfarë mundësi kemi dhe çfarë mundësi buxhetore faktikisht kemi dhe çfarë kosto do del, do dalim në teren do ta shohim dhe çfarë mundësie kemi do ta veprojmë aty. Edhe di që është shumë e nevojshme për ujë, se vetë vijë prej atij fshatit, por pak na pamundëson për shkak që nuk menaxhohet nga Hidroregjioni.

Agim Muçaj (AAK): Veç një sekond, një sekond se nuk do zgjatna. E dimë ne mirë menaxhimin e Hidroregjionit qysh vepron, ne sigurisht se në qoftë se dojmë me shkuar me Hidroregjion e kemi procedurën qysh lidhje e shkurtër e kryhet menjëherë. Nuk do të thotë se ne jemi të gjithë këtu dhe ndër vite kemi përcjellë që komuna në momente të caktuara për disa banorë, fshatra apo lagje të

caktuara ka bërë kësi lloj investime. Edhe mendoj se 200.000 euro për komunën pavarësisht nuk është ndonjë shumë e papërballueshme. Kjo që bëhet një zgjidhje që për Korishën për 10 deri në 20 vite të garantojë se do të jetë problem i zgjidhur. Kjo është ajo çka duhet. Kam biseduar me ekspertat, është kompania vetë, pikërisht Hidroregionin me ekspertat e vetë që janë të gatshëm ta marrin këtë punë dhe përgjegjësi për ta kry sepse nuk ka shumë punë. Komuna veç ka investu Islam për këtë punë e dimë në ndër vite, pikërisht qeverisja e hershme e PDK-së ka bërë investime aty dhe atë projekt duhet me e realizu deri në fund. Të lutem, faleminderit.

Islam Ukimeri: Do ta diskutojmë po edhe njëherë këtë çështjen e ujit të Korishtit. Shukri Quni sa i përket ngecjes punimit në Nashec po la Shukë. Për shkak të anës financiare, operatorët i kanë ndërprerë. Do ta shohim çfarë mundësie kemi për shkak të kërkesës që e patëm në rrugën Nashec-Tupec dhe në pjesën Nashec-Kojushë po te kjo pjesa Nashec-Tupec që është rruga e dëmtuar, ta shohim çfarë gjatësie ka për punë që do të ketë mundësi ndoshta të shtrohet me kubëza. Po edhe këtë pjesën që the Nashec-Kojushë në ato fshatra të tjerë, për asfalt, do ta shohim edhe atë, do dalim në terren, do ta konstatojmë çfarë kosto do na del, do të bisedojmë me operatorin dhe me kontratën e kornizës që e kemi, çfarë mundësie kemi që të vazhdojmë ta shtrojmë atë rrugë që është shumë e nevojshme. Nëse sa i përket ndriçimit, ne e kemi nënshkruar para nja dy muaj nëse s'gabofsha apo një muaj e gjysëm një kontratë të ndriçimit dhe e kemi parë shumë se në qytet shumë lagje dhe shumë pjesë të qytetit kanë filluar të përmirësohen ndriçimi dhe në momentin që të përfundon rregullimi i gjithë qytetit dhe lagjeve të qytetit, do të kalojmë në fshatra, të rregullojmë gjithë ndriçimin ku ka mungesë, domethënë ku ka çështje të riparimit është fjala dhe ndonjë mungesë të poçit elektrik. Më është bërë pyetja nga Shukri Quni dhe lidhja Mazrek-Kojushë është dëmtuar bazeni i ujit. Edhe aty të riparohet pastaj. Dhe aty do të dalim në terren, ta shohim çfarë mundësie e kemi dhe çdo mundësi që e kemi, veç të jemi shumë korrekt. Çështja është vetëm te ana financiare. Sa i përket intervenimit, e kemi shumë lehtë të intervenojmë dhe i kemi disa kontrata kornizë që mund të intervenojmë. Edhe nuk na merr kohë veç t'i kemi mjetet. Po ana e mjeteve e dini dhe vetë, a dini, mos ta arsyetojmë disa herë se po duhet me secilin asambleistë me arsyetuar çështjen financiare. Jeni shumë në ngjarje, nuk është që s'jeni ngjarje, por çdo mundësi që e kemi, besoni që do ta shtyjmë përpara. Selman Sokoli, kërkesa që është bërë në prej kryetarit të Bashkësisë këtyre fshatrave përreth Mazrek e të gjitha fshatrave të tjerë, unë do ta shqyrtoj atë kërkesë dhe do ta kthej përgjigjen dhe çfarë mundësie kemi që të intervenojmë ne në baze të atyre kërkesave të shohim me prioritet cila mundësi i ke, dhe të vazhdojmë t'i intervenojmë në ato, në bazë të kërkesave që është bërë, por çdo herë duke e parë mundësinë në shërbim dhe prioritetin se edhe kemi mundësi me i kryer sa më shpejt, mos me lënë kohë shumë të gjatë me u vonu. Dafina Alishani, rruga Marlin Barleti, po Dafina rruga do të vazhdohet është e nevojshme shumë për shkak të se tash vjen edhe fillon edhe sezona verore dhe na nevojitet ajo rrugë të jetë e rregulluar. Por sipas informacionit që mora Kisha ka bërë kërkesë po duhet paraprakisht të bëhet një izolim rreth murit të kishës dhe të vazhdohet. Ne kemi bërë kërkesë që ta kryejnë sa më shpejt atë izolim dhe të vazhdohet të përfundon ajo rrugë Marlin Barleti dhe kjo rruga tjetër që ke Zita Bashoti edhe ajo rrugë do të rregullohet se është edhe kërkesa jonë si drejtori që të kryhet sa më shpejt rruga Marlin Barleti. Sa i përket prerjes së asfaltit në Dardani, ka qenë një një leje që është dhënë nga drejtorja, një pëlqim nga Drejtorja e Shërbimeve Publike në kohë të mëhershme, po në mandatin e kaluar, po në fund të mandatit të kaluar. Unë të isha kanë drejtor po të betohem se kisha dhënë, bile goxha jam tensionuar për atë pëlqim që është dhënë. Dhe ajo kompani e HIP Kosova që ka

bërë shtrirjen e një kabllës nga Dardania deri në ITP. Po e ka marrë edhe këtë pjesën prej Bazhdarhanes përpjetë. Është e vërtetë që e ka prerë asfaltin, por në pëlqim është e specifikuar edhe e përcaktuar që në momentin që të përfundojnë punimet të kthehet në gjendjen e mëparshme. Dhe ne dy email i kemi shkruar dhe na ka premtuar që me datën 27 faktikisht para dy ditësh që do të filloj shtrimi me asfalt aty në prerje që janë bërë, në ato pjesë të dy-tre pumpave dhe të Dardania aty, të semaforat. Por mandej na ka kthyer një përgjigje që nuk po mund kompania për shkak të ngritjes e çmimit dhe ne kemi dhënë afat 50 ditë në qoftë se nuk intervenon ne me kompaninë tonë do ta rregullojmë dhe faturën do t'ia dërgojmë kompanisë që e ka marrë pëlqimin faktikisht kompanisë private. Ka qenë shumë dëmi i madh që u ka shkaktuar, jo dëmi në aspektin infrastrukturor por dëmi edhe të qytetarët ka pasur shumë ankesa dhe neve na kanë thirrur shumë dhe unë kam qenë shumë shumë i dhënë që sa më shpejt përfundon ajo rrugë për shkak që po ka shumë pengesa gjatë lëvizjes së rrugëve. Më është bërë pyetja e Ekoregjionit të dislokimit faktikisht nga ajo pjesë. Ne veç procedurat janë nisur në vitin e kaluar të vartet dhe procedurat jemi në pritje të një konfirmimit të lokacionit. Ne fillimisht kemi parë e kemi parë e kemi paraparë që të çohet ai Ekoregjioni faktikisht makineria e Ekoregjionit të shkojë në Tusuz, por për shkak që aty janë bërë janë bërë shumë ndërtime, është çerdhja, është një ambulantë dhe ne kemi ndryshuar lokacionin. Lokacioni do të jetë tash në, ku është të varreza ku është dhënë 50 e sa hektarë që kemi dhënë dhe jemi në diskutim që të ndahen së paku një hektar, komplet të çohet komplet makineria dhe edhe krypa që është për dimër, të bëhet në atë vend dhe komplet të bartet te pjesa ku është varreza, pra në rrugën e tranzitit, faktikisht para kështit të autostradës, ku janë varrezat e rrugës të Serbicës aty, do të kalohet aty. Jemi në pritje të ndarjes së parcellës për një hektar, një apo dy hektar, nuk jam i sigurt tash, dhe në momentin që të ndahet ajo, ne do t'i çojmë atje në atë pjesë, të largohen, se është shumë e nevojshme të largohen nga ajo pjesë ku janë sot përballë Elkosit faktikisht, ku është lokacioni i Ekoregjionit. Ndërsa sa i përket çështjes së varrezave, ne jemi shumë në përfundim dhe në pritje të përfundimit të infrastrukturës nga kompania. Tash me datë më mirë mos të them datë të saktë, por ne me mund edhe nesër do ta bëjmë e dimë problematikën e varrezave të qytetit qysh qëndron, për shkak që veç nuk ka hapësirë dhe janë duke varrosur varr mbi varr. Por besojmë që e kemi bërë presion edhe nga kompanisë t'i përfundojnë sa më shpejt punimet, infrastrukturën që i ka aty dhe të fillohet që të bëhet varrimi. Procedura nga ana jonë ka përfunduar të gjitha. Vetëm jemi duke pritur të përfundon çështja e infrastrukturës. Kemi bërë javën e kaluar një takim dhe na ka thënë që shumë shpejt dy apo tri javë do t'i përfundojnë. Në momentin që i përfundon çështja e infrastrukturës, të rregullimit të infrastrukturës në atë pjesë, do të fillohet menjëherë të bëhet edhe varrimi në atë pjesë, në varrezat e reja që janë në tranzit. Veturat në Shadervan. Po, ne veç jemi, e kemi, e dini, i keni parë të ura Kfor-it, janë vënë dy pistonat. Dhe e kemi diskutuar që rruga të hyhet nga Qafa kishës përpjetë ashtu siç e the dhe ti. Në momentin që përfundon ajo pjesë, edhe infrastruktura e rrugës, ne do të fillojmë faktikisht hyrja dhe dalja në Shadervan të bëhet nga pjesa nga Qafa Kishë, nga shkolla Muzikës, sikurse që e the ti, ashtu është edhe në plan të bëhet. Po mundohemi sa më shpejt të bëjmë që ta lëshojmë atë rrugë dhe të pistonat që i kemi poshtë, të na bëjmë ndërprerje që mos t'ju lëmë me hy. Ne kemi dhënë, unë kam pasur shumë kërkesa të për hyrje dhe dalje në Shadervan. Unë e kam njoftuar edhe policinë në Prizrenit në këtë rast dhe i kam thënë që vërtetimin që është lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike për hyrje dhe dalje nuk është dëshmi që duhet të parkohet. Ai vërtetimi ka dhe kriteret që secili që paiset me atë vërtim hyrje dhe dalje në Shadervan, duhet të ketë garazhin e vetë apo oborrin e vetë.

Por jo të parkojë në trotuar, ne i kemi njoftuar dhe jemi në fund të dhënies së këtyre pëlqimeve dhe do ta dërgojmë listën të gjitha ata që janë pajisur me hyrje e dalje në Shadrvan dhe të gjithë ata që do të identifikohen nga policia në trotuar do të gjobiten. Nuk vlen ai vërtetim për parking. Ai vërtetim është hyrje e dalje për të shkuar në shtëpi apo për biznese që e shfrytëzojnë për t'u furnizuar më mall. Por jo për t'u parkuar, jo vetëm Shadërvan, por në asnjë rrugë të Shadërvanit nuk lejohet të parkohet me atë vërtetim që e kemi lëshuar ne si drejtori. Ajo është vetëm për hyrje e dalje, nuk vlen për asgjë tjetër. Sa i përket pyetjes Bajram Curr, që është bërë te Beteja Vrinia. Është e pakalueshme, është e vërtetë, ne kemi filluar më herët me sa e dini, por na ka dalë një kontest pronësor dhe si duket jemi në prag të zgjidhjes së atij problemi dhe në atë pjesë, ne kemi mund me vazhduar edhe në pjesë të tjera, por në atë pjesë ku ka qëlluar është kontesti pronësor, e kemi lënë që të merren vesh dhe të na kthejnë që të vazhdohet përfundimi dhe komplet si rrugë, jo me të jetë në gjysmë, a mandej të fillohet edhe pjesa tjetër të rregullohet. Ta shohim deri ku kanë arritur me marrëveshjen, në momentin që e kanë përfunduar atë marrëveshjen në mes vetvetes, ne të fillojmë ta kryejmë atë rrugë, se është shumë e nevojshme. Alban Bislimaj. Paska shkuar më duket. Okej, me shkrim. Faleminderit shumë, besoj që të gjithëve në qoftë se dikujt s'e kam kthy, mund me më bë pyetje më vonë ose në ditë tjetër.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për përgjigjet që ju dhe. Fjala për ju drejtori i administratës, zoti Beqat Bytyqi.

Bexhat Bytyqi: Përshëndetje kryesues, të nderuar drejtor, asambleist, qytetarë të nderuar, media. Unë do t'i përgjigjem në pyetje të Shukri Qunit në lidhje me mirëmbajtjen e komplekseve memoriale. Këtë vit ka kaluar ky projekt te Drejtoria e Administratës, tek ne. Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet për tenderimin e këtij projekti dhe pas tenderimit do të vazhdojmë. Gjithashtu edhe për zonjën Balaj vlen kjo përgjigje që pas tenderimit pasi që ndonjë operator të lidhim kontratën, do të dalim në vendin e ngjarjes edhe do të shikojmë çka kemi mundësi me e rregullu. E di që komplekset memoriale nuk janë në gjendje të mirë, personalisht i kam parë janë në gjendje të mjerueshme edhe duhet të rregullohen. E di që është më se e nevojshme të rregullohen këto komplekse memoriale. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Fjala për ju drejtoresha e arsimit, Luljeta Veselaj Gutaj.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit shumë kryesues, të nderuar koleg drejtor, kuvendar, të nderuar media, qytetarë të Prizrenit. Thashë, dola në foltore sepse kur flas për Zhurin, kam shumë respekt për komunitetin e Zhurit, por dhe për kontributin që e ka dhënë Zhuri në kohrat më të vështirat, e aq më tepër kur flasim për shkollën. Më tregun kolegët, nuk isha e pranishme për shkak që më thirrën jashtë. Për pyetjen të cilën e keni parashtruar zonja Veçgishti lidhje me renovimin e shkollës apo? Ka qenë kështu? Nëse ka diçka me shtu edhe gaboj më plotësoni. Shkolla në fshatin Zhur është në renovim të tërësishëm dhe nga Drejtoria e Arsimit edhe nga Banka evropiane që është në kuadër të komunës një projekt për efikasitet dhe një pjesë do të jetë nga drejtoria e arsimit, veçse kanë filluar disa finesa, mirëpo gjatë procesit mësimor nuk mund të vazhdohet me renovime të tërësishme, do të shkohet pjesë pjesë dhe projekti është dy vjeçar. Do thotë besoj që brenda dy vjetëve gjithçka do të jetë e finalizuar sikur të ishte shkollë e re. E di që gjendja që nga fillimi ka qenë edhe më keq, ndër shkollat e para që unë e kam vizituar ka qenë shkolla e Zhurit dhe me të

vërtetë ajo ditë ka qenë shumë e keqe për mua në momentin kur kam hyrë në shkollë. Përveç gjendjes së tmerrshme, do të thotë objekti shumë të vjetër, përkundër faktit që Zhuri ka pasur edhe drejtor të arsimit me vite dhe nuk e ka dhënë asnjë kontribut, do të thotë ka qenë edhe gjendja e papastërtisë në nivelin më të lartë. Sot duke ju falenderuar të gjithëve që punojnë aty, prej drejtoreshës, mësimeve, punëtorëve teknik por më së shumti komunitetit të prindërve, të cilët e kanë dhënë një mbështetje të jashtëzakonshme dhe model edhe për shkollat e tjera për mbështetjen që i kanë dhënë edhe për sponsorizimet që i kanë bërë, është në gjendje më të mirë dhe është funksionale. Megjithatë, jemi kujdesë që shkolla të ketë renovim të tërësishëm. Sa i përket pyetjes zoti Quni faleminderit. Ju siç e dini dhe jeni në njohje, është udhëzimi administrativ që i përcakton pagesat e nxënësve, kërkesat të cilat janë për nxënësit që kanë mbi 4 km edhe që kanë nivel të rrezikshmërisë, sigurisht drejtoresha e shkollës i prezanton drejtori dhe ne asnjëherë nuk i kemi refuzuar dhe s'kemi të drejtë me i refuzuar do t'i mbështesim. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoresh. Fjala për ju drejtori i emergjencave, Sead Arifi.

Sead Arifi:

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor, fjala për ju drejtoresha e inspektoriatit.

Samra Iljazi:

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoresh, fjala për ju drejtori i ekonomisë dhe financave Levent Bus.

Levent Bus: Përgjigje për Baca Agimin une interesona dhe shikoj se ka dilemë për atë. Se edhe unë e lexova edhe pak ligjin edhe ankesat që kanë bërë. Kështu që besoj që gjatë javës e rregullojmë ato. Pyetja e Selman Sokolit se e kuptova për 2024 je duke folur, auditori i jashtëm që e ka rekomanduar neve, apo? E tashë jemi 2026. Kështu që prej 1 janari 2026 asnjë asnjë tender nuk u hap, deri sa s'ka pasur drejtorja mjete. Kështu që për 2026 muj me folur unë që asnjë tender nuk u hap. Drejtorja në qoftë se nuk ka mjete, kështu që për 2026 deri në sot edhe drejtorët janë duke ankuar, vetëm s'kemi çka me bë, gjendjen e kemi që kështu për momentin, për 2026. Inshallah rregullojmë përbashkë, edhe ju edhe ne se përmbaruesi deri në sot e kam marrë 14 milionë, prej mallra shumë i kemi 1.4 edhe 14 milionë, kështu që vjen përafërsisht që deri në 16-18 milionë mund të me shku sivjet. Po mendoj që unë sa po shoh deri në 22 milionë ka me shkuar me përmbaruesin.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues a bën veç që se më duket nuk e ke kuptuar mirë çfarë kanë ngritur. Nëse bëni një sqarim ... Auditori, raportet e auditorit janë për 2024-ën, për shkak se për 2025-ën vjen në qershor të 2026-ës. Unë e ceka që arsyeja pse komunës së Prizrenit po i merren mjetet financiare, nuk është vetëm kontrata kolektive, e kemi cekur disa herë këto. Është edhe keqplanifikimi edhe keqmenaxhimi i financave publike nga qeverisja e Partisë Demokratike të Kosovës. Një rekomandim ke rekomandimi numër 13, e citova auditorin. Rekomandimi numër 13, i përsëritur, i thotë komunës e Prizrenit që duhet t'i paguani faturat në kohë. Nëse faturat nuk paguhen në kohë, bizneset e çojnë rastin te përmbaruesi edhe përmbaruesi përmes vendimeve gjyqësore, jo të qeverisë, inkason mjetet në mënyrë të dhunshme. Quhet por është ligjore për shkak

se është vendim i gjykatës. Kështu që arsyeja thashë pse Prizreni është tu i pas këto probleme, është edhe njëra nga vendimet ose njëra nga pasqyrat financiare të auditorit. Kjo ke, nuk ka të bëjë me përgjigjen e juaj që më dha. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, drejtor. A ke replikë?

Levent Bus: Po besoj që unë e kam qenë edhe unë i qartë. 80% është prej kontrata kolektive 20 edhe ne i dimë që e kemi operatorëve borxhet që e kanë çu në përmbarues, ajo është përafërsisht 20 më shumë të 25%. Kështu që auditori i jashtëm që e ka, unë po mund me fol për 1 janar deri sot. Kështu që asnjë tender nuk u hap pa pas mjete. Se ju e keni cek që u hap. Faleminderit.

Selman Sokolaj (LVV): Thotë duhet të merrni masa edhe konstaton që nuk është zbatuar për vitin 2024. Ndërsa në qershor të vitit 2025, në rregull është ajo që po thoni ju. Në qershor të vitit 2026, mund ta konfirmojnë këtë që ju po e thoni drejtor. Drejtor, po besoj që jemi në rregull. Domethënë në qershor të vitit 2026, këtij viti mund ta konfirmojmë këtë që po thoni ju. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë pra me pikën e radhës. Drejtori i punës e mirëqenjes sociale që e patë pyetjen, tha, ju përcjell me shkrim. Edhe po besoj që të gjithë drejtorët i morët përgjigjet nga drejtorët. Kalojmë te pika e katërt e rendit të ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ftojme të prezantohet kjo pikë nga iniciuesi i pikës për rendin e ditës.

Dafina Alishani (LVV): Mbetet ju pa u përgjigj në pyetjen e kuvendarit prej komunitetit turk. Në raport me përdorimin e gjuhëve, meqë kemi këtu edhe përfaqësues të komunitetit turk, ish dasht pak edhe ju me marrë shumë seriozisht këtë shqetësim për të cilën disa herë e kanë ngritur. Çka është problemi i përdorimit? Ju si kryesues keni obligim direkt me ja kthyer përgjigjen.

Simir Krasniqi (Kryesues): Do ta do ta merr përgjigjen, sa i përket kuvendit, gjithë materiali ju shkon me kohë, edhe për këtë do ta merr përgjigjen. Vazhdojmë pra me iniciuesin e pikës së rendit të ditës. Fjala për ju, Lulzim Sylejmani.

Lulzim Sylejmani: Faleminderit kryesues. Përshëndetje për juve, kuvendarët, drejtorët, media të pranishëm. Sigurt materialen e keni marrë dhe ky material ka kaluar edhe nëpër KPF. Nga mjetet e bartura janë vlera 1.671.873.59, nga kjo vlerë që bartet kemi një tejkallim të hyrave vetanake të vitit të kaluar rreth 960.000 euro dhe pjesa tjetër është të hyrat gjatë vitit 2025 të cilat janë të pashpenzuara dhe që barten për shpenzime në vitin 2026. Nga kjo shumë kemi planifikuar këtë shpërndarje. Në arsim në paga shkojnë 70.000 euro në sektorin, domethënë në sektorin fillor, 30.000 për paga shkojnë në sektorin e mesëm, mallra shërbime në Drejtorinë e Arsimit shkojnë 100.000, shërbime komunale shkojnë 100.000, në Drejtorinë e Financave në mallra shkojnë 121.873.59, në Drejtorinë e re të Tatimit në Pronë shkojnë 150.000 euro, te investimet kapitale janë 1.100.000 euro të shpërndarë në katër projekte, tri projekte i takojnë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe një projekt është në Drejtorinë e Financat që është projekt me donatorë, që i kemi disa

prej marrëveshjeve për investime me donatorë, siç janë efiquenca e energjisë nëpër shumë objekte të komunës, sidomos në shkolla. Në tabelën është prezantuar shpërndarja, domethënë sipas drejtorive dhe sipas kategorive të shpenzimeve, nëse ka ndonjë pyetje rreth këtij propozimi, jemi këtu, do t'ju përgjigjem dhe arsyetojmë këtë propozim. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Lulzim, mundeni me u ul aty edhe që ka në pyetje. Mirë, fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Thashë një pyetje të thjeshtë të ja bëj, te shpërndarja mjeteve. A është bërë drejtor, kjo shpërndarje në bazë të fuqive qysh e kanë të drejtuar atë fuqinë edhe forcën në ekzekutiv apo është bërë me të vërtetë sipas kërkesës siç e keni ndarë ju. Se po i shoh unë që vetëm disa drejtori që goxha janë të fortë, i keni ndarë ato mjete. Vetëm qetë deshta thjesht me bërë.

Levent Bus: Kështu. Si e dini, prej kapitaleve deri në sot përmbaruesi i ka marrë 11 milion. Prej 11 milion janë prej shërbimeve publike.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor, fjala për ju Dafina Alishanit, le të përgatitet zoti Islamaj.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit. Edhe unë deshta me bëni domethënë edhe pse në KPF e kam pyetur pse bashkë këto projekte, po ne gjatë KPF-së e pamë një reagim të drejtorit të shëndetësisë i cili u ankua që do të mbesim pa shërbime edhe pa materiale ku kjo rezikon edhe shëndetin e qytetarëve. Tash meqë kemi emergjencën, unë nuk po e kuptoj pse nuk ka bartje të mjeteve dhe te Drejtoria e Shëndetësisë. Ju jeni në koalicion me LDK-në. Po më vjen keq që duhet në emër të LDK-së me kërkua, me pas gjithëpërfshirje për LDK-në, po s'është halli i LDK-së, sa është halli që me i parapri sëmundjeve tek qytetarët të cilët pastaj do të jetë kosto edhe për buxhetin e komunës. Kjo ndasi kështu mes drejtorive, ju e keni bërë gjithmonë, tash po e bëni pak më të theksuar, ndoshta ka lidhje me forcën që e përmendi zotëri Shukri Quni. Po një çështje tjetër që dua ta theksoj, se ju shumë lehtë e keni kaluar raportin e auditorit këtu. Edhe nuk mundeni me thënë që vetëm domethënë kontrata kolektive ka bërë dëm në buxhetin e komunës. Ne këtu vazhdimisht në secilën seancë, ku është diskutu buxheti, ju kemi bërë thirrje që mos të futni kode buxhetore që nuk ka buxhet. Vetëm në tre raste ku është marrë mostra nga auditori, unë dua ta lexoj sepse këto nuk i keni diskutuar në seancë. Thotë në projektin ndërtimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afër kampusit universitar, ishte lidhur kontrata me datën 04.03.2024 në vlerë prej 2.199.000. Derisa fondet e buxhetuara në ligjin e buxhetit 2024 për tre vite ishin vetëm 200.000 euro. Tash ju, rasti tjetër, është ndërtimi i infrastrukturës në Korishë projekt dyvjeçar, është lidhur kontrata me datën 9.02.2024 në vlerë prej 1.4 milionë euro, derisa fondet e buxhetuara për tre vite ishin vetëm 400.000 euro. Domethënë për vitin 2024 100.000, vitin 2025 150.000 dhe vitin 2026 është 150.000. Me ligjin e buxhetit për vitin 2025 për këtë projekt ishin paraparë edhe 624.000 euro. Për projektin ndërtimi i infrastrukturës në Romajë, rrugë dhe ndriçim publik ishte lidhur kontrata me vlerë 336.000 euro, kurse ju i keni paraparë vetëm 60.000 euro. Hajde sivjet u bë ky problemi i kontratës, ju morën shumë shumë miliona. Po ju keni bërë planifikime, domethënë keni futur buxhetin në buxhet keni futur kode marramendëse, vetëm me ja bërë qejfin disa kuvendarëve dhe tash thuani që vallahi na kanë marrë. A mundeni njëherë me u ndalë qëto punimet që i keni bërë, me pas mundësi me trajtu. Ju po thuni nuk kena buxhet, ndërsa tash kemi këtu kod buxhetor

që po propozoni subvencionim. Ndërkohë, nënat lehona nuk po paguhen sivejt. A e keni hallin ju me menaxhu buxhetin si duhet apo e keni hallin vetëm aty ku ju konvenon me bë shpërndarje të parave, atyre kompanitë që keni raporte të mira me ja u pagu faturat, edhe ata drejtor të cilët i takojnë partisë politike të juaj, e ku keni fuqi me ja nda bartjen e mjeteve. Pse shëndetësia mbasi 2 milionë euro ju kanë marrë edhe e rrezikon komplet shëndetin e qytetarëve, pse bile ni 500.000 euro nuk ja ndajmë? Apo vetëm prioriteti i qeverisë Totaj është asfalti.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju zotëri Islamaj.

Sefidin Islamaj (BDP): Faleminderit zoti kryesues. Unë e kuptoj krejtësisht domosdoshmërinë e këtij vendimi, por kisha lut institucionet të jenë sa më transparente dhe të tregojnë qartë sa është niveli i borxheve, cilat raste kanë shkuar në përmbarim dhe çfarë është plani konkret për me dalë nga kjo situatë në të ardhmen? Meqënëse edhe drejtori kërkoi ndihmë nga ne kuvendarët. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju, Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (GUXO): Faleminderit kryesues. Me sa kemi lexuar, nuk është paraparë ndonjë bartje e mjeteve edhe në drejtori të cilat janë më emergjente. Është fjala dhe për drejtorinë e bujqësisë. Pse nuk është mbajtur ndonjë mjet edhe për këtë? Fermerët bashkë në kohën kur kanë më së shumti nevojë, do të thotë, bile së paku me ja u dhënë subvencionet e viteve të kaluar. Ashtu edhe nënat lehona janë duke i pritur mjetet të viteve të kaluar dhe nuk janë dhënë. Thjesht janë duke u dhënë, siç e tha dhe kolegja në bazë drejtorive më të fuqishme që janë dhe prej drejtorëve të koalicionit asnjë ndarje të mjeteve nuk ka. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Petrit, fjala për ju Selman Sokoli.

Selman Sokolaj (LVV): Problem shtesë i buxhetit të komunës së Prizrenit në këtë rast, për shkak që nuk po parashihet as në buxhet as në bartje, mund të jetë edhe siç e tha kolegja çështja e pagesës së lehonave apo fëmijëve që lindin në komunën e Prizrenit. Për shkak se siç e dini në fund të vitit 2023 ne e kemi nxjerrë një rregullore, e cila e parasheh qartë kushtet dhe kriteret e përfitimit të subvencioneve për fëmijë që lindin në komunën e Prizrenit dhe afatin e aplikimit. Ai afat është tre muaj. Domethënë në momentin që një fëmijë lind, deri në tre muaj ka afat të aplikoj. Nëse komuna e Prizrenit nuk ka parapa mjete për këtë kategori, unë kam parë veç prindërit kanë filluar edhe me bë kërkesa në komunën e Prizrenit, nëse kërkesa i refuzohet, në bazë të ligjit ata prapë mund t'ju drejtohen përmbaruesit. Domethënë vazhdimisht, nuk është e kaluar veç që po na shkakton probleme, por edhe e tashmja për shkak të vendimeve të gabuara. Ekonomistët mund ta dinë më mirë, mirëpo në ekonomi është ligji i radhësisë, resurset janë të rralla nuk ka pakufi asgjë. Edhe këto financa që i ka komuna e Prizrenit i menaxhon, i alokon në bazë të prioriteteve. Nuk mundesh me thënë po e zbatoj një projekt, kaq kam financa dhe nuk kam financa për shiringa në qendrat e mjekësisë familjare. Nuk kam financa për analiza elementare të cilat nuk po jepen edhe nuk kanë financa për shqetësimet e mëdha që i ngriti i ngriti drejtori i shëndetësisë. Pasi drejtori i shëndetësisë ka reaguar publikisht, unë po mendoj që e ka tentuar edhe në formë institucionale mirëpo nuk ka marrë vëmendje siç po shihet në bazë të letrave. Edhe I gjori është detyru me reagu publikisht, me na paralajmëru për atë çka po ndodh edhe atë çka e pret qytetarin e Prizrenit. Kështu që nuk mundesh drejtor me u anku në financa, në Shadërvan me çu miliona euro, investim

riinvestim vazhdimisht, edhe mos me pas mjete për gjëra elementare në qendrën kryesore të mjekësisë familjare edhe në qendrat e mjekësisë familjare të komunës së Prizrenit. Sa i përket kontratës kolektive, kontrata kolektive është nënshkruar në vitin 2017. Një ligj, një vendim, një kontratë kur të nënshkruhet, parashihet në detaje që ajo edhe me u zbatu. Nënshkrimi i qeverisë së Pani-t kryesisht i PDK-së së vitit 2017, po lenë pasoja dhe në vitin 2026. Tash veç paramendoni, nuk mjafton me ra prej pushtetit edhe mos me i pësu, mos me i përjetu pasojat e një pushteti të dëmshëm qysh ka qenë atëherë. Mirëpo dhe në vitin 2026 ne i vuajmë pasojat e një vendimi të gabuar atëherë. Kështu që duheni me pas parasysh që vendimet e këqija, jo të gjitha gabimet mund të rregullohen shumë shpejt. E marrin janë rregulluar vazhdimisht. Aty duhet edhe gatishmëri prej komunave dhe. Kryesues a bën ... Kështu që, okej, po e përfundoj. U dashtë me ja tërhek vërejtjen drejtorit për ndërhyrjen, jo me ma ndal mua fjalën, se nuk e kuptova a e din? Faleminderit për mirëkuptimin. Kështu që, siç e thashë edhe një herë, duhet me pasur parasysh shumë çfarë vendime po merrni, për shkak se pasojat janë edhe kur ju nuk jeni më në qeverisje. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Shqipe Shatri, le të përgatitet Haziz Hodaj.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit kryesues. I nderuar drejtori i financave, zotëri Levent Bus, i nderuar drejtori i shërbimeve publike, zotëri Ukimeri. Në kuadër të pikës të rendit të ditës për propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026, dua të ndalem tek neni katër pika dy, ndërtimi i infrastrukturës në Gjonaj, ku në fund thuhet se shuma e prezantuar për bartje është obligim ndaj kontratës. Është e kuptueshme që obligimet kontraktuale duhet të përmbushen. Megjithatë, konsideroj se paralelisht me pagesat duhet të ketë edhe një kontroll rigoroz të cilësisë së punimeve të kryera. Në rastin konkret në Gjonaj kam shqetësime reale bashkë me banorët e tjerë, ku disa rrugë të asfaltura kanë filluar të dëmtohen brenda një periudhe shumë të shkurtër, madje pa kaluar as edhe një vit. Kjo ngre dyshime serioze për cilësinë e punimeve dhe mbikëqyrjen e tyre. I nderuar drejtor, kërkoj që para ekzekutimit të plotë të pagesave të sigurohet se punimet janë kryer sipas standarteve dhe specifikave të kontratës si dhe të ketë përgjegjësi konkrete në rast të mosrespektimit të tyre. Prandaj kërkoj që para ekzekutimit të plotë të pagesave të sigurohet se punimet janë standarte dhe të ketë përgjegjësi kontraktuesi i fituar. Ju faleminderit nëse e merr në konsideratë dhe e ndryshon pagesën këtë herë për në Gjonaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesues. Ne jemi të vetëdijshëm që çështja e e përmbaruesit është bërë problematike sidomos në komunën e Prizrenit dhe kjo shkakton pakënaqësi jo veç te drejtorët e LDK-së, por te të gjithë drejtorët e ekzekutivit të komunës së Prizrenit. Për këtë jemi të vetëdijshëm. Por që duhet të jeni më racionale në ndarje të asaj çka është e mundshme kjo duhet ta keni parasysh. Po ne nuk dyshojmë në drejtorët që i kemi që jemi të përfaqësuar në ekzekutiv absolutisht sepse i kanë sytë kapsolla dhe janë janë agjil edhe në punën që e kryjnë edhe në kërkesa. Përndryshe në Komitetin për Politikë e Financat që ishin pardje në mbledhje drejtori i shëndetësisë nuk ka qenë. Unë e kam parë reagimin edhe shqetësimin e tij, që është shqetësimi i të gjithë neve, i gjithë komunës së Prizrenit, mirëpo ai nuk ka qenë në Komitetin për Politikë e Financa. Kështu që nga Komiteti për Politikë e Financa nuk e kemi këtë shqetësim. Shqetësimi thashë është për të gjithë ne, natyrisht për ju më shumë sepse ballafaqoheni drejtpërdrejt me këtë ndarje, e shuma

është shumë e vogël e kërkesat janë shumë të mëdha, andaj duhet të keni kujdes në ndarje mos të krijohen pakënaqësi pastaj edhe të drejtuar të caktuar jo veç të LDK-së, por te të gjithë drejtorët, sepse racionaliteti mandej është një arsytim që nuk mundemi edhe ne të reagojmë pa pas ndonjë bazë. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju, Qemal a do me marrë fjalën apo e kryeti baca Haziz për ju?

Qemal Krasniqi (LDK): Jo, i tha Hazizi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë, faleminderit. Fjala për ju Agim Muqaj.

Agim Muqaj (AAK): Faleminderit kryesues. Kjo pikë bartje mjete sigurisht se është dhe e rregulluar edhe me ligj edhe nuk kam kundërshtim rreth bartjes. Mirëpo sigurisht se duke i parë dukuritë që kanë ndodhur në komunën tonë dhe në shumë komuna të tjera, mendoj se çdo drejtori i ka përgjegjësitë e veta, secila është nga rëndësia, i ka problemet e veta. Po ajo në këtë fazë mendoj se prioriteti, të gjitha prioritetet sigurisht se është shëndeti dhe sidomos edhe drejtoria e bujqësisë, sepse këto dy drejtori mendoj që në këtë fazë, në këtë krizë, mendoj se duhet të ishte më me prioritet, se ndoshta në drejtori të caktuara ku mund të shkonë ndonjë asfalt i cili mund të pret, mirëpo duhet ta ruajmë rëndësinë e shëndetit dhe ata të cilët janë bujqit të cilët punojnë dhe kanë mbijetesën e tyre, por sigurisht edhe vetë të gjithë banorët e qytetit jemi të varur nga produktet e tyre. Kisha dashur që ky lloj buxheti të rishikohet dhe në këto dy drejtoritë të jetë prioriteti i prioritetëve së paku në këtë krizë të cilën gjendet komuna. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Agim. Atëherë po Arianit Berisha shefi i grupit parlamentar të PDK-së.

Arianit Berisha (PDK): Përshëndetje për të gjithë. Ju kisha lutur qoftë drejtorit, qoftë zyrtarit të financave me na bë një sqarim. Unë jam munduar me atë pjesën time me bë një dy-tri herë, po e di që gjykohen politikisht kur e jap një mendim, me na dhënë një sqarim të saktë se si kontrata kolektive i implikon borxhet e projekteve të tjera. Me na tregu se si kur merret qoftë edhe 5 euro prej kontratës kolektive, preket një projekt tjetër, ai projekt tjetër nuk mundet me u pagu pastaj brenda këtij viti, e bartet për vitin tjetër, e kur bartet për vitin tjetër ai shkon te përmbaruesi, e përmbaruesi merr pra me na spjegu këtë cikël, ju kisha lutur në mënyrë profesionale, edhe nëse merr kohë që qytetarët njëherë e mirë ta kuptojnë këtë, e mos të bëjmë këtu luftë të hedhjes së fajit, a i ka fajet qeveria apo i ka dikush tjetër. Gjithashtu u përmend që kontrata kolektive është e keqe. Unë mendoj që kontrata kolektive ka qenë e mirë, po edhe nëse dikujt nuk i pëlqen, bashkë me bartjen e pushtetit dhe ndërrimin e pushtetit, barten edhe përgjegjësitë ligjore të cilat i ka krijuar një pushtet i kaluar. Prandaj, kjo kontratë ka qenë vendim i qeverisë dhe qeveria që ka ardhur pas ka mund me e ndërpre kontratën qysh ka vepruar për shkak se paska qenë e keqe për ta. Mirëpo është e obliguar që një obligim që ja jep ligji me e zbatu, se nuk mundet me ja marrë për periudhën që ligji ka funksionuar. Pastaj unë mendoj që me gjithë këto shpërblime që i jep kryeministri, sa herë kemi zgjedhje sidomos këto dy vitet e fundit, me një fond të veçantë e kishte zgjidh këtë çështje, as s'kishim pasur më telashe me përmbarues, as nuk na u kishin marrë ato mjete prej mjeteve të tjera, nuk ishin bartur borxhet për vitin tjetër, po jemi në këtë situatë që jemi, bëjmë lojëra fjalësh, mirëpo ata që e pësojnë më së shumti janë qytetarët. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. Fjala për ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Nga ky vend gjatë seancave të kaluara shpesh kemi tërhequr vërejtjen veçanti kur është përpiluar buxheti dhe para se të votohet se ka shumë kode buxhetore që nuk janë përputhje reale me vlerat aktuale të çmimit të tregut edhe shumë projekte domethënë kanë filluar me 20-30.000euro, 50.000 euro, e është ditë që ajo tejkalon me qindra mijëra euro. Dhe tash vjen koha që ngarkoheni me borxhe edhe pse nuk keni tejkaluar të gjitha ato paramasat e parapara dhe vijmë në këtë situatë sot kur kemi ardhur. Kemi raste edhe me Qendrën Kulturore Turke që janë ndryshuar gjatë zhvillimit të projektit. Janë ndryshuar edhe paramasat e objektit, por edhe çmimi i saj, kostoja e saj. U cekën projekte të ndryshme. Kemi një OJQ që brenda vitit ka marrë 180.000 euro në tre raste të ndryshme nga komuna e Prizrenit. Dy herë në emër të bashkëpunimit që ka nënshkruar kryetari dhe njëherë si subvencionim. Dhe tash te bartja e buxhetit vetëm dy janë arsimi edhe drejtoria e shërbimeve publike. Pse nuk ka bartje edhe në drejtori të tjera? Për shembull, kemi drejtorinë e Kulturës që ka borxhe të papaguara ndaj OJQ-ve që kanë përfutur subvencione vitin e kaluar. Kanë kaluar që sa muaj, janë përfunduar projektet dhe kanë mbetur pa u paguar gjithë ato shërbime dhe gjithë ata njerëz që kanë qenë të angazhuar. Një pjesë e këtij buxheti, pse nuk bartet edhe në drejtori të Kulturës dhe pse jo edhe në drejtori të tjera? Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Ilir, fjala për ju Lulzim Sylejmani.

Selman Sokolaj (LVV): Në çfarë cilësie na shpjegon zyrtari kryesor financiar i komunës Prizrenit kontratën kolektive? A është nënshkruar? A ka marrë obligime në kontratën kolektive? A ka dhënë garancione të zbatimit? Veç na shpjegon në çfarë cilësie na shpjegon? Po vazhdimisht shërbyes civil po futni në lojra politike. Ju lutem kërkoj shërbyesve civil mos të bëhen pjesë e betejave politike.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdo. Dëgjoje tash përgjigjen.

Lulzim Sylejmani: Sa i përket kontratës kolektive, unë mund me dhënë shpjegim veç në aspektin financiar dhe barrës së cilës ju kanë ngrakuar komuna dhe përballem sepse nga detyrat që kam jam ZKF, zyrtari kryesor financiar dhe kam përgjegjësi ndaj çdo centit të shpenzuar të komunës me ligj, s'jam staf politik, jam shërbyes civil, po mbaj detyrën e zyrtarit kryesor financiar që me ligj çdo cent i komunës bie barrë e përgjegjësisë ligjore që ma ngrakon ligji mua. Dhe për këtë mund të jap shpjegim profesional në lidhje me atë që çka është duke ndodhur në financa, jo çka përmban kontrata kolektive. Atë pjesë nuk më takon mua. Gjatë dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e buxhetit të vitit 2026, ne kemi pasur takim me Ministrinë e Financave dhe kemi kërkuar që ta buxhetojmë kontratën kolektive, ta ndajmë vlerën që ne e parashikojmë që mundet me ekzekutu përmbaruesi dhe mos t'i planifikojmë te projektet kapitale pastaj të prishet planifikimi. Kemi kërkuar, kemi thënë, a ka mundësi 5 milionë euro t'i ndajmë te kodi emergjent, kur paraqitet kërkesa t'i kryejmë prej aty dhe mos të prishet planifikimi. Nuk kanë lejuar, s'kanë lejuar, domethënë s'ka lejuar Ministria e Financave. Ju them me përgjegjësi të plotë në prezencë ka qenë drejtori i thesarit dhe drejtori i buxhetit. Të dytë, nuk kanë lejuar me buxhetu, s'ka qenë kërkesa e Prizrenit, e të gjitha komunave, sepse kush më shumë e kush më pak e kemi të njëjtën telashe. Problemi nuk është te kryegjësja, obligimi që rrjedh nga kontrata kolektive. Problemi është te shpenzimet administrative që i bashkangjitet asaj e që është një kosto shumë e madhe. Po ju tregoj

veç një listë që ka ardhur. Ka ardhur një listë me 120 kërkesa për vonesa në ekzekutim të vendimeve përmbarimore. Domethënë është ekzekutuar vendimi por është ekzekutuar me vonesë. Të gjitha ato vonesa kanë prodhuar efekt, kamatë në vonesë 5 euro 1 cent. Për 5 euro 1 cent të gjitha lëndët janë bërë 337 euro. Tash paramendoni sa ka qenë borxhi dhe sa ka qenë shtesa. Këtu dikush e ka qitur një perde para vetit dhe s'ka dash me adresuar këto për nivel të Kosovës. Më tutje spo du me hy te kontrata kolektive. Sa i përket shpenzimit që ka ndodhur dhe që ka reflektuar financiarisht komunën e Prizrenit, po ju them që diku rreth 70% e atyre 37 milionë eurove që po dojnë me u ekzekutue edhe tash në këtë moment, domethënë 30-35% janë kanë borxhet të operatorëve ekonomikë dhe pjesa tjetër ka qenë e kontratës kolektive. Po edhe ky borxh i operatorëve ekonomikë, nuk është borxh që kemi bërë ne keqplanifikim të buxhetit. Po ka qenë borxh që ka reflektuar prej ekzekutimit të vitit 2022 dhe ka shkuar zinxhir. Vitin e kaluam ku e kemi prezantuar planifikimin e buxhetit këtu, të gjithë kemi pasur kërkesa për projekte të reja, të cilat i kemi marrë prej dëgjimeve buxhetore. Keni qenë edhe ju dikush bashkë me neve nëpër dëgjime buxhetore dhe e kemi parë çfarë janë kërkesat. Dhe është reduktuar minimalisht prej 22 milionëve te investimet kapitale përafërsisht 1 milion kanë qenë projekte të reja. 22 milion kanë qenë obligime kontraktuale për kontratat në vazhdim dhe ne i kemi respektuar sepse ligji thotë gjatë planifikimit të buxhetit thotë njëherë respekto kontratat, pastaj kërkesat e qytetarëve. Ne i kemi respektuar kontratat. Çfarë ka ndodhur në mars? Në momentin që është aprovuar buxheti, janë ekzekutuar 12 milion, 12.3 milion. Gati 11 milion te shërbimet publike. Domethënë ne nuk kemi hyrë me kërkesat me buxhetu kërkesat e reja, i kemi buxhetuar kontratat, por janë ekzekutuar. Janë ekzekutuar dhe ta kanë prishur balancin. Sa i përket shqetësimit të të hyrat e bartura, te Drejtoria e Shëndetësisë, nuk është që e kemi anashkuar. Pasi e kemi prur ne propozim vendimin këtu, është ekzekutuar javën e kaluar 1.4 milion te mallrat, 1 milion janë ekzekutuar te Shëndetësia dhe 428.000 nëse s'jam gabim te administrata. Dhe po ju them kështu, komplet buxheti te mallat dhe shërbimet diku është 15 milionë i shpërndarë nëpër drejtori. Do të thotë kryetari i ka shkruar drejtorit të thesarit dhe drejtorit të buxhetit dhe i ka kërkuar korrigjim me i rikthyer ato mjete në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe me i marrë ku ke mundësi që sado pak të jetë më e lehtë ajo barrë. Ende s'kemi marrë përgjigje, por unë shpresoj që atë korrigjim kena me bë. Domethënë kena me i marrë dhe të gjitha drejtoritë nëse është nevoja e fundit ka me mbet Drejtoria e Shëndetësisë me mbet pa shërbime, sepse e dimë rëndësinë e asaj. Projektet të tjera, veç edhe një minutë e kryta kryesues. Projekte të tjera që janë propozuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për këtë bartje, mundet me i arsyetu edhe drejtori, po ju thashë që kur të merren 11 milionë prej 14-ve që i ka drejtoria, patjetër që kanë pasur me u bartë te Drejtoria e shërbimeve publike, sepse ka pësuar më së shumti nga ekzekutimi. Kjo ka qenë arsyeja. Te pagat që janë bartë te arsimi, domethënë te shkollat e mesme, te pagat janë bartë sepse e kemi atë mësimin që zhvillohet për të rritur dhe aty participon shkollat. Domethënë këto mjete janë të atyre, domethënë ju kthehet në paga për mësimin për të rritur që zhvillohet jashtë orarit të rregullt. Te niveli fillor kemi bërë për shkak, në paga për shkak se kemi zëvendësimin e lehonave, kemi dhe zëvendësimin në disa raste të arsimtarëve që janë me sëmundje, që nuk mundesh me heq nga lista e pagave në mënyrë automatike dhe duhet me zëvendësuar. Ka një mori shpenzime është aty të cilat, ministria, kur ne e bëjmë buxhetin, nuk lë me pas rezervë te pagat, edhe pse ne e dimë vazhdimisht që arsimi ka telashe. E bëjmë buxhetin dhe thojmë, me këtë buxhet kemi me pas ne telashet e pagat në arsim, por nuk lë me e shtu, qysh

me thënë, me mbajt një rezervë të caktuar që ne ti me mbulu muajt në vijim. Kaq kisha pas me shpjegu, nëse s'jam i qartë, këtu jam.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit për përgjigjen shumë profesionale, zoti Lulzim që e dhaje. Mundësisht po e hedhim në votime dhe po shkojmë pauzë pak se e zgjatëm.

Dafina Alishani (LVV): Kryesues, për juve është shumë profesionale, po për mua është gjysmë profesionale. Meqë zotëria u paraqit, a e di, mos bëni vlerësime, ju për vete mundeni me i falenderu, po ne nuk e kemi të qartë një gjë. Ky zotëriu doli këtu, na tha, "Unë jam përgjegjës për secilin cent që shpenzohet në komunën e Prizrenit", apo jo? Me detyrë. Këtu ne kemi që komuna paska pagu dhe paska regjistru shpenzime në vlerë 846.000 euro në kategori jo adekuate. Po thotë, nga kategoria e investimeve kapitale në emër të mirëmbajtjes, investimeve, fshirje dhe larje e rrugëve janë paguar 422.000 euro. Ju po thirrni që domethënë vetëm e vetëm përmbarusi i ka marrë ato të cilët janë me kontratë. Unë prapë po e cekim për hirë të korrektësisë tek qytetarët. Nëse kjo komunë ka paguar një OJQ tri herë, 183.000 euro, dy herë me marrëveshje me kryetarin, me zyrën e kryetarit dhe njëherë me subvencion. Ndërkohë OJQ-të tjera ende nuk kanë marrë subvencione. Nëse kryetari nuk po na jep sqarime, a mundeni ju si zyrtar me na tregu neve, qysh mundeni me leju ju një diskrepancë kaq të madhe mes OJQ-ve? Nëse po thuni që secilin cent ne kemi obligim. Kur është bërë kategorizimi i gabueshëm ku keni qenë ju si zyrë, si ka mundësi investimet kapitale me u pagu prej kodit buxhetor të mallra dhe shërbime? Hajde, po ju lus si profesionist na tregoni qysh lejohet një gjë e tillë me u bë, nuk është hera e parë. Tre vite radhazi paguhet mallra shërbime me investime kapitale ose anasjelltas.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, shkurt vetëm.

Selman Sokolaj (LVV): Zotëri, ju folët për kontratën kolektive, mirëpo edhe folët që i keni bërë kërkesë të ministrisë, po paraprakisht thatë që nuk e njihni ose nuk doni me folë me për kontratën kolektive. A i bien kjo që mund ta keni bërë një kërkesë jo ligjore te ministria, nëse nuk e njiheni kontratën kolektive dhe nëse nuk jeni të thirrur me folë në emër të saj, për shkak se edhe kërkesa që i bëni ministrisë për mos me turbullu këtu, mos me na keqinformu. A mendoni që janë ligjore dhe ata kundërligjëm apo, se po thoni kemi bërë një kërkesë, a lejon ligji një gjë të tillë? A parasheh kontrata kolektive qatë fondin që ju e keni kërku? A ke lexu kontratën kolektive, së pari? Sinqerisht po të pyes. Kontratën kolektive të hartuar nga SBASHK-u, Ministria e Financave në 2017-ën, a e keni lexu? Jo edhe kryesuesi se tha ke përgjigje super profesionale. Tjetra, domethënë se ke lexu shumë keq. Tjetra, ju thatë që gjithçka shkon në rregull. Mirë, e ceku Dafina Alishani, në Romajë të Hasit, 300.000 euro kushton projekti, i keni nda 60.000 euro. Edhe auditori konstaton në vitin paraprak nuk është nda asnjë cent. Më fal, qysh mundesh mos me hy këtu në obligime përmbartimore edhe me i shkaktu probleme komunës së Prizrenit? Këta thashë në fillim e kurseni veten nga çështje politike....

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju thatë që shkurt urdhno përfundoje tash. Përfundoje tash.

Selman Sokolaj (LVV): Zoti Krasniqi të sqarohemi. Nëse është shkurt nëse është rregullorë e ndale bre qysh ndalet në Kuvend të Kosovës? T'i zgjidhim këto çështje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë, mbasi hyjmë në rregullore, unë të dhashë hapësirë më tepër se që duhet. Ju e dini shumë mirë, as nuk tu cek emrin këtu në rregullore. Unë ta dhashë atë hapësirën edhe më erët, se vetëm njëherë ki i të drejtë që ta merr fjalën. Në qoftë se të përmendet emri, të jepet mundësia me e marrë fjalën. Unë ta dhash më tepër se që duhet mundësinë, ja japim fjalën zyrtarit të financave. Përfundoje tash.

Selmam Sokolaj (LVV): Ta përfundoj. Kështu ke. Ky tha kontrata kolektive, ky nuk flet në emër të kontratës kolektive. Në të njëjtën kohë u mundua me arsyetu, me disa kërkesa që janë politike. Disa kërkesa që janë politike. Qatë thashë që mos u bën pjesë e lojrave për shkak se po thotë unë s'kam kompetencë për kontratë kolektive, mirëpo ne si komunë kemi tentuar. Çka ke tentu? A ta lejon kontrata kolektive këtë gjë? Edhe kryesues sa i përket dijeve përmbledhjes, shumë vendime 80% të vendimeve po ju kthehen juve edhe asambleistëve të juve. Kështu që merrni ju pak, merrni dije, e na leni neve në këtë mosdijen tonë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, veç një përgjigje këtu. Vendimi i njëjtë të komunës së Fushë-Kosovës, ndoshta që udhëheq dikush tjetër, është kthyer ligjëmëria, kurse neve na është kthyer negativ. Vazhdojmë me Lulzimin.

Lulzim Sylejmani: Te pyetja e Dafinës, te keqklasifikimi, Dafinë në buxhetin e vitit 2026, domethënë te pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugës, domethënë është buxhetuar në kodin e mallrave dhe ai keqklasifikim nuk do të ndodhë më, domethënë është rregulluar ajo çështje. Sa i përket kërkesës ne që e kemi drejtuar ministrisë, fare nuk e kemi përmendur kontratën kolektive. Ne kemi kërkuar korrigjim brenda drejtorive. Domethënë ne s'e kemi përmendur hiç në atë kërkesë, kontratën kolektive. Kemi kërkuar kontabilitetin të Ministrisë së Financave, Thesarit, me na bë një korrigjim me thënë, merri në drejtorinë tjetër edhe kthej në drejtorinë e shëndetësisë. Kaq kemi bërë kërkesë, fare s'kemi, sepse e dimë ne, kush ka mund me ndryshu e kush s'ka dashur e kush ka dashtë me ndryshu. S'kemi hyrë në atë çështje. Ne kemi kërkuar edhe vitin tjetër, edhe vitin e kaluar kemi bërë korrigjime, aty ku kemi pasur mundësi. Nuk kanë lejuar, por me ligjin e ndarjeve buxhetore për vitin 2026, ministri ja ka shtuar kompetencat vetit për do sende që ti më nuk mundesh as me i bë, as me i kërkuar, as me i korrigjuar. Ne ju kemi drejtuar me shkresë zyrtare, departamentit të buxhetit, drejtorit të buxhetit në ministri dhe drejtorit të thesarit. Kemi thënë, sikur që ka ndodhur viteve të kaluar, a ka mundësi ta bëjmë një korrigjim me më pak dhimbje ku dhemb më shumë çështja? Veç me i bartë prej një drejtor të caktuar, me i qit aty që mos me mbetë shëndetësia pa shërbime. Dhe besoj dhe kam shpresë që atë përgjigje do ta marrim pozitive sepse është e arsyeshme.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kalojmë në procesin e votimit. Sa jemi prezent?

Dafina Alishani (LVV): Më fal kryesues, veç edhe diçka. A mundet drejtori i shëndetësisë me u deklaruar që, a është i pajtimt me këtë bartje, meqë ka reaguar mu në ditën e KPF-së, ta kemi parasysh edhe ai erdhë tash, se na folëm pa qenë ky këtu, me u deklaruar a është në rregull me këtë bartje edhe a siguron ky shërbime me këtë bartje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kemi pas ne takime me drejtorin e shëndetësisë, nuk ka nevojë tash.

Dafina Alishani (LVV): A mundemi me pasë një deklaratë drejtorit?

Simir Krasniqi (Kryesues): 36 jemi prezent.

Dafina Alishani (LVV): Ju lutem kryesues mos e keqpërdor bre. Erdhi njëri mbasi që u diskutua.

Simir Krasniqi (Kryesues): Jemi kordinuar me drejtorin e shëndetësisë.

Dafina Alishani (LVV): Ti mundesh me kordinuar për hir të transparencës, unë dua me pas një deklaratë të drejtorit. Ju lutem.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, ne dhe këtu që jemi në seancë përmbaruesi mund të merr mjete, edhe tash nuk është, ne atë ditë që e kemi mbajt KPF-në, ndërkohë ka ndodhur që përmbaruesi i ka marrë mjetet, edhe ne asnjë punë nuk e bëjmë pa u kordinuar me të gjithë drejtorët. Drejtorët janë të përbashkët të gjithë, nuk ka dallime këtu mes drejtorit të shëndetësisë apo të shërbimeve publike, të emergjencave, të gjithë janë drejtorat e përbashkët. E tash e drejta jote është me besu. 33 jemi prezent. Sa jemi për? 23 Për. Kundër? 7 kundër. Abstenim. Atëherë kjo pikë miratohet. Vazhdojmë 25 minuta pushim.

Pas Pauze

Simir Krasniqi (Kryesues): Po pikën e pesë do ta kalojmë, do të kalojmë te pika e gjashtë. Vjen drejtori ose iniciuesi i pikës që ta bën prezentimin, pasi për momentin nuk është këtu, kalojmë te pika e gjashtë e rendit të ditës. 26 jemi prezent, pra kemi kuorum.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001-011-25151 të datës 26.02.2026 për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajshme të komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2026 sipas kërkesës së MAPL-së.

Këtu e kemi iniciuesin e pikës dhe mund ta bëj prezantimin pra të pikës së rendit të ditës. Për ju fjala, drejtor i pronës.

Elsabah Xhurxhehalo: Faleminderit, i nderuar kryesues, të nderuar zëvendës kryesuese, kolegët e ekzekutivit, të nderuar kuvedar, media dhe qytetarë të dashur. E kemi iniciuar këtë pikë për arsye se qysh jeni të njoftuar nga dokumentacioni që keni pranuar. Votimi i cili ka ndodhur këtu, dokumentacioni ka shkuar në MAPL dhe e njëjta nuk është kthyer pozitive në aspektin e ligjshmërisë. Ka pasur kërkesa, të cilat tani në propozimin që e kemi sjell i kemi inkadruar të gjitha. Vlen të theksohet që këto kërkesa kanë pasur përmbajtje teknike, ndërsa me çështjen se çka është tu u propozuar, të gjitha i kanë pasur edhe në propozimin e kaluar, domethënë kolegët atëherë të sektorit të pronës kur e kanë përgatitur. Mirëpo, kërkesa ka qenë që këto të ndryshohen dhe të kalojnë nga dokumenti i propozimit për vendim, te lista, te tabela e pronave. Ju dokumentacionin e keni. Na këto të gjitha i kemi integruar. Prezantimi është bërë në mbledhjen e rregullt në muajin shkurt. Edhe diskutimi, debati, votimi, realisht për arsyeshmërinë e kësaj është bërë në muajin

shkurt. Sot është pranë jush vetëm për shkak të ndryshimeve apo përshtatjes, të cilën e ka kërkuar MAPL nga ne. Ne gjatë kësaj kohe e kemi bërë këtë përshtatje dhe sot është para jush për votim. Ne kërkojmë që të votohet. Nëse keni ndonjë pyetje rreth kësaj, jam këtu. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për sqarime. E hapim diskutimin. Po, fjala për ju, Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Edhe gjatë takimit në KPF u përmend që vlerësimi që ka ardhur nga MAPL-ja bazohet në katër pika. Njëra prej tyre, e para është se komuna duhet të publikojë listën e përgjithshme të pronave të paluajshme deri me datën 31 dhjetor. Do të thotë ai arsyetimi që na është dhënë neve edhe herën e kaluar se na e kanë shtyrë deri në fund të marsit, askund nuk është duke u përmendur. Këtu po merret edhe ajo si argument. Edhe pika tjetër është se kanë dhënë afat një muaj ditë, data 18 mars. Sot jemi me 30 prill. Do të thotë edhe ky afat është tejkalu, po edhe këtu nuk ka leje apo pëlqim që na mundëson me shty, me marrë vendimin deri me 31 mars. Kështu që mendoj që vetëm ndryshimet teknike që i ka bërë drejtori nuk janë të mjaftueshme. Edhe afatin kohor e kemi kaluar të ligjshmërisë, po edhe nuk ka pëlqim prej ministrisë për ta vazhduar afatin nga 31 dhjetori deri më 31 mars.

Elsabah Xhuxhehalo: Kemi biseduar dhe në KPF, zyrtari, udhëheqësi i sektorit, Gurseli ju sqaroj, që kanë pranuar, po edhe kryesuesi ju sqaroj, që kanë pranuar, domethënë me shkrim prej MAPL-së, që për shkak të organizimit të zgjedhjeve lokale, ky afat është shty prej 31 dhjetor deri në fund të marsit. Domethënë këto, unë po besoj që e keni sqaru, por nëse keni nevojë edhe me dokument me ju sqaru, po besoj që ditëve në vijim mundemi edhe me jua prezantuar dokumentin. Domethënë po ashtu sikur të ishte kjo, sikur të qëndronte kjo çka po thoni, atëherë në vendimin e MPAL do të cekej që ne nuk mundem me vazhduar më tutjetë jetë me procedimin e kësaj çështjes. Ndërsa MAPL neve na thotë që brenda 30 ditëve të bëni ndryshime e nevojshme dhe të na njoftoni neve. Domethënë që vetvetiu vendimi nënkupton që është një proces në vazhdimësi, sepse sikur të thoshte që ka qenë data 31 dhjetor dhe tash jeni jashtë datës, atëherë nuk do të na sugjeronte që brenda 30 ditëve t'i ndërmarrim disa veprime dhe të njoftojmë po ashtu MAPL për veprimet e ndërmara. Pasi që do të konsiderohej se do të ishte një procedurë e përfunduar. Për atë arsye edhe po ta elaboroj që domethënë nuk qëndron ajo pjesë, pasi që edhe e kanë edhe vendimin. Ndërsa pyetjen tjetër që e kishit rreth çështjes së 30-ditore, nëse e shihni te dokumenti është i protokolluar me datën 23 mars, naltë në të majtë, protokoli i Ministrisë është, në aspektin juridik, kjo datë konsiderohet data kur dokumenti lëshohet prej këtij autoriteti dhe ka nga kjo datë rrjedh afati 30 ditor. Ne brenda afatit 30 ditor edhe këto po e sqaroj, e kam sqaruar edhe në KPF, po e sqaroj edhe njëherë për opinionin që ne para afatit 30 ditor i kemi kryer këto ndryshime dhe i kemi dërguar dokumentacionin te kryesuesi, për t'ju shpërnda edhe për të ndërmarrë veprimet e më tutjeshme edhe në këtë komunikim e kemi mbajtur të bashkangjitur edhe këta zyrtarë të MAPL-së, konkretisht ata të cilët e kanë këtë rast që e kanë lëshuar këtë vendim dhe kjo në aspektin juridik konsiderohet që ne e kemi njoftuar për hapat e më tutjeshme që i kemi ndërmarrë, lidhur me vendimin të cilin na kanë lëshuar. Prandaj nuk edhe kjo nuk qëndron që jemi jashtë afatit, pasi që seanca nuk caktohet vetëm për këtë vendim, apo kisha me thënë më të drejtë është pastaj në planin

edhe programin ee kryesuesit. Dhe këtë e konsideroj që është brenda afatit. Domethënë veprimet që i ka kërkuar më MAPL-ja me këtë vendim, me u ndërmarrë, janë ndërmarrë brenda afatit, janë dërguar për procedim më tutje shëm dhe është njoftuar më MAPL-ja për domethënë këto ndryshime. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. A do dikush fjalën? Po Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Vetëm drejtor për sqarim te vendimi për shfuqizim apo çka do që të jetë i me MAPL-së. Njëra prej pikave thotë që prona duhet të përmbajë këto dhëna. Prona në listën e veçantë që do të jepet në shfrytëzim. Dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin. Nëse mundesh me na sqaru pak më shumë destinimin për shkak se qëllimi, destinimi thotë rritja e vlerës së pronës. Mirëpo destinim i pronës mund me qenë banimi, biznesi komercial, destinim bujqësor, destinim industrial. Domethënë a jemi të sigurt që nuk po kërkohet që kjo me u specifiku prej MAPL-së, e jo vetëm për të gjitha pronat këtu, rritja e vlerës së pronës komunale dhe të hyrave, rritja e vlerës së pronës komunale dhe të hyrave. Nuk e keni cekur destinimin. Faleminderit.

Elsabah Xhuxhehalo: Faleminderit për pyetjen e juaj. Nëse jemi duke e shikuar dokumentin e njëjtë, tabelën e njëjtë. Para këtij termi që ju po i thoni rritja e vlerës së pronës komunale dhe të hyrave, e keni termin sipas HZK, që nënkupton sipas hartave zonale. Domethënë ne si drejtori apo para neve që ka qenë sektori si sektor, nuk jemi kompetent për me caktuar destinim çka mundet me ra në kundërshtim me hartat zonale. Është një term i përgjithshëm. Ndoshta nuk e përmenda parës në sqarim, po e sqaroj edhe këtë pjesë që gjatë përpilimit të kësaj tabele, meqënëse nuk kemi pasur bashkëpunimin e pritur ashtu qysh e kanë cekur edhe në vendimin e tyre këta shërbyes civil të MAPL-së, me të cilët shërbyesit tonë civilë të drejtorisë tonë kanë kërkuar takim, në mënyrë që me sqaruar saktëkonkretisht se çka po kërkohet, deri në këto momente kur ne edhe tash jemi tu folur, ne nuk kemi pranuar domethënë një aprovim, kemi provu përmes telefonit, përmes emailit, përmes telefonave privat edhe zyrtar, me i kontaktu, në mënyrë që me na sqaru më detajisht këto. Dhe në mungesë të një komunikimi, atëherë ne kemi shkuar me formën e mostrimit, duke i parë komuna të tjera si kanë vepruar, dhe kemi parë që në disa komuna të tjera në Kosovë, e kanë përdorur këtë term dhe e kanë përgjithësuar çështjen e destinimit edhe qëllimit në këtë formë, pasi që qëllimi dihet sepse është edhe sigurimi i të hyrave për komunë, por edhe për shkak se ajo pronë e cila shfrytëzohet, i rritet edhe vlera e asaj. Kjo është e vetëkuptueshme, ndërsa për çështjen e destinimit edhe ne po besoj që ka edhe komuna të tjera, por edhe vetë MAPL-ja ndoshta do të kishte mundur me na dhënë më shumë sqarime se si ne me e sqaru destinimin, se ne nuk mund me e ndryshuar ato. Nëse me hartë zonale është e parapame prej njëren prej aktiviteteve që e përmendet ju, unë nuk mund këtu me propozuar pranë jush që të del me një aktivitet tjetër, pasi që është një dokument tjetër që e pengon këtë. Dhe për atë arsye, domethënë, e kemi përdorur këtë term të përgjithshëm, i cili po besoj që ka me u pranë në këtë formë, pasi që jo vetëm Prizreni, domethënë, nuk është një diçka që ne si Prizreni e kemi shpikur, e kemi marrë nga komuna të tjera, duke nisur nga komuna e Prishtinës, kemi marrë nga komunat e tjera, se si i kanë dhe i kemi integruar në të njëjtën formë. Dhe po besoj që kanë me pranë, apo të paktën, kanë me na sqaru se

çka saktë duhet me bë. Na nga ana jonë përpjekjen e kemi bërë, qysh ditën e parë, kemi dërguar kërkesë për takim, domethënë në formën zyrtare, kemi qenë të gatshëm me shku edhe me zhvilluar takim edhe me pa se çka konkret dhe saktësisht mundemi me integruar në këtë dokument, po nuk na është kthyer asnjë përgjigje deri në këto momente.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Atëherë, kalohet në procesin e votimit. Sa jemi prezent? 34 jemi prezent. Sa jemi për? 25 jemi për. Kundër? 6 kundër. Abstenim. 0. Po, atëherë miratohet pika e gjashtë e rendit të ditës, pra shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001-011-25151 të datës 26.2.2026 për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2026 sipas kërkesës së MAPL-së.

Kalojmë pra në pikën e pesë për shkak që nuk ishte drejtori kur e filluam vazhdimin e seancës. Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ftojme të prezantohet kjo pikë nga iniciuesi i pikës për rendin e ditës. Fjala për ju, drejtor i shërbimeve publike.

Islam Ukimeri: Faleminderit kryesues, të nderuar drejtor, asambleistë dhe ju të pranishëm. Po dal për shkak rëndësisë të veçantë që është kjo pikë, dola edhe në foltoresë s'kam dalë moti edhe besoj që ndoshta është edhe më mirë edhe kam edhe faleminderit shumë edhe e kam përgatitur edhe një fjalim për atë arsye edhe ndoshta mos me harru ndonjë send që të më bajnë ndonjë pyetje. Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit, para jush se të paraqitet pika e shqyrtimit dhe miratimi i propozimit për subvencionimin e transportit urban në komunën e Prizrenit. Si një hap shumë i rëndësishëm për herët e parë pas luftës kemi arritur që qeverisja e Shaqir Totës të bëjë subvencionimin, lirimin e disa kategorive me të cilën sadopak do të ndihmojnë si për qytetarë që do ta shfrytëzojnë transportin ashtu edhe për përmirësimin e shërbimeve në transportin urban. Qëllimi kryesor i këtij subvencionimi është përmirësimi i shërbimit i transportit publik, rritja e qasjes së qytetarëve në transport të sigurt, të rregullt dhe më të përballueshëm, si dhe mbështetja e kategorive të caktuara sociale dhe institucionale. Përmes kësaj mase synohet që transporti urban të jetë më funksional, më i përdorshëm dhe më i drejtë për qytetarët duke i ndikuar njëkohësisht edhe në uljen e ngarkesës ekonomike për familjet që kanë nevojë, zvogëlimin e përdorimit të veturave private, uljen e dendësisë të trafikut dhe mbrojtjen e mjedisit. Subvencionimi parashihet të bëhet për linjat të transportit urban, ku operatorët e transportit u kompensohet një pjesë e kostës operative me qëllim që qytetarëve t'u ofrohet shërbim më i lirë dhe më i qëndrueshëm. Nga ky subvencionim pritet të përfitojnë kategori të caktuara si pensionist, kategoritë dalin nga lufta dhe familjet e tyre, personat me aftësi të veçantë, policia, ushtria, zjarrfikës, punëtorët e arsimit, shërbyes civil si dhe nxënësit e shkollave të mesme dhe të ulët, sipas përcaktimit të vendimit. Sa përket linjave urbane periferike në fshatrat e komunës së Prizrenit, dëshiroj të sqaroj se ato nuk janë të përjashtuara dhe nuk do të përjashohen nga vëmendja e komunës. Pra, infrastruktura e

tanishme e transportit urban e periferik ka nevojë për përmirësim siç janë. Përmirësimi i kushteve të autobuzeve me pajisje përcjellëse, qasje për transport me nevoja të veçanta, mbrojtja e ambientit, si dhe digjitalizimi apo numërimi automatik me kartela të udhëtarëve në hyrje-dalje me qëllim të identifikimit më të lehtë dhe automatik për udhëtarët e liruar nga pagesa. Aktualisht ne si drejtorja e shërbimeve publike në kuadër të kompetencave ligjore jemi në proces të realizimit të matjeve në terren dhe analizat të detajuara teknike financiare, në mënyrë që të përcaktohet kostoja reale dhe përfshirja e të gjitha fshatrave për subvencionim. Pas përfundimit të këtyre analizave dhe pas vlerësimit të mundësive buxhetore, subvencionimi i transportit urbano periferik në fshatra, në fshatrat e komunës Prizrenit do të marrin hapat për të vazhduar me subvencionim sa më të shpejtë të jetë e mundur. Prandaj kërkojmë mbështetjen tuaj për miratimin e kësaj pike si një hap konkret dhe shumë i rëndësishëm drejt një transporti publik më të çashëm, më të organizuar dhe më të dobishëm për qytetarët e komunës e Prizrenit. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. E hapim diskutimin. Fjala për ju Agim Muqaj, në të përgatitet Ilir Gashi.

Agim Muqaj (AAK): Faleminderit drejtor, Islam Ukimeri, kjo besoj që gjatë dekadës së fundit është një ndër kërkesa apo vendimi më i qëlluar nga kuvendi komunal i Prizrenit. Sigurisht se ka qenë dashur edhe më herët, por asnjëherë nuk është vonë dhe mendoj se të gjithë qytetarët do t'i gëzohen këtij vendimi. Mirëpo, pasi që do të bëhet subvencionimi për kompaninë e caktuar kisha dashur pak, një përgjigje pak më të saktë. Çfarë do të bëhet, do të thotë që ju e thotë që nuk do të të tejkaluar fshatrat përreth, mirëpo ka një afat kur do të fillojë implementimi i qarkullimit të këtij rrjeti urban edhe nëpër fshatra që ta dinë së paku kur do të fillojë. Në qoftë se edhe këtë vit nuk ka mundësi, por së paku vitin tjetër ta dinë data kur fillon dhe linjat sigurisht se duhet të jenë të rregulluara për t'ju përshtatur mëngjesit, orarit të punës, nxënësve dhe deri në orët e vona edhe që ka nxënës edhe punononjës. Kështu që kisha dashur një afat, pak më preciz, ku e keni parashikuar apo i keni bërë përlllogaritjet, kur do të jetë afati që edhe fshatrat do fillojnë ta shfrytëzojnë këtë benefitet. Me të vërtetë ju përgëzoj për këtë vendim edhe besoj që dekada e fundit është një ndër vendimet më të qëlluara.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Agim Muqaj, fjala për ju. Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit. Drejtor, edhe dje në KPF e patëm këtë diskutim. E para, kjo qasje është diskriminuese. Nëse krejt qytetarët janë të barabartë, atëherë nuk mundet një pjesë me qenë pak më e barabartë ose me pas më shumë të drejta se të tjerët. Me një anë, një pjesës i jepni privilegje, ndërsa pjesës tjetër të qytetarëve që jetojnë nëpër fshatra, vetëm thoni se vëmendja e komunës vazhdon të jetë me juve. Pra, atyre vëmendjen, këtyre subvencionet. E para, kompania aktuale që punon transportin publik urban brenda në qytet, a ka licencë për me operu? Nëse ka licencë, është kompani e vetme. Nëse nuk ka licencë, qysh mundesh me e subvencionuar një kompani që punon pa licencë? Tjetra, barra më e madhe i bie atyre që udhëtojnë nga periferia, pra nga fshatrat në qytet të qytetit e jo brenda qytetit. E dimë që shumica e institucioneve brenda qytetit janë në largësi që mund të kalohen edhe duke ecur. A është bërë një analizë se sa policë, zjarrfikës,

familjarë të dëshmorëve, studentë, nxënës dhe të moshuar përdorin autobuset urban çdo ditë? A është nxjerrë një listë sa është nevoja e tyre që ju po mundoni me i subvencionu? Këta që vijnë nga fshatrat, paguajnë kosto shumë më të madhe. Plus ndalohet hyrja e autobusave tyre në pjesën më të madhe të qytetit. Në ato pjesë që detyrohen të kalojnë, aty ata paguajnë 30 cent. Për shembull, nga Skorobishti autobuzi që vjen, paguan diku 30 cent prej Lubizhdës deri në Dardani apo ku e ka atë pikën e fundit, ku lejohet me autobus të kalojnë. Dhe kështu ju po mundësoni diskriminim. Unë propozoj që ky vendim është i ngutshëm, natyrisht është i dobishëm dhe i nevojshëm për të gjitha ato arsye ju që i cekët më herët, por duhet të tërhiqet dhe edhe njëherë të diskutohet edhe me operatorët transportit urbano-periferik, edhe me banorët e fshatrave, me shoqërinë civile, të ketë një diskutim më të gjon dhe të vendosen prioritetet, se cilat kategori duhet më së pari të subvencionohen. Ato që vijnë prej fshatrave në qytet apo brenda qytetit. Ky është propozimi që besoj se duhet të merret parasysh, përndryshe një ofrim i tillë dhe arsyet që i dhatë, besoj që janë të qëndrueshme dhe janë të nevojshme, por ky hap është hap i ngutshëm. Ka ankesa që kompania në fjalë që operon në trafikun urban, nuk i përmbahet linjave ashtu qysh është paraparë në fillim kur kanë marrë lejen për me operuar dhe kanë bërë ndryshime në krye veti. Dhe në këto kushte, për me subvencionu një kompani, unë besoj se duhet të shtohen më shumë autobus, më shumë linja brenda qytetit, të ketë linja direkte, e jo kështu që shkojnë nga gjysmë ore 40 minuta prej një pike me mbërri me një pikë tjetër, e cila mund të kalohet për pesë minuta apo apo gjashtë. Ne të plotësohen këto kushte, e pastaj të shohim subvencionimin e trafikut urban. Po, mbi të gjitha, trafiku ndër-urban, apo ajo urban periferik, nëpër fshatra duhet të ketë prioritet. Faleminderit për dëgjim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. I nderuar drejtor, në bazë të nenit 5 janë përfshirë disa kategori. S'po di, në mesin e të gjithë qytetarëve, a ka mbetur ndonjë kategori pa u përfshirë se po më duket këtu të gjithë qytetarët janë të përfshirë. S'di kush ka mbetur jashtë kësaj përfshirje. Jo, edhe asambleistë po më duket janë të përfshirë, s'ka kategori që sa janë përfshirë. E dyta, subvencionimi bëhet me vlerë prej 1.20 cent edhe një sqarim për kilometër. Bëhet për autobus apo për individ, apo qysh është? Për autobus 1.20 cent, apo? Okej. Sa i përket kategorive, po më duket është pak e zgjeruar kjo, se tash kemi me fillu krejt me udhëtu me autobus. Ani atëherë duhet me rritur edhe numrin e autobusave. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Bajram, fjala për ju Petrit Hoxha.

Petrit Hoxha (GUXO): Faleminderit kryesues. Tek neni 5 ku e përcakton kategoritë, se kush duhet t'i shfrytëzojë këto. Unë kisha propozuar që edhe një kategori të futet në këtë, është punëtorët e Ekoregjionit. Të gjithë i dimë të cilët me çfarë rroga punojnë dhe që e mbajnë të vetmit pastërtinë e qytetit, është mirë që edhe këto ta shfrytëzojnë këtë mundësi. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit fjala për ju Shqipe Shatri.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit kryesues. Në kuadër të propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban, kërkoj që të rishikohet vendimi dhe të përfshihen veçanërisht edhe nxënësit dhe studentët nga të gjitha fshatrat e komunës së Prizrenit. Nxënësit dhe studentët nga fshatrat përballen me kosto dukshëm më të lartë të udhëtimit dhe kanë nevojë për mbështetje në transport. Kohëve të fundit, rritja e çmimeve të biletave ka rënduar edhe më shumë barrën familjare, financiare për familjet e tyre. Për shembull, një nxënës apo student nga Lugishta e Hasit apo nga fshati Kushnin që ndjek mësimet apo studimet në Prizren, paguan 5 deri në 6 euro për një biletë kthyesë, një kosto shumë e lartë në baza ditore dhe mujore. I nderuar drejtor zotëri Ukimeri, ju lutem të sigurohet trajtim i barabartë për të gjithë, pa dallim vendbanimi, pasi mbështetja për transport do të lehtësonte ndjeshëm nxënësit dhe studentët që udhetojnë çdo ditë me distanca më të larta. Ju lutem të keni në konsideratë. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zonja Shqipe. Fjala për ju Selman Sokolaj. Le të përgatitet zoti Islamaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Kur jemi te vendimet që merren ad-hok edhe për interesa të ngushta është pikërisht ky vendim në prag të fushatës zgjedhore që pritet me mbajt tash. Mundesh universalisht mos me përfshirë drejtor kategori të ndryshme. Ke përfshirë kategori të ndryshme këtu edhe normal të gjithëkategoritë shoqërore nuk i përfshinë. Mirëpo, një vendim i kuvendit komunal me votu ne edhe me bë ndasi gjeografike kjo është, nuk bën me leju komuna e Prizrenit, qyteti i Prizrenit edhe asambleistët në këtë anë, me ndodhë kjo. Është e tmerrshme me nxjerrë në një vendim që bën dallime gjeografike. Thashë dhe njëherë po them, sa i përket përcaktimit të kategorive që përfitojnë në mënyrë universale, ajo është në rregull. Mirëpo përcaktimi gjeografik jo vetëm me ata përfitues, a jetojnë në fshat a në qytet, nuk ka rëndësi. Po ju po i subvenciononi veteranët e luftës, përshembull, pensionistët, vetëm ata që sillen në qytet, mirëpo ata mund ta marrin autobusin edhe të shkojnë në Kushnin, në Lubizhdë, a përfshihen ata? Në Korishë, në Zhur, në Piran, në Zojz, kudo që është. Kështu që edhe njëherë po them ky vendim se në arsyetimin juaj ajo pjesa që nuk ishte e shkruar aty, ajo është shumë më e rëndësishme. Se ajo ishte arsyetim për diçka që nuk po e bëni. Kështu që kjo asamble, edhe unë po ju propozoj drejtor që këta mos me nda gjeografikisht se sinqerisht është vendim shumë i dëmshëm edhe nuk i bën nder komunës së Prizrenit, që nxjerr vendime të tilla që kanë përcaktim gjeografik. Domethënë edhe për veriun e Kosovës nuk lejohet me marrë kësi vendime speciale, që është një rrethanë e jashtëzakonshme, se leje më për disa vendbanime të komunës së Prizrenit. Edhe drejtor është mirë me u përgjigj me qetësi kështu, jo me dëgju atë zonjën aty afër që thotë mos u përgjigj, mos u përgjigj. Se kjo është arrogancë, është e tmerrshme, është e tmerrshme kjo qasje. Edhe ju lutem na na lejoni ta mbajmë fjalën. Kështu që është mirë me u përgjigj. Edhe i ftoj edhe njëherë asambleistë, jo ju, asambleistë i ftoj mos me ngrit dorën për këtë veprim të turpshëm e nëse më lejohet me thënë, sidomos asambleistët që vijnë nga ato vende gjeografike që po përjashtohen prej këtu. Se është turp! Është turp nëse e ngritni dorën për një vendim të turpshëm. Përndryshe si propozim vendim, prapë thashë, kategoritë universale që janë të të cekura, jemi për, do ta ngritni dorën, mirëpo ndarja gjeografike nuk... Nëse zonja Ymran nuk e kupton çfarë domethënë kategori

universale, mundem me e shpjegu pas seancës, se po më duket ka nevojë për gjëra elementale. Se qytetarëtnuk e dëgjojnë mirëpo anash këto, fliten fjalë të ndryshme, ofendime, kështu që unë ju drejtova zonjës, se qytetarët nuk e dëgjojnë, ata që na shohin neve nuk e dëgjojnë, kështu që ka nevojë e shpjegojmë mbas seancës. Drejtori të kisha lutur singerisht, ju sidomos ju vini prej një një rajoni që e keni e keni përjashtuar vetveten. Ju vini nga Korisha, e keni përjashtuar Korishën nga një vendim që e sjellni përpara. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pasi ju përmend emri. Fjala për ju, Ymrane.

Ymran Fusha (PDK): Se shumë keq po më vjen nga kolegu, se po i xigloj nervat, veç unë vetëm këtë protestë do të bëj në heshtje, le të mendon ai vet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zonja Ymrane. Fjala për ju, Sefidin Islamaj, pasi Arianiti e kërkoj më erët, po fjala për ju.

Sefidin Islamaj (BDP): Faleminderit zoti kryesues. Unë edhe në fjalimin tim të parë këtu në kuvend e kam theksuar se për ngritjen e mirëqenies sociale duhet me mendu seriozisht edhe për nxënësit që udhëtojnë nga fshatrat, për shkollim në qytet. Por si duket kërkush ska dëgju ose s'ka dashur me më dëgju. Edhe sot vjen një vendim që është shumë selektiv, i pabarabartë dhe në mënyrë të qartë le jashtë fshatrat prej këtij subvencioni. Është e papranueshme që nxënësit që udhëtojnë çdo ditë për shkollim në qytet, me mbet jashtë, ku biletat e tyre vetëm për një drejtim shkojnë deri në 2 euro. Kjo është një barrë e madhe për familjarët, sidomos për ata familjarë që kanë më shumë se një fëmijë për shkollim. Në anën tjetër, nëse shohim realitetin politik dhe social në terren, sidomos në fshatra, ky vendim bëhet edhe më pa i arsyeshëm. Vetë partitë që janë sot në pushtet, nga 76 fshatra sa ka qyteti jonë, mbi 80% të këtyre fshatrave kanë dalë fitues. Atëherë shtrohet pyetje shumë e thjeshtë. Si do të arsyetojnë këtë vendim para atyre qytetarëve që janë votuar pikërisht në këto vende. Sidomos ju që vini nga fshatra dhe shumica mbështetje e keni marrë nga këto nga këto vende. Ky vendim, për mendimin tim, duhet me u kthi, me u rishiku dhe me u korrigju, në mënyrë që me qenë i drejtë, i barabartë dhe i qasshëm për të gjithë qytetarët pa dallim. Prandaj në këtë vendim, në këtë formë, nuk e mbështes dhe pres që edhe kolegët e mi me pa realisht situatën dhe mos me e përkrahë këtë qasje. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, zoti Islamaj. Fjala për ju, Arjanit Berisha, se ta mora fjalën më herët. Po vazhdo se është Qemali me radhë, Qemal Krasniqi.

Arianit Berisha (PDK): Do pyetje për drejtorin. Në formë sqaruese, jo pse nuk i kam të qarta për vete, po nashta nuk na i dha sqarimet e mjaftueshme dhe për qato po i ndëgjoj do kritika që për besë po më duken të paarsyeshme. Qeky vendim, ai përjashton banorët e fshatrave mos me e shfrytëzu transportin urban të njëjtën formë apo po e paraqesin qashtu, se nëse ish kanë qashtu, atëherë për njëmend kishte qenë diskriminues. Gjithashtu disa sqarime pak më të gjana se si ky subvencionim i transportit urban e stimulon shfrytëzimin e transportit urban, që ka pastaj disa benefite nga kjo, si ndotja, si krijimi, domethënë zvogëlimi i kolonave e tjera për të cilat besoj që mundesh me na dhënë më shumë sqarime. Dhe t'i thu këtij vendimi domethënë këtij propozimi

nga ana juaj, si diçka e keqe nuk e di nuk po nuk po arrij me kuptu. Drejtor ndoshta do sqarime pak më të mëdhaja duhesh me na i dhënë se qetash kemi nis dhe ne me ra në nivelin që s'jemi tu e marrë vesh çka është ka bëhet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. Fjala për ju, Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Drejtor, unë po të përgëzoj për këtë propozim. Është ide e qëllume. Mos t'i japim tash ngjyra jo katun, jo qytet, mos ni, mos hyni në këto sene. Unë jam vetë katundar, jetoj në katun. E di çka domethënë. Mirëpo njëherë fillohet, fillohet me u zbatuar brenda qytetit, sepse e di që ka shumë nevojë brenda qytetit, po po besoj, po besoj që shumë shpejt ka me kalu edhe në fshatra, sidomos te nxënësit edhe te pensionerët. Kështu që unë përgëzoj për këtë propozim edhe po besoj që kjo është në interes të gjithë qytetarëve të komunës e Prizrenit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Qemal. Fjala për ju Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Unë sinqerisht po habitëm me disa kolegë këtu edhe për hir të korrektësisë disa kolegë të rinj që nuk po e kuptojnë, pak më duhet me ju shpjegu kjo qeveri se çfarë ka bërë me transport. Kjo qeverisje ka hapur thirrje publike për 15 ditë edhe i ka bërë thirrje operatorëve ekonomikë me sjellë 10 autobusë të rinj në thirrje publike. E ato autobusë janë parkuar, pa u kry thirrja publike në një vend këtu afër Prizrenit edhe ja ka dhënë kompanisë të afërt, të cilën pastaj e kemi gjetur që numri i ish-zëvendës kryesuesit ka qenë në ARBK në atë kompani. Halli nuk ka qenë transporti publik, i nderuar. Ani që s'ke qenë drejtor. Halli ka qenë, halli ka qenë qysh mundeni me i dhanë kompanive të juaja të afërta. Tash halli i dytë nuk është që juve fort ju ndinë trafiku e ndotja e ajrit. Me ju ndi, prej administratës deri këtu ecnin këmbë, nuk sorollateni me vetura. Të lutna mos më ndërpre pa mikrofon. Edhe ju lutna secili anëtar i PDK-së, mos paçit guxim me dhezë mikrofonta, mosni pa mikrofonta se s'ju ka hije. Nuk ju ka hije me ndërpre. E para, e dyta, kryesues, a je kryesues? A je vetëm vegël e këtyre ekzekutivit këtu që herë ta çojnë dorën, herë thojnë ndale mikrofonin, herë thotë dilte tema tjetër, a je i vetëdijshëm për rolin tënd i nderuar? Qe, qe a po sheh? Nëse je vegëla e Luljeta Veselaj Gutaj, qite aty, heke kryesuesin, thuaj jam vegëla e Luljeta Veselaj Gutaj. Nëse je vegël i tjetër drejtor, të lutna identifikoj me karakterin që e ke, por nuk je kryesues. A je ti që ai njeri që për çdo veprim të drejtorëve, për çdo ngritje të dorës, ti ose na ndal fjalën, ose del në pikën tjetër, ose mundohesh me ndalë diskutimin. A je ti qaj? Kryesuesja para teje na ka respektuar bile si kuvendar. Të lutna, prej seancës së parë, ju kemi bërë thirrje, na respektoni. Minimalja që mundeni me e bë. Kush është Luljeta ty me të dirigju? Luljeta ka të drejtë me fol vetëm pikat e saj kur e ka sponsorizuar. Kaq! Ju lutem mos i tejkaloni përgjegjësitë që i keni. Edhe respektonani bre. Sa i përket pikës, ju lutem në KPF, thamë mos i bëni ndasi qytetarëve të Prizrenit. Ju po thoni mos bëni politikë. Edhe ai që jeton në fshat paguan taksa, edhe ai që jeton në qytet paguan taksa. Ju këtu një orë u krekoset që s'keni buxhet. Një vit nuk po i paguni nënat lehona, për shkak që nuk keni buxhet, tash ju paska ra në mend për qytetarin edhe xhepin e qytetarit. Është shumë për të ardhur keq. Kallëzoheni qysh tash po i planifikoni me i nda linjat. Unë kam marrë ankesa prej operatorëve të

transportit që nuk po kanë përgjegje me mujë të tëra. Nuk po i jepni qasje në dokumente, nuk po i jepni informata për linja. Për kënd po përgatitet kjo e gjithë kjo tollëvi e madhe. Unë nuk jam kundër subvencionimit, vetëm jam kundër subvencionimit të pjesërisëm. Pse nuk po i bëni për secilin qytetar të Prizrenit? A po dojmë trafikun me ndalë? A po dojmë ndotjen me ndalë? Çka tash? A po i bie që veç ata në qytet që jetojnë po bëjnë ndotje më të madhe, e fshati jo. Unë ju kam bërë thirrje edhe në KPF, njerëzit që më së shumti shpenzojnë në transport, janë ata që vijnë më larg për në qytet. Edhe kjo është ndasi shumë e madhe, është qasje tejte e keqe e një qeverisje që jeni thirrur për gjithëpërfshirje, jeni thirrur për të gjithë qytetarët, jeni thirrur goxha dhe siç është po thirrën disa asambleistë që ne i takojmë një rrethit votuesve dhe ne flasim për ta. Jo, jo, secili qëtu në këtë vend ka të drejtë me folë edhe për fshat, edhe për katund. Edhe për pjesën urbane. Nuk mundeni ju me privatizu me thënë na flasim për fshatra e ju shuni. Unë po ju lus, mos e merrni këto qasje opozitare, është gabim me i diskriminuar një përqindje të madhe të qytetarëve. Nëse e rishikoni edhe njëherë këtë vendim, po ju premtoj në emër të grupit e votojmë këto bashkarisht, unanimisht, por vetëm mos t'i diskriminojmë pjesë të tjera që jetojnë jashtë qytetit. Po ju lus, mosni se është dëm edhe për juve. Unë kam pranuar shumë kërkesa prej KPF-së e deri tash. Janë duke u ndi njerëzit të fymë, janë duke u ndi njerëzit goxha të anashkaluar me këtë vendim. Qëllimi nuk është ajo që ju po aludoni që po reklamoni. Po ju e dini prapë, unë po ju bëj thirrje secilit asamblist e sidomos ata që thirren në emër të fshatrave, ta kenë parasysh çka po votojnë se kjo është në dëm edhe është ndasi tejte e madhe, e këtë Prizreni nuk ish dashtë me e bë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë. Po, po fjala për ju drejtor Levent Bush.

Levent Bus: Tash po foli turqisht se ju më mirë se Dafina e kuptoni. Sayın Dafina hanım bucune kadar yaptıklarını çok isla bileym arkamdan ne yapmışın, sen bir benim için boşver sen biçe baştasın Türk düşmanı oni da unutma. Se Türkler büle açın celır yatırımlar sen konoşorson a toni ne düverisin o fabrikayı da bilersin çok isla cendın da nasıldır. A sen tebüle hareketlerınl en sanaysın çi po en mi kazanısın, sanaysın çi 2-3 arkadaşın ne var Türk mi sen kazanacaksın o poeni, unut buni. Em ne yaptınız seçimlerde çok isla bilerım bana, sensın başta aktör sora bu yanındaçi. Çok isla bilerim ne yapmışınız illa da illa bizi cürsterma kasabada fena ama biz cüstermisık oylarlen size. Anladın mi? Em bundan sonra açın konoşorson bişi faktlari da düver o faktlari da açın angarsın şimdi ben sana düverim da kronolojiyay. Deysın almiş tenderi üle mi Levent Buş'un adi çeçmiş onda ben deym şimdi telefon numresinden dogri mi? Senin meclis üyen buradan aldı mi tender ben sana soraym? Ver cevap çi ona cüre verim cevabi şimdi. Kısa, senın meclis üyen buradan aldı mi tender? Sana soraym, ver cevabi çi verecem cevap sora, evet ya da hayır. Yok ben soraym sana şimdi. Sen kovkmısın düverma bunda ne olacak ne bitecek. Senin varise cidersın Prokuroriaya dersın çi tebüle tebüle olmuştır, em ben şimdi seni verecem prokuroriyaya bakam sora çim çıkacak hâkli. A sensın Türk düşmanı oni bil.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Fjala për ju, Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit zotëri ish-kryesues. Kjo qasje tregon shumë. Domethënë, a donë turqisht? A donë edhe turqisht?

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, fjala për ju është.

Dafina Alishani (LVV): Sa i përket, sa jam dushman i turqve sa nuk jam, populli e di shumë mirë. Mua po më vjen shumë keq që ka kaluar më koha që i etiketoni njerëz kaq padrejtësisht edhe mundoni me fitu ju poena politikë. E mundoni në qafë të këtyre ndasive me mbledh poena politikë. Njerëzit që ju kanë votuar po lypin përgjegjësi, nuk po lypin me ju pa numrat e juaj nëpër kompani që përfitojnë tendera. Unë e thashë, po të kishte marrë tender në rregull, me gjithçka në rregull, sikurse qysh po aludoni që kuvendari jonë paska marrë, atëherë pse nuk e keni ngritur asnjë shqetësim ju? Ky tender ka qenë i kurdisun, i nderuar. Këto po të vjen inati që ka dalë në shesh. Po më vjen shumë keq që ty të ka dalë. Dushmanllëkat, armiqësitë që po i bëni kështu nëpër terren, është shumë për të ardhur keq. Kush është dushman, e dinë shumë mirë qytetarët. Ju që mes veti s'mund po bëheni bashkë, nuk keni nevojë me nxjerrë armiq të rinj. Çka lyp numri yt me një kompani? Çka lypin 10 autobuza të parkum pa u kry, thirrja publike? Për këtë e dashti me dalë me me bë sqarime. A që na voton komuniteti turk mua dhe Ilirit nuk ju kena faj ne. Keni faj ju që s'po mundeni me i përfaqësuar ata qysh duhet. Keni faj ju që po ja merrni votën në emër të turqëzimit edhe nuk po i përfaqësoni këtu. Sa veta jeni këtu, çohet kuvendari thotë turqishtja s'po shfrytëzohet nëpër dokumente zyrtare. Për çka jeni ju këtu? Me më shpallë mua dushman a? A me shpallë dikënd tjetër? Dushmanë më të mëdhenj jeni ju që as gjuhën e juaj s'po mundeni me siguru kur jeni në bashkëqeverisje.Kush do e voton, kënd do e voton. Ju, të njëjti send po bëhet edhe me pjesën e komunitetit turk. Nuk mundeni ju me privatizu votën e turqve. Nuk mundeni me thënë që ne që po marrim vota nga turq, jemi armiq. Nuk është kjo çështja.....Po ju lus, kur shpalosen këto padrejtësi, kur shpalosen këto kurdisjet e tenderve, mbajeni qetësinë edhe mos akuzoni me armiq, edhe mos bëni ndasi sidomos në pjesën turq-shqiptar. Kjo është e e ultë çka po bëni.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju drejtor Levent Bush.

Levent Bus: Për turqinë ose për shqiptarë unë e di shumë mirë edhe flas edhe shqip edhe turqisht mirë. Kështu që për shqiptarë mos më kallëzo mua, sa kam shok shqiptar ose turq. Më shumë e kam shok shqiptar se turq. Unë e kam dëgjuar ty, tash edhe ti dëgjon.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, ky dëgjoi, mundesh me dëgju tash, nuk ndërhyti.

Levent Bus: Se ju kur po vini, jemi Kasabali, ju Kasabalitë që qoni shembull si Selmani me fol për neve, a në anën tjetër ju folni për katundar. Kështu që unë e di krejt ato politika ç'ka bëni ju. Po nuk po më intereson fundi fundit, apo. Këtu është politika juaj, edhe mendimi juaj. Tash në anën tjetër, ti drejtëpërdrejtë mundesh me shkuar për qit rastin prokurori me qit edhe emrin tim, edhe numrin tim, me qit rastin. Në qoftë se nuk bën, atëherë ti s'je Dafina për mua, i pari. I dyti, tash ti smundesh se këta krejt jemi turq këtu. Edhe ne përfaqësojmë turqët këtu. Edhe si drejtor e përfaqësoj, edhe ai si zëvendës kryesues, edhe ai si asamblist. Ti s'mundesh me fol në emër tonë. Se ne e dimë shumë mirë. Kur ka nevojë për gjuhën ose për diçka tjetër, krejt jemi këtu bashkë. Dihet ato. Kështu që ti mos kallëzo neve, sa e përfaqëson ti turq ose na sa po e përfaqësojnë turq.

Simir Krasniqi (Kryesues): Të e marrim përgjigjet e drejtorit se ka koxha shumë.

Selman Sokolaj (LVV): A po bën me tërheq fjalën se e ka bërë një akuzë të rëndë? Apo ju nuk dëgjoni, s'kuptoni? E ka bërë një akuzë të rëndë? A i qëndron a si qëndron?

Levent Bus: Pse çka kam folur?

Selman Sokolaj (LVV): Ky zotëria e ka bërë një akuzë të rëndë. A i qëndron akuzës? Edhe ta përsëritë edhe njëherë ta inqizojmë apo do me tërheq fjalën?

Levent Bus: Për çka?

Selman Sokolaj (LVV): Se ky zotëria, kur ish-kryetari është si është quajtur turk, në krejt fshatrat, unë kam qenë dëshmitar, ky ka shkuar e ka votu bashkë atë parti që ja ka quajtur një qytetar të Prizrenit turk. Është fjala për Mytaher Haskukën. Është quajtur turk, ky ka shku e ka votu një parti që ka ofenduar komunitetin turk. Qaq i përfaqëson turqit zotri Levent Bus.

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtor, fjala për ju debatet i runi për tash në fushatë zgjedhore.

Islam Ukimeri: Po unë dua me ja dhënë përgjigjen se pak a shumë, pak a shumë përgjigja është gati e njëjtë të gjithë që keni bërë pyetjet, përgjigja gati është universale. Se pak a shumë sillte veç me i ndërru pak vende..

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdo. Shkurt, mundësisht e kërkojnë edhe të tjerët, edhe dy orë mbesim këtu në këtë pikë.

Dafina Alishani (LVV): Unë po besoj që më ka keqkuptuar zotëriu, unë nuk thashë që unë përfaqësoj komunitet turq, unë përfaqësoj ata që më votojnë. Këtyre që po i vjen keq, që po marr vota edhe prej komuniteteve të tjera, unë nuk mund me u ndje keq në emër të tyre. Po me dalë në foltore të Prizrenit edhe me i akuzu të dy asambleistët më të votuar në Prizren, si armiq të komunitetit turk, është përbesë me të ardhur keq. Fort po djeg që të ka dalë ky manipulim që e keni bërë, po më vjen keq. Qekjo akuzë është vetëm e vetëm se ju ka dalë në shesh qajo kontratë. Edhe nuk ke mundësi kështu me akuzu, me përgjithësu dy asambleistë, të cilët janë më të votuar në Prizren. Ju lutem, kryesues, pse....?

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë me përgjigjet e drejtorit të shërbimeve publik.

Eldis Abazi (VAKAT): Kryesues, më fal, a kemi ne drejtë me fol, me vetë?

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Eldi Abazi.

Eldis Abazi (VAKAT):

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Eldis. Fjala për jua Onur Kovac.

Onur Kovaçi (KDTP): Farklı bir konu konuşurken Türk toplumundan bahsedildi ve Türk toplumunun temsilcilerinden bahsedildi. Türk topluluğunun temsiliyeti konusunda burada konuşulacaklar Türk toplumunun temsilcileridir. Lütfen bunu konuşurken daha dikkatli olalım.

Bireysel problemleri, bireysel sorunları burada Türk toplumuna atfetmeyelim. Benim demek istediğim budur, vermiş olduğum örnekler ve taleplerim de iki günlük üç günlük beş günlük talepler değildir yıllardır süren dillerin kullanım Yasasının kullanılmasıyla ilgili sıkıntılardır. Bu yüzden lütfen bireysel problemlerimizi Türk toplumuna atfetmeyelim ve Türk toplumunun temsilcileri buradayken de Türk toplumunu bizden daha çok düşündüğümüzü savunmayalım. Teşekkür ederim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Fjala per ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Sinqerisht më vjen keq që jemi dalë në një fushë absolutisht të pa nevojshme në këto marrëdhëniet në këto raportet shqiptarë turq apo shqiptarë boshnjakë, sepse nëse e kemi pasur një vlerë edhe si qytet, edhe si Kosovë është marrëdhëniet ndër etnike që i kemi pasur bashkë në Prizren edhe në Kosovë edhe jemi krenuar me to edhe këtë vlerë duhet ta ruajmë. Kjo dalja në atë fushën e cënimit nacional është gjëja më e ulët me të cilën na duhet me u marrë tash në këtë kuvend. Sa i përket temës në të cilën jemi. Unë vetë dje e kam ngritur zërin edhe kam kërkuar që mos të ketë dallime në mbështetje të kategorive të ndryshme edhe në fshatra edhe në qytete. I vetëdijshëm shumë që mundësitë janë të kufizuara. Unë kërkoja nga drejtori që të parashihet në faza implementimi edhe i fshatrave në mbështetje të këtyre kategorive. Dhe po pajtohem plotësisht me kërkesën, bile edhe nuk deshta me fol me të Agimit, drejtor a mund të na thuash se kur do të jetë faza tjetër e implementimit këtij projekti që ne ta përbylлим në mënyrë çfarë duhet me përbylлим sepse bëhet fjalë vërtetë për një ndërmarrje shumë pozitive, po dallimi sigurisht që nuk na bën mirë. Andaj do të donim ta dinim kur mund të planifikojmë ose kur mund të planifikoni që të implementohet edhe pjesa tjetër dhe të kompletohet i tërë procesi. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Baca Hazis. Fjalën e ka kërkuar Sevil Kazaz. Ne të Ne të përgatitet Sevilaj Hapçi.

Sevil Kazaz (Ythp): Dafina hanıma cevap olarak bu konuya değinmek istiyorum. Biz burda Türk toplumu temsilcileri olarak 2 Müdür, 1 Meclis Başkan yardımcısı, 1 Belediye Başkan Yardımcısı ve 2 Meclis üyesi ile Türk toplumunu temsil ediyoruz. Ha nasıl temsil ediyoruz ona gelince sorgulaması gereken en son insan sensin ve sen bizim buradaki temsiliyetimizi çok iyi bilmen lazım. 3. dönem birlikte bu salonda hizmet ediyoruz ve bizim ne kadar mücadelelerde bulunduğumuzu sen çok yakından şahit oldun bugüne kadar. Bunun bize karşı yaptığın maalesef üzücü atıflarda bulunman bu yüzden özür dilemeni bekliyoruz. Hem bizden... Biz sana genel olarak öyle bir şey demedik onu diyen, tabi ki ona cevap verebilirsin ama sen genelleme yaptın ben o yüzden atladım, genelleme yapma dedim ama sen Türk toplumundan oy alarak bizi bununla suçlayan bu bize büyük bir ayıp bize karşı, çünkü biz de hem Arnavut toplumundan oy alıyoruz hem Boşnak toplumundan oy alıyoruz sonuçta Prizren’de yaşıyoruz. Sizler de Türklerden oy alabilirsiniz yani burada sorun bizim temsiliyetimizin eksikliği değil ki çünkü biz de senin seçmenlerinden oy alabiliyoruz. Burada önemli olan Türk toplumunun temsilcilerine atıfta bulunman, suçlamadan bulunman. Bu yüzden özür dilemeni bekliyoruz. Saygılarımı sunuyorum

bu konuyu çok fazla irdelemek istemiyorum, bu yüzden sizin de zamanınızı aldığımız için bu konuda özür diliyorum, çünkü gereksiz. Teşekkür ederim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala per ju Sevilay Igci Hapçi.

Sevilaz Igci Hapçi (KDTP): Meclis Başkanımız, Müdürlerimiz, değerli meclis üyelerimiz, basın mensupları hepinizi selamlıyorum öncelikle. Bu toplantıda bu tür görüşlerin olması açıkçası hepimizi üzmüştür. Öncelikle Türk toplumu çıkarlarını, dilini savunmak, korumak Türk temsilcilerinin görevidir. Partimizi ve hedeflerimizi karıştırmamamızı temenni ediyorum. Şunu da dile getirmek isterim ki geçtiğimiz günlerde Topluluklardan sorumlu Belediye Başkan Yardımcısı seçimi sürecinde sn. Ilir Gashi öncelikle bu konunun gündeme alınmasına karşı çıkmış ve oylamaya sunulmasını tercih etmemiştir ancak daha sonra siyasi bir yaklaşım sergileyerek Belediye Başkan yardımcısını destekleyeceklerini ve bunu Türk toplumuna duydukları saygıdan dolayı yaptıklarını ifade etmiştir oysa bu durum açık bir çelişkidir tüm toplum tarafından da net bir şekilde görülmüştür. Bu tür tutarsız yaklaşımlarla Türk toplumunun güvenini kazanmayı düşünüyorsanız bunun doğru bir yol olmadığını açıkça ifade etmek istiyorum. Teşekkürler

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Të përgëzoj edhe ty, edhe Levent Bushin, që prej një teme shumë të qartë, shumë konkrete që e kishim, arritët me e deviju. Ai filloi devijimin e ti e lejove. U dash me ndërpre. Kryesues a mundesh me ja dhënë më së pari Arianitit le ta përfundo. Tani unë e marr mbas tij.

Simir Krasniqi (Kryesues):Vazhdoj Ilir.

Arianit Berisha (PDK): Dafina ishte ajo që Dafina filloi devijimin. Dafina filloi me fol për procesin që ne nuk kemi qenë të përfshirë dhe nuk kemi dijeni se qysh ka ndodhur ai tenderimi. Domethënë unë i thashë edhe kryesuesit mbaje në temë se është jashtë temës. Kur të është tema ajo edhe unë do ta kem një mendim timin. Por nuk ishte tema ajo. Tema ishte ky propozimi për subvencionim të transportit urban. Këtu filloi devijimi Ilir! Mo burrë... na respektimi pak.

Ilir Gashi (LVV): Kështu. E përgëzoj Levent Bushin që arriti tamam me atë taktikën klasike të politikanëve të korruptuar. Se kur janë në zor thirrën nacionalizëm e thirrën tema të ngjashme, për me e mbulu vetveten. Kërkush nuk foli kundër askujt. Edhe askush, askush nuk ka të drejtë ekskluzive për me e mbrojtë një komunitet, një entitet të caktuar. Është kushtetuta dhe janë ligjet që e mbrojnë baraz çdo qytetar të Republikës së Kosovës. E tash, me ju vërsul kolegës, Dafinës e bashkë me to edhe mu me u gjujt, është turp, është keqpërdorim i pozitës. E për këtë Levent Bushi duhet me dhënë përgjegjësi. Pse e keqpërdor pushtetin? Qysh mundet një kompani private me pru autobusa të gatshëm, emri i tij me qenë, numri i tij me qenë kontaktues, pastaj me u shpall tenderi, pastaj qajo kompani që është përfshirë në Levent Bushi me fillu, e tash me u subvencionu plus për çdo kilometër, edhe me kthy muhabetin tash në nivel personal, kundër meje edhe Dafinës. Edhe ju kryesues, shuni aty, heshni, ndërpreja fjalën, po del jashtë temës. Në të arsyetohen involvimi e tij. Edhe ky subvencionim, a ka të bëjë me të? Ne të del qaty ne të tregon.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ilir, Dafina ishte ajo e cila doli prej temës dhe e nxori debatin.

Levent Bus: E ka përmendur emrin tim. Kështu që dy fjalë ka me fol. Ju dy muaj më keni sulmuar në kohën e zgjedhjeve edhe thashë morale po të kallzoni çfarë keni bërë. Që më keni sulmuar kam shujtë deri sot. E sot prapë e keni hapur temën ju. Unë s'e kam hapur këtë temën. Ju e keni përmendur emrin tim. Unë s'e kam s'e kam përmendur emrin juaj.

Shukri Quni (BDP): Kryesues, tu ka dhënë vota me mbajtur rendin këtu, pjesa dërrmuese. Tash me thënë që edhe unë kam votuar, se ka qenë votimi i fshehtë. Po kemi marrë goxha vota që me u mbajt rendin këtu dhe mos me dalë prej kontrollit. Unë kam kërkuar drejtor edhe në komitet për politikë e financa, po ashtu edhe Hazizi ke në fillim po dikur u pajtua. Ne kërkuam që në këtë subvencionim për transport që të futen edhe fshatrat. Po ashtu unë i bëra edhe disa pyetje të cilat kanë pyetje pak si të nxehta ju erdhën. Unë e kam kërkuar se cila kompani do ta bëj bartjen e kësaj. Po ashtu, kam kërkuar edhe prej juve se çka do të bëhet me kompanitë ekzistuese. Kështu t'i kam bërë pyetjet aty. Po njëherit edhe për taksistat që punojnë këtu në qytet, çka bëhet për ta, të cilët kur i merr ajo kompani me i baje gjithë qytetarët, ata ngelën edhe pa punë. Pastaj unë i dhashë edhe disa vërejtje të tjera, që ju i keni qit në letër se kush do të përfitojë këtu. Domethënë do të jenë, pensionistët, nxënësit, personat me aftësi të kufizuar, pastaj të dalur nga lufta e kështu me radhë. Unë e kundërshtova këtu që e keni fut ju policinë, ushtrinë, zjarrfikës, punëtorët të arsimit edhe shërbimet civile e kështu me radhë. Domethënë qata të cilët kanë rroga, nuk di për çka me u liruar nga ky udhëtim. Por, propozimi është kështu, i joni. Që të futet një amandament edhe të përfshihet i tërë qyteti edhe fshatrat, që kjo mos bëhet ndarje, por amendamentit i bashkangjitet, t'i propozim vendimi për subvencionimin e transportit urban. Me me siguru edhe Hazizin që figuron edhe kjo. Se Hazizit i ke thënë kemi me me fut, po ne po duam me shti këtu në këtë në këtë propozim-vendim edhe këtë amendament. S'di sa isha i qartë, por besoj që po.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdo drejtor.

Islam Ukimeri: Faleminderit kryesues. Unë ju ngova një orë, tash ngomni, ose po e lë, po dal. Nga e tash ta jap përgjigjen, tani fol për amandament. Prit ta jap përgjigjen, kam me i dhënë 20 përgjigje këtu. Se s'jam te amandamenti besoj. Fillimisht, fillimisht unë e mendova që.....

Dafina Alishani (LVV): A bën bre pak më serioz? Po s'është bre përkthyes, është kuvendar. Po drejtor alla ile ruaje qetësinë.

Islam Ukimeri: Po dhe ti ruaje qetësinë. Unë me të vërtetë me të vërtetë më erdh shumë çudi, që te kjo pikë e rendit të ditës te ky subvencionim.... Edhe po më vjen shumë çudi qysh po arrini me bërë këtë debat. Unë edhe në komitet politik dhe financa e kam shpjeguar shumë qartë. Keni qenë në prezencë aty atje që ishin anëtarë të komitetit politik financa. E kam shpjeguar shumë qartë mënyrën qysh po subvencionohet edhe mënyrën qysh ka me subvencionuar edhe fshatrat. Jo veç një send dua me ja bërë një përgjigje edhe dua me dhënë një njoftim. A e dini ju që nga qeverisja Partisë Demokratike mësimdhënësit udhëtarë janë mbi 10 apo 15 vite mundem me thënë ka mundësi edhe prej 2010-ës subvencionohen të gjithë mësimdhënësit nga fshatrat që vijnë në

komunën tonë në Prizren, që mësojnë nëpër shkolla. Pse nuk ankohen mësuesit e qytetit? Pse s'u çu me thënë mësuesit e qytetit nuk po paguhen, po paguhen vetëm mësuesit e fshatrave. Më fal, nuk paguhen. Unë po foli ata që udhëtojnë, që të gjithë mësime dhënësit që udhëtojnë, që udhëtojnë jashtë qytetit, që shkojnë nëpër fshatra, apo të kundërta nga fshati mësime dhënësi që vijnë në qytet, paguhen. E para. E dyta, të gjithë nxënësit mbi 4 km që nuk ka transport, ka vite e vite që subvencionohen dhe paguhen. Deri në klasën e nëntë domethënë. PDK-ja i ka bërë, ti s'i ke bërë, i ka bërë Partia Demokratike. Emra të përveçëm s'po foli unë, i ka bërë Partia Demokratike. Okej, ne po i po i shtyjme përpara, faleminderit që e keni bërë, faleminderit. Bile s'paku ne ju falenderojmë kur e bëni një.... Faleminderit shumë, ne po ju falenderohemi për punën që e keni bërë. Unë shumë mirë e shpjegova kur dola në foltore, që subvencionimi i fshatrave, derisa të përgatiten përgatitjet teknike, subvencionimi i fshatrave ka me u bërë, edhe këtë vit dëgjimet buxhetore ka me bërë planifikimi edhe për fshatrat që edhe transporti nga fshatra të subvencionohen. Po janë disa parakushte që të përgatiten, për arsye që edhe ata të kanë mundësi të bëhen identifikim me kartela dhe të krijohen mundësitë e transportit modern. Tjetra, sa i përket shfrytëzimit të transportit urban në qytet që bëhet pa pagesë, qysh po mund me thënë keni bërë ndarje apo një farë, qysh me thënë ndarje gjeografike mos gabofsha e dëgjova, s'po duhet me i përmend emart e asamblistëve, që thuhet ndarja gjeografike fshatra qytet, ku qai transport urban, në qoftë se një vëlla i im, po e marr shembull të prej meje, një vëlla i im me se u përmend shumë edhe fshati im. Një vëllai im prej Korishës vjen në Prizren, zbrit në Bazhdarahanë, që është student, e shfrytëzon urbanin pa pagesë, shkon në fakultet. Apo një prindër i imi që vjen nga Korisha në atacion të autobusave, ka me shkuar bërë analizat në spital, e shfrytëzon transportin pa pagesë me shku në spital. Qysh është diskriminim ky, s'po mund me dit qysh ma ka mundësi me ma shpjegu qysh është fjala apo ndarje gjeografike apo diskriminim fshat dhe qytet. Transportin urban e shfrytëzojnë të gjithë pa dallim, nuk domethënë a është i fshatit, aty nuk lypet identifikimi, a je i katunit, i fshatit apo i qytetit apo i lagjes. Këtu shfrytëzohet të gjithë, ata kanë të drejtë ta shfrytëzojnë transportin urban brenda qytetit. Ne jemi tu përgatit dhe mbasë dakordimeve që i kemi edhe si politikë, edhe si qeverisje, edhe si asamble, shumë shpejt, kur të bëhen dëgjimi buxhetore këtë vit, kemi me bërë planifikimin 2027, 2028, 2029 që të hyjë në buxhet edhe subvencionimi i transportit në fshatra. Nuk është diskriminim as largim. Kemi me subvencionuar dhe transporti në fshatra. Sa i përket transportit, nuk po dua me ofendu askëndin, po mund deri nesër mëngjes me ju shpjegu, se vetë punoj që 25 vjet me këtë punë. Ndërsa, pyetja tjetër që me u bërë, po, te punëtorët e Ekoregjionit. Gjithsesi, faleminderit shumë. Duhet të hyjnë edhe ata, se normal që është e nevojshme. Mandej, masat që faktikisht numri e kategori që do të hyjnë, me mund unë krejt qytetin e kisha bërë gratis free. Në krejt vendet e Evropës subvencionohet transporti brenda qytetit, në krejt vendet e Evropës. Besoj që shumica juaj krejt keni dalë nëpër Evropë, keni familjarë dhe transporti në qytet subvencionohet për shkak që nuk munden me mbijetu. Mandej u folën edhe shumë tema këtu, se ne kur e kemi bërë shpalljen publike, transportin në qoftë se nuk ka me u subvencionuar, se ka mundësia është shumë e bëhet kostoja e mbajtjes linja, nuk janë linja rentabile. Për atë arsye edhe subvencionohet transporti. Kur një linjë nuk është rentabile, duhet patjetër subvencionohet. Po nuk është emër i përveçëm, se ne e kemi shpallur, tri herë ka bërë thirrje publike, dy herë faktikisht, është hera e tretë

tash, dy herë ka bërë thirrje publike komuna Prizren, në këtë rast drejtorja e shërbimeve publike, që të aplikojnë, nuk ka aplikuar askush. Herën e tretë tash kemi një aplikant. S'di pse po thoni është bërë ndonjë orientim apo është bërë ndonjëfarë klan apo ndonjë organizim apo ndonjë ndonjë ndonjë si me thënë atë përgjigje. Tri herë, hera e tretë është që është fituar tash, ndërsa dy herë nuk ka aplikuar askush për shkak të kostove. Dhe unë besoj shumë që ju duhet me qenë falenderues dhe duhet me qenë shqyrt që njëherë mbas luftës po bëhet subvencionimi i transportit urban në qytet edhe besoj që unanimisht duhet me votu. Nuk duhet me bë politikë për këtë punë. Faleminderit shumë.

Bajram Kastrati (LDK): Kryesues, a bën veç një sqarim prej drejtorit? The që mbi 4 km organizoni udhëtimin e nxënësve. Po, se kemi disa kërkesa që janë.

Luljeta Veselaj Gutaj: Dëgjo, i nderuar, e dinë shumica e kuvendarëve, ata që janë marrë me fushën e arsimit dhe që kanë fëmijë të cilët të udhëtojnë. Të gjithë fëmijët të cilët janë në arsimin parauniversitar deri në klasën e nëntë, do të thotë ju garantohej me ligj, me udhëzim administrativ secili që kalon mbi katër kilometra subvencionohet i sigurohet transporti nga ana e Komunës. Në këtë rast nga ana e Drejtorisë së Arsimit. Dhe kjo bëhet ndërvite, nuk bëhet prej kohës kur unë jam drejtuueshë, po bëhet prej kur udhëzimi është në fuqi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po fjala për ju Agim Muçaj.

Agim Muçaj (AAK): Faleminderit kryesues. I nderuar i them unë edhe me fillim e përgëzoja iniciativën edhe qëllimin edhe është më se e duhur ky vendim edhe jo me një duar, por me dy duar do të votoj. Po nuk më përgjigjet saktë, nuk më përgjigjet saktë. Kur është plani dinamik nga firma dhe nga ju, kur do të fillojnë fshatrat domethënë të futen në këtë proces që t'i gëzojnë këto benefite të udhëtimit. Du, jo të lutem, e përmende me rishikim buxhetit 27, 28, 29. Ti mund me shkua në 2040-ën ashtu. Të lutem, du një plan dinamik, kur komuna në bashkëpunim me këtë kompani fillon vitin 2027, 28 së paku ta dinë. Edhe në ta dinë të gjithë fshatrat, ata nxënës kush presin. Të lutem, unë desha një përgjigje për këtë. Faleminderit.

Islam Ukimeri: Faleminderit kryesues, Agim po ta jap shkurt përgjigjen. Sa i përket datës edhe kohës, po them shumë të drejtë, unë e kam elaboruar edhe apat e përsërita në komitet dhe politikë dhe financa, se shumë fshatra në pjesën tonë ka gravitojmë ne, nuk ka transport fare. Për atë arsye unë dola edhe thashë që ne jemi duke bërë përgatitjen, dhe kam çdo send që është e nevojshme që më së pari t'i sigurojmë transport, mandej të bëjmë suvencionimin. Planifikimi i buxhetit këtë vit, që faktikisht kur bëhen dëxhimet buxhetore për vitin 2027 se nuk mundemi me bë nesër. Të jemi shumë të sinqertë, a kupton? Kur të bëhet planifikimi i 2027-ës, që i bjen vitin e ardhëm, nuk është 2040-a. Në momentin që planifikohet këtë vit për suvencionimin edhe fshatrave, hyjnë në buxhet, votohet dhe vazhdon me suvencionim. Kaq është.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Shukri Çuni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues. Për me bë rehat edhe kolegun Agim Muçaj, unë propozova koleg, në fakt propozuam, një amendament që përfshin tërë qytetin dhe fshatrat. E jo të bëhet kjo ndarje, zotëri kolegu Agim Muçaj. Propozova që ky amendament i bashkangjitet këtij propozim-vendimi për subvencionim të transportit urban. Dhe kjo të qitet dhe të votohet Agim. Nëse dojmë me fletë rehat. Nëse nuk dojmë, këta kanë me thënë kur ta rishikojmë...

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë, atëherë shkojmë shkojmë me propozimin e Shukri Qunit që t'i shtohet edhe një amandament që të përfshihen edhe fshatrat. Të pranishëm jemi?

Arianit Berisha (PDK): A mundem, a mundem të paktën një tekst me ditë çka jemi tu propozu, çka përfshin aj amandamenti? Tekst i saktë, ta dëgjojmë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përveç subvencionimit brenda qytetit shtohet edhe një nen aty që të subvencionohen edhe fshatrat. Drejtori e dha shumë mirë sqarimin që vitin e ardhshëm do të futet edhe kjo pjesë, por ne hedhim votim. Sa jemi prezent?

Agim Muçaj (AAK): Një sekond, një sekond, ne po pajtohemi për një të mirë që jemi duke bë për qytetin dhe për rrethin, edhe përnjëmend ndamje nuk duam. Mirëpo me të vërtetë asgjë nuk ka që kjo të qitet votim, asgjë të keqe s'ka, të futem votim. Ne të gjithë po e shohim që jemi duke bërë diçka të mirë. Të lutem.

Simir Krasniqi (Kryesues): 33 jemi të pranishëm. Me propozimin e Shukri Qunit që të shtohet edhe një amandament.

Selman Sokolaj (LVV): Zotëria tha shumë mirë në terminologji a mundet me përsërit edhe njëherë? Seriozisht e kam, shumë e tha mirë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po mund tash zyrtari ligjor, Arbër.

Arbër Krasniqi : Përsëritet të nderuar anëtarë të kuvendit. Në këtë rast la Shuk e dha një propozim që duhet një amandament për me ju shtu transportit urban, domethënë quhet urbano periferik. Tash në këtë rast, ky amandament në fillim hidhet në votim nga prej kryesuesit. Nëse donë anëtarët e kuvendit me inkorporu këtë pjesë mirë, nëse jo, atëherë hidhet në votim propozimi qysh ka ardhur prej drejtorisë shërbimeve publike. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Sa jemi të pranishëm? 33. Sa jemi pro që të futet ky amandament propozimi i Shukri Qunit? 16 për. Kundër? Nuk ka. Abstenime... Arbër, mundësisht edhe njëherë sqarime.

Dafina Alishani (LVV): Kryesues votimi u krye, vazhdojmë pikën tjetër. U kry votimi krye ishim në proces të votimit u votuan për, disa heshtën disa abstenuan, kaluam vazhdojmë pikën tjetër urime edhe fshatrave edhe qytetit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Astrit Temaj

Astrit Temaj (LDK): Kryesues a bën edhe një sqarim se e kemi pasur paqartë këtë pikë a bën një sqarim prej Arbërit saktë edhe njëherë për procedurën sepse e kemi pasur të paqartë. Nuk e kemi pasur të qartë, faleminderit.

Arianit Berisha (PDK): Arbër, a mundesh edhe një sqarim përveç këtyre, kur konsiderohet një vendim i kaluar?

Arbër Krasniqi: Përshëndetje të nderuar, amendamenti të cilin e dha Shukri Quni, ka kaluar se i ka marrë 16 vota për, pa vota kundër. Po, është pjesë e propozimit vendimit. Tash hidhet në votim komplet dokumenti me këtë ndryshimin, tash hidhet në votim komplet dokumenti me propozimin.

Arianit Berisha (PDK): Kryesues, veç e kam edhe një paqartësi, prej zyrës ligjore. Qysh konsiderohet i kaluar një vendim kur nuk e ka shumicën e anëtarëve prezent? Ose unë jam gabim, një sqarim kur konsiderohet i kaluar një vendim?

Arbër Krasniqi: Përshëndetje të nderuar, vendimet e kuvendit të komunës kalojnë me shumicën e anëtarëve të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë. Në këtë rast të pranishëm ishin 33, kanë votuar për 16, disa ishin abstenime. Ky vendim ka kaluar. I ka marrë votat e nevojshme të anëtarëve të kuvendit dhe ka kaluar, pa vota kundër. Domethënë nëse kishin qenë 17 vota kundër, atëherë nuk kishte kaluar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Tash duhet të votohet me propozimin e Shukrisë. Tash a kalon apo s'kalon është çështje që duhet...

Islam Ukimeri: Më falni veç edhe një herë një sekond ta shpjegoj, se po më duket ju po doni e marrë meritokraci dhe po doni që ju e doni katundin më shumë se ne. Nuk qëndron fare kjo. Po nuk i qëndron se ata kur kanë deshtë katundin e kanë ditur kur e kanë deshtë që 15 vjet e po e doni ju sot. Ne më duket shumë qartë edhe unë kam shpjeguar shumë qartë që nuk është tu u bë diskriminim apo jena t'i largu fshatrat. Në këtë radhë kanë me u subvencionuar transporti urban brenda qytetit. Me ndërgjimet buxhetore të marrë këtë vit, në 2026, për 2027, 2028 dhe 2029, do të hyjnë në buxhet edhe subvencionimi i fshatrave, që i bjen që nga viti i ardhshëm ka me subvencionuar dhe fshatrat. Nuk e di pse po e bëni, po mund të bëni, ju kisha lutur, mos bëni politikë në këtë rast këtu, në foltore, veç për poena politikë, keni se po e doni fshatin, keni se jeni për fshatin. Duhet mepër të gjithë qytetarët. Edhe subvencionimi i transportit brenda qytetit nuk është as për qytetar, as për fshatar, po i të gjithëve. Kanë të drejtë me shfrytëzu të gjithë. Atë të drejt atë benefitet e kanë edhe fshatrat. Faleminderit shumë. Edhe tash votimi bëhet edhe me atë amendament, por ne këtë e kena shti, ashtu ashtu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë, drejtor, tash erdhëm në votim me amendamentin e Shukri Qunit, që a kalon apo nuk kalon vendimi? Po tash komplet me amendamentin e Shukri Qunit e hedhim në votim. Tash a i merr votat a s'i merr është çështje që do të votohet? Sa jemi për që

komplet të votohet pra vendimi me amendamentin e Shukri Qunit? 34 jemi prezent. E shoh që nuk e kanë të qartë, një takim me shefat e grupeve nuk e kanë qartë.

Dafina Alishani (LVV): Jo jo jo, midis procesit të votimit po e ndalni procesin a? Po e ndalni a? Po u votu për. Kush është kundër, kush është abstenim edhe kryhet? Amendamenti u votu kryesues.

Simir Krasniqi (Kryesues): Duhet të votohet komplet vendimi.

Dafina Alishani (LVV): U votu kryesues. Kryesues. je tu e shkel ligjin kryesues edhe je tu e keqpërdorur detyrën kryesues.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pesë minuta pauzë me shefat e grupeve.

Dafina Alishani (LVV): Midis votimit jemi, Arbër, midis votimit jemi. Kemi votuar për, ju lutna, ky proces ka shkelje. Nuk mundeni në proces të votimit me dalë në pauzë. Është për të ardhur keq çfarë deregje keni ardhur? Je në proces të votimit, kryesues,

Simir Krasniqi (Kryesues): E shoh që nuk e kanë të qartë.

Dafina Alishani (LVV): Jo, jo, je në proces të votimit, Amandamenti kaloi me 17 vota. Të tjerët ishin në sallë, por nuk morën pjesë në votim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pesë minuta konsultë me shefat e grupeve, është fut amandamenti i Shukri Qunit. Pesë minuta konsultë me shefat e grupeve.

Shukri Quni (BDP): Po me qenë ky amandamenti jem, qysh po mendoni ju, krejt duhet me votu. Edhe ata çka janë atje në ekzekutiv. Ma leni ato pallavera për Zotin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pesë minuta kërkova. Pesë minuta kërkova konsultë me shefat e grupeve.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë, sa jemi prezent në sallë? 33 jemi prezent. Kalohet në procesin e votimit, e hodhim në votim me propozimin e Shukri Çunit që të futet edhe amandamenti pra, që të përfshihen edhe fshatrat. Sa jemi për pra që komplet me propozimin e Shukri Çunit që të futet edhe amandamenti? 12 për. Kundër? 17 kundër. Abstenim? Abstenim nuk ka. Atëherë nuk kalon kjo pikë e rendit të ditës, sjellet në seancat e radhës pra pika e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Ftojme iniciuesin e pikës, drejtoreshën e arsimit që ta bëjë prezantimin e pikës. Fjala për ju, drejtoreshë.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit shumë kryesues. Të nderuar kuvendarë, derisa të krijohen kushtet. A më vazhduat?

Agim Muçaj (AAK): Kryesues, më falni një sekond, kamerat ekzistojnë. Unë për e çova, pastaj kundër, dy herë nuk numërohet vota ime.

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo jo. Është anuluar ai vendimi, nuk ka ecur përpara, në seancat e radhës vjen. Vazhdojmë me ju drejtoreshë.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit kryesues, të nderuar kuvendor, në bazë Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, e ligjit nr.03/L-40 për vetëqeverisje lokale, neni 14, paragrafi 8, pika 8.1 e rregullores nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes së emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publiko-edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar, si dhe neni 27 paragrafin 1 të Statutut të Komunës së Prizrenit, numër 01/011-5643 të datës 15 tetor 2008, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren i propozon Kuvendit të Komunës së Prizrenit të merr vendim për formimin e komisionit për zgjedhës, për testimin dhe intervistimin e kandidatëve në konkursin i cili do të shpallet sipas afatit ligjor për pozitat e lira për drejtor, zëvendës drejtor në institucionet publike edukativo-arsimore në komunën e Prizrenit. Komisionet kanë këtë përbërje. Komisioni i parë ka përbërjen zyrtar i arsimit në drejtorinë e arsimit, zoti Nexhat Maçkaj, ekspert e pavarur i arsimit, Afërdita Çollaku dhe një anëtar i cili propozohet nga Ministria e Arsimit sipas nenit 14, paragrafi 8, pika 8.2 të rregullores që e potencova më herët. Komisioni i dytë përbëhet nga zyrtarja e arsimit zonja Hagjere Gavazaj dhe eksperti i pavarur i arsimit profesor doktor Shemsi Morina nga Universiteti i Prizrenit dhe anëtar i tretë poashtu propozim nga Mashti. Si dhe komisioni i tretë përbëhet nga anëtarët e komuniteteve Ferdi Kovaç zyrtar në drejtorinë e arsimit Alija Biliban ekspert i pavarur i arsimit dhe një anëtar nga Mashti. Detyrat, përcaktimin e detyrave përbëhet sipas rregullores të cilën e potencova në fjalë. Kërkoj mbështetjen e juaj për votim për anëtarët e komisionit lidhur me legjislacionit sipas legjislacionit në fuqi. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoreshë. E hapim diskutimin që do dikush me marrë fjalën. Po Sevilay Hapçi, fjala për ju.

Sevilay Igci Hapçi (KDTP): Egitim Müdürlüğü bünyesinde oluşturulan seçim komisyonlarında sürecin şeffaf ve topluluk haklarına ve saygı çerçevesinde yürütülmesi adına bazı hususların açık şekilde düzenlenmesi gerekmektedir. Bununla birlikte çoğunluk topluluğuna yönelik gerçekleştirilen komisyonlarda çoğunluk topluluğunu temsilen yetkililerin yer alması, azınlık topluluklarına yönelik seçimlerde ise ilgili topluluğu temsilen yetkili kişilerin seçim komisyonlarında bulunmasının sağlanması, topluluk haklarının korunması açısından büyük önem arz etmektedir. Özellikle Türk topluluğuna yönelik Müdür, Müdür yardımcıları ve öğretmen seçimlerinde, seçim komisyonunda yalnızca Türk topluluğunu temsilen yetkililerin yer alması gerekmektedir.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Dikush tjetër do ta merr fjalën? Dafina Alishani, fjala për ju.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Përse i përket përzgjedhjes apo komisioneve të kaluara, ne kemi pasur një eksperiencë të keqe, po prapë po dua me ju falenderu që tash nuk i keni dhënë hapësirë trixaxhiut të famshëm në komunën e Prizrenit. Është për të ardhur mirë që keni reflektuar në kërkesat tona të vazhdueshme. Por, këtu një ekspert të pavarur të cilën e keni propozuar në listë, unë nuk besoj që është i pavarur, meqë ka afërsi shumë të afërta me kryetarin e komunës, ku edhe herën e kaluar e kam e kam potencuar që zotëri Bilibani ka afërsi shumë të mirë me kryetarin, edhe kam frikën që do të ketë ndikim politik drejtpërdrejtë, edhe nëpër zgjedhjen e drejtorëve, edhe të zëvendës drejtorëve, ku do të ishte mirë që mos me ndiku' politika, po meqë keni propozuar atë, unë prapë në emër të opinionit publik dua t'i sqaroj qytetarëve që këtu nuk është ky anëtar i pavarur. Domethënë këtu ju mundeni me emëru' si anëtar të pavarur. I keni emëruar edhe më herët edhe trixaxhiun si anëtar të pavarur e profesionist të pavarur. Kemi dëgjuar se si kurdisen konkurset. Kështu që nuk ka ndryshuar diçka shumë, vetëm emrat kanë ndryshuar, por roli edhe detyra e tyre është po e njëjta, me i shërby pushtetit edhe me i instalu personat politik në shkollat publike, gjë që është totalisht kundër asaj që ju keni premtuar edhe si drejtori edhe si kryetar i komunës. Andaj Lëvizja Vetëvendosje nuk ka votë për këtë komision.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë pra, do dikush tjetër fjalën? Atëherë që nuk ka? Fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Po. Faleminderit. Qeky komision, gjithë kur kemi votuar... e din ti kryesues çfarë ka heq Mytaheri me komisionin për përzgjedhjen e drejtorëve, katër vjet. Në rast se dikush ja ka pru ndonjë sëmundje atij, ne ja kemi pru, katër vjet. Edhe s'un e ka shti në rend dite. Po këto më mirë e din Sulltani kur ka qenë kryesues ai, ti ke qenë shef i grupit të Partisë Demokratike. Andaj mos i harroni disa gjëra, të cilat ja kemi trasu punën dhe ju kemi pruar deri këtu. Duhet do sende mos me i harruar të mirat. Unë po habitna kur po thoni ju tash, se në disa shkolla është katastrofë. Qysh bre? Kurrigjë mos u njohtë qeveria e profesorit doktor Ramadan Muja, ka me u njohur për shkolla. Shtatë shkolla i kemi ndërtuar në Has. Shkolla në Nashec, në Atmaxhë, Kobaj, mos të hyjë më rend, janë mbaruar kohën kur unë kam qenë PDK dhe kryetar ka qenë Ramadan Muja, drejtor Nexhat Qoqaj. Mos i harroni këto. Mos shkoni vetëm ju që keni bërë diçka. Me bë me hy te arsimi tash, kush ka fëmijë në shkollë, ai e di qysh është. Kur po i lavdoj disa, po i vjen egër. Ndjesë pastë, Ridvan Hoxha, kur ka qenë drejtor i mjekësisë, kush ka pasur fëmijë atëherë, tanë kanë kryer fakultete. Po duhet ta lavdoj edhe Shaip Budurin kur ka qenë drejtor i gjimnazit, çfarë rendi ke pasur e çfarë pune. Andaj, edhe kur i jap lavdatat, merrni për lavdata. Po edhe vërejtjet duhet me i marrë për vërejtje. Se goxha do vjet i kam qetu dhe të gjitha këto i kam përcjellur. Si keni mbërritur ju këto! Këtu i keni marrë të gatshme të gjitha. Këtu më vjen keq për disa asambleista që nuk janë në rrjedha, edhe duhet me pyet pak. Kur e them te komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve, ju ka pru në pushtet mos harroni. Mytaher Haskukës nuk ja kemi votuar,

komisionin për përzgjedhjen e drejtorëve, komisionin për përzgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, bashkësive lokale, hartat zonale edhe buxhetin nuk i ka kalu, ti vetë ke qenë këtu. Duhet pak me mendu qysh kanë qenë gjendja më herët dhe qysh është sot. Pse po i merrni kaq me hez sendet? Pse nuk ndalni me diskutu për shembull? Ne jemi për këtë. Edhe kuvendi deri në 12 parnat mbrëma punoj, edhe kurgjë se gjeti hiç. Edhe ne kur të kemi çështje me rëndësi duhet me i diskutu këto. Qeky komision nuk po e shoh që ka datë të caktuar. Ne gjithë i kemi votuar për një vit. Tash nëse unë se unë e kam pa mirë, atëherë është mirë dikush me më thënë që ekziston, për sa ka me funksionu ky komision? Për një vit, për gjashtë muaj? Ta kemi të qartë çka po votojmë. Se nuk është e thënë tash sikur parës, u çuan do votuan, do jo. Jo se di çka votova se çka nuk votova. Nuk është në rregull.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju drejtoreshë, mundesh me ja dhënë sqarim Shukri Qunit.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit kryesues, i nderuar zoti Quni, ashtu siç jam qartësuar dhe në komunitetin për politikë e financa, tanimë pas ndryshimit të udhëzimit administrativ dhe hyrjes në fuqi të rregullores së re për përzgjedhjen, për procedurat të përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve ndryshon edhe mandati i komisionit përzgjedhës. Pra, mandati i komisionit përzgjedhës përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatëve në pozitat e kërkuara në konkurs sipas paragrafit 14 të rregullores për procedurat që janë për përzgjedhje. Pra, udhëzimi i cili ka qenë në fuqi më herët, ka qenë mandat për një vit shkollor, kurse tani fillon me legjitimitetin, me kthimin e ligjshmërisë nga ministritë e linjes, hapjen e konkursit dhe përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar me rezultatet për grup pozitat e caktuara. Sa i përket zonjës Hapçi, do të thotë këtu Rregullorja nuk përcakton, nuk bën ndasi, as për komunitete, po flet në të përgjithshmen për anëtarët e komisionit. Megjithatë ne kemi pas në konsideratë edhe në të kaluarën dhe tani dhe kemi një komision i cili merret me procedurat e komuniteteve, të cilat i kemi në shkollat tona. Është edhe zyrtari Ferdi Kovaç, i cili e përfaqëson në mënyrën më të mirë të mundshme komunitetin turk, po i mbron edhe i përfaqëson edhe i mbron edhe punon edhe për komunitetin boshnak. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoreshë. A kemi diskutues të tjerë? Atëherë që nuk kemi e hedhim në votim pra pikën e rendit të ditës. Sa jemi? 30 jemi prezent, kemi kuorum. Kush është për? 22 për. Kundër? 3 kundër. Abstenim? 1 abstenim. Atëherë miratohet propozim vendimi për formimin e komisionit përzgjedhës të DKA-së.

Kalojmë me pikën e radhës.

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit të veprimit për transparencë 2026-2030, sipas kërkesës së MAPL-së.

E kemi iniciuesin e pikës, këtu mund të na sqarojë pra në detaje. Fjala për ju, zoti Ymer.

Ymer Berisha: I nderuar kryesues, unë normalisht e kam kënaqësinë kur flas me audienca të ndryshme, me ato vendimmarrëse edhe më shumë. Ministria e administrimit të pushtetit lokal edhe

komuna kanë një gjuhë. Kërkesa është me i rrit shërbimet pro qytetarëve dhe me i ofruar shërbime cilësore sa më shumë që është e mundur. Plani i veprimit për transparencë 2026-2030, në faqen 13 e tij është bërë një lëshim nga numri 15 për shqyrtimin e ditëve të akteve administrative, ka kaluar në 30. Kështu që në faqen 13 të planit të veprimit bëhet ky ndryshim dhe sot vjen me këtë ndryshim. Meqë na u dha mundësia që ministria kërkoi me bë këtë ndryshim edhe ne normalisht si grup punues u ulëm edhe njëherë me i pa disa analiza të cilat e rrisin politikbërjen ose vendimmarrjen e komunës e Prizrenit. Lidhshipi i komunës së Prizrenit normalisht ka përkrahje të plotë që qytetarët janë të barabartë me ne, por në këtë mandat ne e kemi mundësinë për të vendosur për ata me vendimmarrje dhe dëshirojmë që Komuna e Prizrenit të jetë e hapur në 360 shkallët e vendimmarrjes së tij. Domethënë, gjithë politikat publike, gjithë vendimmarrjen edhe si proces, edhe si vendimmarrje, edhe ta konsultojmë audiencat që i targeton ajo politikë publike, po edhe ta publikojmë. I dëgjova disa zëra edhe për gjuhët, premtoj këtu publikisht se jam udhëheqës i këtij degasteri. Normalisht që kemi numër jo të mjaftueshëm të përkthyesvën departamentin e përkthimeve, por i kemi tre zonja shumë të respektuara dhe të nderuar, të cilat vërtet bëjnë maksimumin që të gjithë kërkesën që e ka komuna e Prizrenit për ta përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhën boshnjake, gjuhën turke, jemi tu i munduar me bë, pastaj e kemi dhe gjuhën romë në përdorim zyrtar, kështu që komuniteti rom kur na adresohet si një dokument ka nevojë për përkthim edhe në gjuhën romë, ne gjejmë mundësi ta bëjmë përkthimin edhe në këtë gjuhë. Nëse i qasemidashmirësisht kësaj vendimmarrje dhe kësaj politike publike. Nëse dojmë t'i qasemi me tendenca të caktuara, tendencat nuk i mbyllim as për veten tonë. Keni pa kanë njëherë kur dalim para pasqyrës, ka raste kur s'na pëlqen vetja, bëjmë përpjekje maksimale për ta rregullu, po kanë herë i mbrijmë rezultatet kanë herë jo. E lejmë mo kur dalim në politikbërje ose në vendimmarrje. Kështu që unë kam kënaqësinë edhe normalisht dhe falje që për herë të dytë nga seanca e kaluar në këtë seancë kërkoj mbështetjen tuaj, por po them jemi tu punu natë edhe ditë me të vetmin qëllim. Të gjithë jemi të barabartë dhe të gjithë duam politika publike që u shërben familjes së qytetarëve të komunës së Prizrenit pa asnjë dallim fare dhe plani i veprimit është i tillë. Domethënë ju mundëson edhe boshnjakëve edhe turqve edhe shqiptarëve edhe zonave rurale edhe këtyre urbane që ta thonë fjalën e tyre për politikat publike të komunës dhe bashkë strukturojmë drejt arritjeve të reja. Ndaj në fund kërkoj votë nga të gjithë kuvendarët që janë të pranishëm në këtë seancë. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Ymer për sqarime. A kemi diskutime? Po, mund të ulesh Ymer këtu që fjala për ju Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Zoti Berisha nëse më lejon kryesues e kam një kërkesë unë një lutje të singertë. Ju kur kryesues mund ta shikoni veten në pasqyrë edhe tek atëherë i nxirrni balancën e veprimeve. Kështu që ju kisha lut singërisht të jeni në kryerje të detyrës që ua cakton ligji edhe ju kanë dhënë asambleistët. Deshta me ngrit një çështje drejtor, për shkak se para se me ndërmarrë një veprim edhe po flas shumë singërisht nuk besoj që njerëzit që nuk e dinë çka po votojnë me na dhënë neve leksion çka po flasim. Ish zëvendëskryesuesi, drejtori aktual i financave dhe ekonomisë e ka bërë një akuzë të rëndë ndaj asambleistes tonë Dafina Alishani.

Rregulli e do kryesues, beso ki durim dëgjo. Rregulli e do që para se unë me shku me ja bë një kallëzim penal për nxitje të urrejtjes dhe përçarjes ndër-etnike për shkak se e ka quajtur armike të turqve, i kërkoj atij zotërisë me kërku falje edhe me tërheq fjalën e para. Faleminderit shumë për këto e pata që ma dhe mundësinë me u shpreh në këtë formë. E dyta zoti Berisha zbatimi i planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e komunës.... Planit do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumente strategjike, vendimet e kryetarit nuk po vazhdojmë më tutje, po po ndalem te vendimet e kryetarit. Ne si asambleistë jemi dëshmitarë që ka minimum tre seanca që kryetari i komunës së Prizrenit, pa një arsye të caktuar në këtë rast as nuk mund të ketë arsye për shkak se kryesuesi i thirr seancat brenda rregullave ligjore qysh parashihet edhe ka kohën e mjaftueshme që të planifikojë aktivitetet e tjera. Kryetari nuk vjen, nuk na përgjigjet neve, nuk i përgjigjet as qytetarëve. Nuk e ushtron njërin prej detyrave që me qenë këtu prezent në asamblenë komunale edhe me i ndejt kërshi kërkesave dhe çështjeve të ndryshme të cilat i ngrisin kuvendarët. Në këtë rast sjellja e atij në praktikë edhe ato dokumentet që ne po i miratojmë edhe zotimet që po i japim, a munden me pas diskrepancë? Faleminderit.

Ymer Berisha: Do të thotë komunikimi institucional nuk e nënkupton praninë fizike me patjetër. Kryetari i komunës e kemi nënkryetarin para meje ishte këtu, e ka për detyrim nga pozita por edhe kryesuesi nga pozita që ushtron e ka për detyrim ta njoftojë me gjithë të folurat që janë këtu pozitën e kryetarit pa emër edhe mbiemër të përveçëm. Kështu që, a do ishte e preferueshme prania fizike? Po! A do të mundet plani i veprimit me e garantu që e bjen? Jo! Domethënë se plani flet vetëm për të drejtat që unë i kam. Por po them kryetari i komunës informohet për gjithë të folurën në komunë përmes më shumë se sa një burimi. Jo nënkryetari, kryesuesi, pastaj jam edhe unë këtu herë pas here kështu që e ka i fundit. Faleminderit për kontributin Selman.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Ymer. Atëherë kalohet në proces të votimit. Sa jemi prezent? 20 e 21 jemi prezent. Kush është për? 18 për. Kundër? 0. Abstenim? 0. Atëherë miratohet pika e tetë e rendit të ditës, miratimi i projekt planit të veprimit për transparencë 2026-2030 sipas kërkesës së MAPL-së.

Kalojmë në pikën e nëntë.

Rraporti financiar për periudhën janar-mars.

Drejtor jemi te raporti financiar ju apo Lulzimi do ta bëni prezantimin? Atëherë fjala për ju.

Levent Bus: I nderuar kryesues, nënkryetar të nderuar, drejtor, kuvendar, media. Sot do të prezantoj raportin tremujor të drejtorisë për ekonomi dhe financa. Shpenzimet për periudhën janar-mars 2026 të sektorit për buxhet dhe financa, janë si në vijim. Buxheti i përgjithshëm është 75.428.618 euro. Shpenzimet deri sot janë bërë 27.856.010 euro. Domethënë jemi me përqindje 37%. Të hyrat e përgjithshme janë si në vijim. Planifikimi është 11.365.876 euro. Të hyrat janë deri në sot 1.848.645 euro. Në përqindje vjen për afërsi 16%. Raporti tremujor i zyrës për

regjistrimin e bizneseve për periudhën janar-mars 2026 janë regjistruar gjithsesi 268 biznese të reja. Janë që regjistruar 24 biznese dhe janë modifikuar 18 biznese. Raporti tremujor i sektorit për tatimin në pronë për vitin 2026 janë planifikuar të shpërndahen rreth 35.000 fatura për tatim në pronë. Planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë për vitin 2026 është 4.260.045 euro. Inkasimi deri më tash është bërë 645.000 euro. Domethënë vjen 15%. Edhe janë shpërndarë gjithsesi 5.000 letërkujtesa, vërejtje për mospagimin e borxhit të tatimit në pronë. Deri në sot prej përmbauesit i kemi që ka marrë përafërsisht 13.767.018 euro. Prej mallrave të shërbimeve është 1.428.902 euro. Prej kapitaleve është deri në sot 12.338.115 euro. Nëse duhet diçka e kemi edhe ZKF-në, këtu që mundet me na dhënë përgjigje edhe unë jam gati.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Atëherë e hapim debatin. A ka pyetje dikush? Po, Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues a i kam pesë minuta më duket? Ta shfrytëzoj maksimumin se kanë mos durim me qëndru në seancë disa kolegë, e ata janë të zgjedhur për me qëndru në seancë edhe munden mos me qëndru nëse nuk ju rrihet. Po besoj është krejt normale. Mirëpo nuk do ta zgjas shumë edhe të kisha lut kryesues sinqerisht do të kisha lut, ne mundemi me vazhdu me fol po kur të ka kështu anash gjuajtje, me ja tërheq vërejtjen se sidomos prej sodit nuk e shoh më për të madhe se nuk po e dinshin çka po votojnë këta. E kryesuesi i kuvendit komunal tash e kam një pyetje për drejtorin. Nëse më lejon, nuk ke.. ja përsëris, nëse nuk më lejon nuk ja përsëris atë që e pata. U kry në rregull. Ndërsa tash pyetjen e kam. Tash e kam pyetjen e muj me informu gojarisht për çka deshta, ajo ke shumë e sinqertë, shumë serioze çka kërkova unë, po kryesuesi po thotë që e ke konsumuar atë të drejtë. Prej 13.000.000 eurove që janë marrë prej përmbauesit, drejtor a i kemi të cekura ndoshta na kanë ikë, nuk i kemi vërejtur saktësisht sa nga obligimet kontraktuale të kontratës kolektive edhe sa nga bizneset e ndryshme për shkak se jemi dëshmitarë që edhe bizneset punët që i kryejnë në komunën e Prizrenit, për shkak të mungesës së mjeteve financiare të komunës i inkasojnë edhe në formë të dhunshme që quhet përmes gjykatave përmbaimore. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): A ka dikush tjetër ndonjë pyetje? Jo, atëherë po Arianit.

Arianit Berisha (PDK): Një replikë të shkurtër kryesues. Është një thënie filozofike edhe i i ndan njerëzit në tre kategori. Thotë janë të mençurit që pyesin po edhe dinë. Thotë janë gjysmë të mençurit që nuk dinë po pyesin nga pak. Edhe janë ata të tretët që s'po du me i përmend që as nuk dinë, as nuk pyesin. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit a ka dikush tjetër?

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues a ju drejtu dikujt zotëria?

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo s'ju ka drejtu.

Selman Sokolaj (LVV): A okej domethënë domethënë e pat për grupin e vet. U kry. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë kalojmë në pikën e radhës që nuk kemi diskutime.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale stacioni i autobusëve shoqëria aksionare Prizren sipas kërkesës së ministrisë së ekonomisë.

Kjo pikë e rendit të ditës unë e di që është shtjelluar debati. Ministria e ekonomisë materialin ja u kemi përcjellë me kohë. E keni parë se ku janë rekomandimet e tyre, ku duhet të veprojmë ne. Neni katër që ne e kemi cek aty dhe neni pesë që për kompensimin e ndërmarrjeve e aksionarëve do të kujdeset ndërmarrja publike. Ata e kanë parë në kundërshtim me ligjin për ndërmarrjet publike dhe ligjin për shoqëri tregtare. Po këtu kemi kërku një këtu kemi kërku një sqarim prej ministrisë së ekonomisë dhe financave ku disa komunave të njëjtin vendim ta marrë shembull komunës së Fushë Kosovës ja kanë aprovuar ligjshmërinë, kurse neve na kanë kthyer që të largohet ky nen dhe ne e kemi largu këtë nen edhe vendimin e keni, materialin e keni, përgjigjen e ministrisë e keni. Nuk kemi se çka diskutojmë, mund ta hedhim në votim këtë propozim-vendim. Që kemi ndonjë diskutim? Po është shtjerrë debati në këtë pikë.

Selman Sokolaj (LVV): Po veç duhet me me cekë që edhe për këtë pikë kur ka qenë koha e kemi thënë mendimin të cilin e ka dhënë edhe ministria e linjës përkatëse. Kështu që faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nuk është dhënë se këtu është shembulli më i mirë. Prishtina ka 10 ndërmarrje publike. Prizreni ka dy ndërmarrje publike, por ne e kemi marrë modelet e komunave të tjera dhe më herët se si ka shkuar kur një komunë i selekton, ajo është çështje e ministrisë. Ne do ta marrim rekomandimin edhe vërejtjen e ministrisë. Vendimi është me ndryshime pra që është kërku prej ministrisë edhe e hedhim në votim. E di që jeni lodhur po po e përfundojmë edhe dy pika i kemi mund edhe pak durim edhe e përfunduam. 23 janë prezent. Atëherë kemi kuorum. Kush është për? 20 për. Kundër? 0. Abstenim? 0. Atëherë miratohet pika e 10 e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e 11. Edhe kjo është po e njëjta vetëm për kompaninë rajonale pra EkoRegjioni.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale Eko Regjioni shoqëria aksionare Prizren.

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe këtu i njëjti ndryshim është bërë te neni katër dhe pesë. Atëherë që nuk kemi diskutime e hedhim në votim. Sa jemi prezent? 23 jemi prezent. Kemi kuorum. Sa jemi për? 20 jemi për. Kundër? 0. Abstenim? 0. Miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

E kemi edhe një pikë pra në fillim ju thashë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e dhe caktimin e komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit për trashëgiminë kulturore të qendrës historike të Prizrenit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Siç ju thashë ne para dy muajve këtë pikën kur ka kaluar këtu në kuvend kemi pasë kërkesën e ojqt-të por nuk ka pasë interesim. Emrat e tyre i kemi marrë dhe të dy anëtarëve të ojqt-të dhe nesër sot e fusim këtë pikë të rendit të ditës në kuvend. Materialin para seancës ja u ndamë kopjet fizike çdokush cv të personave të cilët kanë aplikuar. Pra personat përbërja e këtyre anëtarëve përbëhet nga pesë anëtarë siç ju thashë, tre anëtarë nga shoqëria civile të propozuar janë Valon Xhabali, nga ojqt- ec ma ndryshe, Fatmir Menekshe edhe Katarina Kajtazi. Anëtarë nga kuvendi pra duhet të propozohen dy. Po fjala për ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Dy herë dy radhazi kam qenë anëtar në këtë komision edhe me sa më kujtohet, nëse nuk jam gabim përfaqësuesin e shoqërisë civile e propozon kryetari e vjen si emër, nuk votohet këtu në në kuvend. Unë sa e mbaj mend nuk votohet në kuvend. Ai vjen gati edhe nga ekzekutivi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Në bazë të konsultimeve me zyrtarët ligjorë, se ky vendim shkon në MAPL, ju thashë në fillim kemi pasë problem që nuk ka pasë interesim nga shoqëria civile. Do të thotë kemi pritur kur kërkesat janë shumë të mëdhaja. Atëherë na duhen edhe dy anëtarë të kuvendit që të votojmë bashkarisht. E marrim propozimin nga Partia Demokratike.

Arianit Berisha (PDK): E propozoj kolegën Dea Gavazaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dea Gavazaj, propozohet nga Partia Demokratike. Vetëm një sqarim. A të shkojmë me grupet parlamentare? Në qoftë se shkojmë me grupet parlamentare atëherë duhet të hyjmë në votim për secilin apo me koordinim që dy kandidatët të jenë. Atëherë nga Lëvizja Vetëvendosje a ka? Nuk ka. Nga Lidhja Demokratike? Nuk ka. Nga komuniteti turk?

Onur Kovaçi (KDTP): Türk Toplumundan da bu komisyonda birinin yer alması olacak ben kendimi öneriyorum Onur Kovaçi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Onur Kovaçi. Mirë atëherë po përfundojmë, le të jetë i komuniteteve boshnjakë dhe turk. Këta janë emrat, po i votojmë në tërësi pra. Nga shoqëria civile Valon Xhabali, Fatmir Menekshe, Katarina Kajtazi. Nga kuvendi komunal Dea Gavazaj dhe Onur Kovaçi. Sa jemi prezent? 23 jemi prezent. Sa jemi për? 21 për. Kundër? 0. Abstenim? 0. Atëherë miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Këtu e mbylлим seancën dhe shihemi në seancat e radhës. Ju faleminderit për vëmendje.

**Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e Rregullt e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Datë: 02 qershor 2026.

Filloi në ora: 10:00.

Vendi: Salla për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në “Shtëpinë e Bardhë” - Prizren.

Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë të Kuvendit të Komunës: Simir Krasniqi – Kryesues, Adem Shabanaj, Adrit Krasniqi, Agim Muqaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj, Alban Bislimaj, Albulena Balaj Halimaj, Arianit Berisha, Astrit Temaj, Bajram Kastrati, Dafina Alishani, Daut Panikaj, Dea Gavazaj, Drita Qenaj, Dzengis Saliji, Eldis Abazi, Endrit Zogaj, Haziz Hodaj, Ilir Gashi, Liridona Veçgishiti, Mergiton Gavazaj, Mimoza Memaj, Nazife Kokollari, Nerimane Pllana Gashi, Onur Kovaçi, Petrit Hoxhaj, Qemal Krasniqi, Sefidin Islamaj, Selman Sokolaj, Sevil Kazazi, Sevilay Igci Hapçi, Shqipe Shatri Çoçaj, Shukri Quni, Tefik Tarashaj, Trëndelina Kastrati, Ymran Fusha, Zikreta Aliti.

Munguan: Driton Sallauka, Karanfil Haxhillari, Sulltan Badalli dhe Zgjim Kryeziu.

Pjesëmarrës të tjerë ishin: Nënkryetari i Komunës z.Kujtim Gashi, drejtorët e Drejtorive komunale, zyrtarë komunal, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Simir Krasniqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë po fillojmë. Përshëndetje të nderuar anëtarë të kuvendit, i nderuar nënkryetar i komunës zoti Kujtim Gashi, të nderuar drejtorë të ekzekutivit, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile dhe ju të pranishëm. Përshëndetje për të gjithë. Urime drejtoreshë emërimi në pozitën e re drejtoreshë e pronës dhe tatimit, ju uroj suksese dhe punë të mbarë. Për sot pra është thirrur mbledhja e pestë e rregullt e kuvendit të Komunës, konfirmojmë se të pranishëm jemi 30 anëtarë të kuvendit, kemi kuorumin për ta zhvilluar punën e kësaj mbledhje. Fillojmë me pikat e rendit të ditës që janë përgatitur për ditën e sotme, të cilat pikat e rendit të ditës janë shqyrtuar dhe rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa për seancën e rregullt pra për këtë mbledhje. Rendi i ditës është ky: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 30 mars 2026, shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës, pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për subvencionimin e transportit urban, shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit, shqyrtimi dhe miratimi i projekt planit Komunal për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Prizrenit 2026-2028, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e rregullores së punës e kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe pika e fundit informatë mbi gjendjen e barazisë gjinore dhe realizimin e objektivave të strategjisë komunale për barazi gjinore 2024-2026 në Komunën e Prizrenit.

Kalojmë tek procesverbalet, te pika e parë.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 30 mars 2026.

Dua t'ju informoj se disa nga fjalimet e komuniteteve nuk janë pranuar nga zyra e përkthimeve, në momentin që i pranojmë ato fjalime, do t'ia bashkëngjisim procesverbaleve. Nëse ka prej juve ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth procesverbaleve, e hapim diskutimin. Atëherë, e hedhim në votim procesverbalet me fjalimet e komuniteteve joshumicë, kur t'i pranojmë. Sa anëtarë të kuvendit? 32 anëtarë të kuvendit jemi të pranishëm, kemi kuorum. Kush është për miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së rregullt të datës 30 mars 2026? 31 për. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Atëherë miratohet pra pika e rendit të ditës, procesverbalet.

Pika e dytë. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

Para se të fillojmë rendin e ditës, a kemi ndonjë propozim, ndonjë pikë të re. Po, fjala për ju, shefi i grupit të Partisë Demokratike, Arianit Berisha.

Arianit Berisha (PDK): I nderuar kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar drejtor, të nderuar kolegë kuvendar, kam një propozim për një pikë shtesë për rendin e ditës. Ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001/011-52028 datës 30 prill, është vendim që ka të bëjë me bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026. Kjo kërkesë ka të bëjë me ndryshimin e nenit tre dhe vjen për faktin se në fund të vitit 2025 është ekzekutuar gabimisht një shumë nga përmbaruesi në vlerë prej 53,320.37 euro dhe kjo shumë më pas është kthyer në llogarinë e komunës. Informata për këtë shumë të ekzekutuar

gabimisht, ka ardhur me vonesë në drejtorinë e financave dhe kjo shumë i takon të hyrave nga Drejtoria e Shëndetësisë. Prandaj me ndryshimin e këtij neni, kjo shumë që është e Drejtorisë së Shëndetësisë do të bartet për nevoja të Drejtorisë së Shëndetësisë, ndërsa dy shuma të tjera do të zbriten për shumën që e ceka. Për më shumë, nëse kjo veç futet në rendin e ditës, Drejtoria e Financave do t'i bëjë arsyetimet shtesë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. A ka diskutues të tjerë? Atëherë, e hedhim në votim propozimin e pikës shtesë pra nga shefi i grupit parlamentar të PDK-së. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001/011-52028 datë 30 prill 2026 për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026. Konstatojmë se të pranishëm jemi 32 kemi kuorum të mjaftueshëm. Kush është për? 19 për, kundër? 5 kundër. Abstenim? Nuk ka. Atëherë miratohet pika e rendit të ditës që kjo pikë t'i bashkëngjitet rendit të ditës si pikë e nëntë e rendit të ditës. Po fjala për ju Arianit.

Arianit Berisha (PDK): Kërkoj vetëm nga administrata që propozimin ta shpërndajë te të gjithë kuvendarët.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Atëherë e hedhim në rendin e ditës prapë me pikën shtesë, prapë pikën e nëntë. Propozim vendimi pra për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001/011-52028 datë 30 prill 2026 për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat të vit në afërtë vitit 2025 në vitin 2026, si pikë shtesë pra, si pikë e nëntë e rendit të ditës. Po.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Ne në seancën e kaluar e kemi diskutuar këtë pikën të cilën e keni sjellë përsëri. Është çështja e subvencionimit të transportit urban po ashtu kemi pasur edhe amandamentim nga kuvendi edhe është diskutu, janë shtjellë të gjitha mundësitë ose mendimet e kuvendarëve. Nëse ka mundësi edhe njëherë me na tregu, risjellja e kësaj pike, a ka ndonjë ndryshim? A është marrë parasysh ndonjë kërkesë e kuvendarëve? Apo është vendim i njëjtë me idenë e njëjtë të cilën shumë prej neve i kemi dhënë mendimet edhe i kemi thënë që nuk është mirë me e sjellë në këtë mënyrë. A vlen amandamentimi i cili është votuar në kuvend në seancën e kaluar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Është pikë e re kjo Dafinë edhe atë ditë e konsultuam pra në Komitet për Politikë dhe Financa dhe e diskutuam për këtë pikë që është pikë e re dhe është futur në rendin e ditës.

Dafina Alishani (LVV): Kur thoni pikë e re, a ka ndryshime në këtë pikë apo është e njëjta si është diskutuar në seancën e kaluar? Nëse kuvendi e ka rolin kryesor në vendime edhe në votime unë nuk po e kuptoj pse vjen vendimi i njëjtë përsëri. Kuvendi e tha fjalën e tyre.

Simir Krasniqi (Kryesues): Propozuesi pra e ka prurë pikën e re dhe ne e kemi futur në rendin e ditës dhe kjo pikë pra është ju ka përcjellë edhe materiali edhe atë ditë e kemi bashkarisht pra në

Komitetin për Politikë dhe Financa, më duket e kemi shtjerrë debatin për këtë pikë, nuk kemi se çka, e drejta e juaj është që ta votoni rendin e ditës apo mos ta votoni me këtë pikë që është këtu.

Dafina Alishani (LVV): Propozimi im është me heq këtë pikë nga rendi i ditës.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë, atëherë është propozimi, e hedhim në votim këtë propozim. Atëherë, përveç propozimit shtesë pra që u fut në rendin e ditës si pikë e nëntë, propozimi i Dafina Alishanit nga Vetëvendosja është që pika e katërt, shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban të largohet nga rendi i ditës. Të sqarohemi këtu. Sa jemi për që kjo pikë e rendit të ditës të largohet pra nga rendi i ditës? 32 janë prezent. 10 jemi për sa jemi kundër që kjo pikë mos të largohet nga rendi i ditës? 22 jemi për që kjo pikë të mbetet në rendin e ditës. A kemi abstenim? Nuk ka abstenim. Atëherë, pika e katërt, pra, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për subvencionimin e transportit urban mbetet në rend të ditës. Atëherë, e hedhim në votim komplet rendin e ditës me propozimin shtesë të shefit të grupit të kuvendarëve, me pikën nëntë. 32 jemi të pranishëm, sa jemi për rendin e ditës? 22 për. Kundër? 7 kundër. Abstenim? Nuk ka abstenim. Atëherë miratohet rendi i ditës me pikën shtesë pikën e nëntë pra nga shefi i grupit të Partisë Demokratike Arianit Berisha.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 30 mars 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit komunal për ri integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Prizrenit 2026-2028;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit;
8. Informatë mbi gjendjen e barazisë gjinore dhe realizimin e objektivave të strategjisë komunale për Barazi Gjinore 2024–2026 në Komunën e Prizrenit;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-52028 i datës 30 prill 2026, për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026

Kalojmë në pikën e tretë.

Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.

E hapim diskutimin. Po fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë kolegët kuvendarë, media, qytetarë. Unë kam një pyetje, një çështje me e ngrit për drejtorinë e arsimit lidhur me mos

organizimin e manifestimit tradicional java Remzi Ademaj, shtigjeve të lirisë. Është një shqetësim që njëkohësisht kërkoj sqarim lidhur me mos organizimin e këtij manifestimi tradicional java Remzi Ademaj, sepse ky manifestim organizohet që nga viti 2002. Kur ju disa ndoshta dhe nuk keni qenë ende me kuptu se çfarë roli ka ky manifestim. Po mos të hyj unë tani te historiku, po pyetja domethënë është kërkesa ime sot apo si çështje me e ngrit, pse ky manifestim nuk është organizuar për të 24-tën herë, domethënë ky manifestim që dy dekada domethënë mbi dy dekada që organizohet. Pastaj në përgjigje kam ende çka me fol, për rolin e manifestimit e për rëndësinë e tij. Besoj që ka këtu, kur kanë qenë nxënësit që kanë marrë pjesë në atë kuiz, besoj që është dikush prej asamblistëve këtu. Për Drejtorinë e Inspektoriatit, ka thënë që ka me dhënë përgjigje, po as me shkrim, as me gojë, po njëherë kjo edhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, shqetësim është për ndotjen e rrugës së fshatit Nashec, që shkon në Prizren-Nashec është fjala për ujërat e zeza, pasi nuk qenka drejtoresha këtu, është drejtori i Shërbimeve Publike, sepse i takon domethënë Drejtorisë e Shërbimeve Publike rrugët me i mbrojtë edhe me i rregullu. Të nderuar përfaqësues, kjo çështje që po e ngris nuk është për herë të parë, ky është një problem fatkeqësisht që po vazhdon ende dhe është shumë shqetësues për banorët e lagjes Jeta e Re apo rruga për Nashec. Kjo është një kërkesë edhe e atyre banorëve se këtë çështje e kam ngritur edhe më herët domethënë pastrohen gropat septike prej oborrit dhe qiten në rrugë drejtor, është e njoftuar edhe inspektorati, policia dhe krejt, dhe s'janë duke marrë masa. Të shtunën e kam pasur mbledhje me atë lagje, nesër kanë me ju ardhë juve, ju vjen një delegacion prej 5 veta, 10, sa vinë tash nuk e di, kanë me paraqit prapë këtë problem, është problem shumë i madh. Unë ju kam dhënë edhe një propozim pasi ne paguajmë ujin e pijës, që është 57 cent metrin kub. 19 centë e paguajmë për kanalizim. Si rast urgjent, ata duhet me shku me ja pastru ato gropa e jo me na i qit ata në rrugë dhe në asfalt. Aty ku hudhen ato fokale apo fëllim ne i thojnë, aty ka fletë edhe asfalti u prish edhe rruga, drejtor. Nuk di çka duhet me përdorur në këtë kuvend kur njeriu e ngrit një çështje edhe nuk jep përgjigjësi askush. Për planin B nuk po flas, se ka me mbajt mbledhjen edhe në Nashec dhe në Grazhdanik, se krejt ato fshatrat qaty pari kalojmë ne. Ka shumë raste kur dëgjoj që e kanë fillu me qit aty në rrugë, sidomos kur bie në shi edhe natën, unë shumë herë shkoj ose nga Atmaxha ose nga Kobaj e Grazhdaniku, e Vlashnja e vijë në Prizren. Ne jemi në zor aty, aty ka me u shfaq edhe ndonjë sëmundje epidemi ka me shfaq. Tash llogariten kur pastrohen gropat edhe hudhet në rrugë ajo flliqësi ta quajmë kështu me marrë vesh dikush, se nuk e di a janë duke marrë vesh se çka po flas. Nesër i keni ata banorë, atë delegacion në kuvend të Komunës te ju drejtor edhe te drejtoresha edhe me marrë masa për këtë, me u zgjidh ky problem. A me ja zgjidh me hap ndonjë kanal, a me ndërtu kanalizimin, ajo duhet me u largu prej atje, në rrugë nuk bën me u qit më. Pse nuk o qit deri tash nuk e di, pesë-gjashtë muajt e fundit jemi në zor për këtë punë, ku e kanë lënë më herët këta nuk e di unë, ky problem duhet me u zgjidhë. Drejtori shërbime publike kam bërë një kërkesë po edhe ju kam dërguar edhe foto, është e nevojshme një mur 50 m gjatësi mur mbrojtës edhe 1.80m thellësi në vendin e quajtur te gurrat e Suzisë është për me u mbrojt mos me u shemb dheu nga uji. I ke parë edhe fotot, më ke thënë që do ta rregulloj, po tash te dera m'i këpute shpresat krejt, the edhe nuk e bëjmë. I forti nuk e bën, tash keni mbërri fuqi edhe ju çka s'bani. Drejtori Gjeodezi dhe Kadastër se nuk qenka këtu, më tha mundesh me ardhë në drejtori për me u konsultu me disa prona është

fjala për në Nashec, vendi quhet Mriz i Suzis. Numri i parcelës 01082-0 010101-0 domethënë janë këto të dyja, po më tha, mundesh me ardhë tha atje tha dhe besoj që e sqaron, se është këto kërkesa pronë e kujna janë ato, pronë shoqërore, pronë e pylltarisë apo pronë private. Drejtori i bujqësisë në Nashec tash shterret Drini edhe ka nevojë aty për spërkatje për mushkonja edhe për insekte. Drejtori, ish-drejtori Bexhat Bytyqi ka marrë vota në Nashec sa ka mujt për këtë. Po shumë e vërtetë është, se e ka kryer me sukses e ka kryer, jo ndoshta për hatër tem, po i ka ky edhe atje i ka do miq, po e ka kryer këtë punë ka bërë shumë mirë. Edhe ti i merr vota, se i keni ju të LDK-së keni në Nashec goxha disa vota, duhet me kthy krytë edhe nga ne andej. Drejtori i bujqësisë, çka është problemi për gjahtarët? Në të gjitha vendet e Kosovës dalin në gjah, në Prizren është e ndaluar. Ne paguajmë tatim, mirëmbajtje të armëve plus kur ta vazhdojmë armën duhet patjetër me shku në shoqatën e gjahtarëve me marrë një vërtetim se përndryshe nuk na vazhdojnë lejen e armës për gjah. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. A hiç s'u bë me ju dhënë atyre bylbylave të Nashecit që sa vjet është një shoqëri kulturo-artistike, njëherë kjo Komunë me u falenderu se ish-drejtori e di pse, se atij i kam bërë shumë herë mirë, e thotë një fjalë popullore ai të mirën s'din me ta kthy, po ta kthen me të keq, po ty s'kam bërë mirë asnjëherë, e kam prit që mos po e merrni parasysh edhe këtë shoqëri. Tani çka është aty më e mira që një vajzë e udhëheq, një profesoreshë e ardhshme e artit, e kulturës, e traditës. Domethënë edhe ju na kishit gjujt anash. Kam ende po, e pashë që minutat të gjitha kanë shkuar, më falni kolegë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Disa herë u mundova ta ndaloj se tetë minuta llogarit 41 kuvendar. Faleminderit atëherë për pyetjet që i bëni. Po fjala për ju Shqipe Shatri.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit i nderuar kryesues zoti Krasniqi. Fillimisht më duhet t'ju uroj bashkëvendëses time zonjës Vjosa Duraj pozitën, suksese dhe punë të mbarë. Edhe unë fillimisht ju drejtohem Drejtorisë Komunale të Arsimit. E nderuara drejtoreshë zonja Veselaj Gutaj, vitin e kaluar, të mos gaboju në muajin shkurt, Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur konkursin për bursat e studentëve të komunës së Prizrenit. Meqenëse tani jemi në muajin qershor dhe ende nuk është shpallur konkurs për bursat e studentëve, kërkoj nga DKA që të na informoj studentët me këtë çështje. Kur pritet të shpallet konkursi? Me gojën plot e them se studentët tanë janë ndër vlerat më të mëdha që ka Komuna e Prizrenit. E di që këtij pajtimi jeni edhe ju, që përkrahja e tyre nuk është vetëm ndihmë financiare, por edhe investim në të ardhmen e Komunës sonë, si dhe motivim për gjeneratat që vijnë. Faleminderit në mirëkuptim. Gjithashtu më duhet t'ju drejtohem edhe Drejtorisë së Emergjencave dhe Sigurisë. I nderuar drejtor zotëri Arifi, duke qenë se jemi në prag të stinës së verës, kur temperaturat e larta rrisin ndjeshëm rrezikun e zjarreve, kërkoj nga Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave të shqyrtojnë mundësinë e instalimit të hidrantëve me ujë në disa fshatra të Hasit. Konkretisht në fshatin Gorozhup, Planej, Kushnin dhe Lugisht e Hasit. Konsideroj se vendosja e hidrantëve në pika strategjike të këtyre fshatrave u'a lehtëson punën ekipeve të zjarrfikësve për reagim më të shpejtë e më efikas në rastet e zjarreve. Ju faleminderit në mirëkuptim dhe vëmendje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zonja Shqipe. Fjala për ju Agim Muqaj.

Agim Muqaj (AAK): Faleminderit kryesues. Përshëndetje ekzekutiv, kuvendar, qytetarë të nderuar. Unë edhe sot kam dy kërkesa pa u fut në ato kërkesat ambicioze për investime, po kërkesa vlenë së pari për drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, ku edhe në mandatin e kaluar kam pasur si kërkesë ku shumë banorë të fshatrave përreth Komunës së Suharekës, kanë problem me pronat e tyre që nuk i kanë listat poseduese nuk kanë mundësi as të ndërtojnë apo të bëjnë ndonjë shit-blerje edhe jo vetëm përreth Komunës së Therandës apo Suharekës, po mendoj se kjo është e njëjta gjë është edhe me Komunën e Rahovecit. Kjo drejtori duhet të jepë një sqarim dhe a ka ndonjë afat, kur do të rregullohet ky problem? Se shumë banorë kanë problem për jetën e tyre, dikush kërkon që të ndërtojë shtëpi, nuk e ka pronën me listë poseduese të rregulluar dhe kjo është një kërkesë e qytetarëve që mendoj se me urgjencë duhet të trajtohet dhe të jepet një sqarim për opinionin. Kërkesa e dytë është për drejtorin e financave, paraprakisht në seancën e kaluar kam bërë një pyetje për një sqarim. Sigurisht ajo kërkesë ka qenë se me ligj është e rregulluar që invalidët dhe familjet të dëshmorëve ndër vite kanë akumuluar borxhin dhe a jemi të liruar apo s'jemi të liruar që së paku të fillojmë ta kryejmë obligimet, sepse unë jam vetë ai përfaqësuesi që kam përfaqësuar këtë kategori lufte ndër vite më parë. E kam thënë, çdo herë janë trajtuar mirë, kanë marrë të gjitha benefitet apo mundësitë që kanë pasur pranë komunës se kanë shfrytëzuar, mirëpo borxhi është akumuluar. Duhet ta dinë e gjithë kjo kategori, a janë të larguar nga këto taksa apo jo. Kështu që drejtor, më keni thënë se do të merrni përgjigje, e kërkoj këtë përgjigje, së paku kjo kategori, këto familje ta dinë a janë të liruar apo le të fillojnë t'i kryejnë obligimet e tyre. Sigurisht se për kërkesa më ambicioze të investimeve kam mjaftueshëm, do të vazhdoj, por mirëpo për një kohë të caktuar i gjithë elektoratit të aleancës i kërkoj falje, se edhe qytetarëve të nderuar se mbas informatave që ka marrë nga shumë kryetarët të Aleancës, të cilat udhëheqen nga Aleanca, sepse nga kjo qeveri e cila është duke na udhëhequr, ka bërë shumë bllokada të buxheteve të kuvendeve Komunale dhe derisa të rregullohet kjo çështje, unë nuk do të kem asnjë kërkesë për investime kapitale apo subvencione të cilat kanë vlerë të madhe. Ju falënderoj, dash Zoti që të ndryshojë gjendjen në përgjithësi në nivel Kosovë që edhe Komuna e Prizrenit dhe gjithë qytetarët e Kosovës t'i përfitojnë benefitet të cilët janë kërkesa imediate për jetën e tyre. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Agim Muqaj. Fjala për ju Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Një çështje që dua ta ngrit ka të bëjë me arsimin, është çështje për drejtoreshën e arsimit në Komunën e Prizrenit. A mund të na sqaroni raportin apo pozicionin e trikaxhisë së Prizrenit Arben Shala në Drejtorinë Komunale të Arsimit, për shkak se kohët e fundit kemi parë raportimin nga media që ai është person përgjegjës për zgjedhje të drejtorëve. Kush është ky person? Nga e ka ky person atë fuqi, ku e merr ky person këtë besim nga ju si Parti Demokratike edhe si drejtoreshë, i cili është edhe në audio inqizim që tregon qartë e ke me zë dhe figurë, duke treguar qysh përdoren trikat për të përzgjedhur drejtorët, domethënë duke anashkaluar çdo rregullativë ligjore. Për më shumë afërsia juaj me atë person është më shumë se zyrtare, ju shihni me të si subjekt politik edhe në mbledhje ndryshme, në ndeja të ndryshme. Kështu që qytetarët edhe drejtorët që pretendojnë ta marrin një pozitë me meritë në shkollat të Prizrenit, kanë të drejtë të marrin një përgjigje nga ju për raportin që e keni me trikaxhinë Arben Shala. E

pata edhe një çështje për kryetarin faktik të Komunës së Prizrenit, zotëri Gashi, mirë që është kthyer, tash ndoshta me letra, për shkak se ajo kuklla aty naltë që na ka mbetur emri i shkruar, ka muaj të tërë që nuk po vjen, mirëpo ai nuk është këtu. Për drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës për shkak se shumicën e herëve nuk po është këtu edhe thjesht po na humb interesi me ngritë atë çështje, mirëpo drejtor nëse ju kujtohet ju bashkë me ish-drejtorin e Kulturës dhe disa asamblastë të PDK-së, para disa vitesh, keni bërë një lloj defileje para varrezave të fshatit Romaj edhe keni bërë kinse keni vendosur aty mexhë apo pikat e parcelës që i takojnë varrezave, aty një pjesë është e uzurpuar. Banorët kanë gatishmëri me lëshu atë pjesë që pretendohet që është e Komunës, mirëpo ajo çfarë keni bërë ju është vetëm keni shkuar, i keni bërë një foto i keni përmendur nja 40 vite, edhe pse s'ka qenë ashtu edhe gjendja është ashtu siç ka qenë. A keni ndërmarrë një veprim tjetër që i takon drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër apo Komuna qato parcela, unë kam biseduar me disa prej pronarëve që janë në atyre poseduesve faktik, të atyre hapësirave që ata mbase edhe janë të gatshëm me liru, mirëpo shteti në fund të fundit i ka mekanizmat në pronën e tij të uzurpuar e liron edhe me mjete të tjera ligjore, mirëpo edhe pronarët janë të gatshëm me liru, mirëpo nuk ka pasur një vullnet prej Komunës së Prizrenit që me u shtu ajo hapësira dhe me u zgjedh një problem për shkak se ka filluar edhe aty me u bë ky sistemi qysh është në varrezat e qytetit të Prizrenit, ku njerëzit varrosen një mbi një për shkak të mungesës së hapësirës për t'i varrosur personat që nuk janë më në këtë jetë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Sevil Kazazi.

Sevil Kazazi (Ythp):

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Atëherë nuk kemi diskutues tjerë që janë lajmëruar. Po, fjala për ju Mergiton Gavazaj.

Mergiton Gavazaj (LVV): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Unë sot po e paraqes një rikërkesë për drejtorinë e kulturës, pasi që deri më tani nuk kam marrur asnjë përgjigje lidhur me kërkesën time. Bëhet fjalë për mos funksionalizimin e shtëpisë së kulturës në Zhur dhe nga drejtoria kërkojmë të dimë se cilat janë afatet konkrete për zgjidhjen e këtij problemi. Po ashtu kërkoj nga Komuna e Prizrenit që të ndajmë mbështetje institucionale për organizimin e shënimit të 80-vjetorit të ansamblit Emin Duraku Zhur. Ruajtja e trashëgimisë kulturore nuk është shpenzim, por investim për identitetin dhe historinë tonë. Prandaj, nëse nuk veprohet, rrezikojmë që një nga ansamblet më të vjetra dhe më të njohura në vend të shuhet. Po ashtu për drejtorinë e shërbimeve publike e kam një kërkesë nga lagja Gurishte, konkretisht rruga Masar Ferati. Aty jetojnë mbi 300 banorë, të cilët prej vitesh vazhdojnë të përballen me mungesë të infrastrukturës bazike, bëhet fjalë përafërsisht një kilometër rrugë, e cila ende nuk ka as ndriçim publik, nuk ka as rrjet të kanalizimit dhe rruga vazhdon të jetë e pashtuar. Prandaj kërkojmë nga drejtoria e shërbimeve publike që të dalë në terren, ta vlerësojë gjendjen reale dhe të na informojë nëse kjo rrugë është e paraparë në investimet Komunale. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Mergitan, fjala për ju Onur Kovaç. Le të përgatitet Alban Bislimaj.

Onur Kovaç (KDTP):

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Onur. Fjala për ju Alban Bislimaj.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesues. Të nderuar nënkryetarë, kolegë kuvendarë, drejtorë, media dhe të nderuar qytetarë. Unë e kam një kërkesë në lidhje me Drejtorinë e Arsimit, është fjala për shkollën Naim Frashëri në paralelen Kobaj, në dimrin që e lamë pas, domethënë ajo shkollë është ballafaquar me probleme të nxemjes qendrore. Në atë shkollë është sistemi domethënë me kalldaj me dru dhe aty ka pasur shumë defekte gjatë dimrit që e lamë pas. E di, domethënë ka pasur intervenime për mënjanimin e defektit, por vazhdimisht ka pasur probleme. Kërkesa ime është që në dimrin që po vijmë domethënë të bëhet kjo zgjidhje me ndonjë sistem tjetër, domethënë me ndonjë me ndonjë sistem pelet apo me pompë termike, pasi që sipas informatave të mësimdhënësve, dimrin që e lamë pas domethënë temperatura ka qenë 13 gradë dhe mendoj që është shumë e ulët për një shkollë nxënësit me mbajtur mësim në një gjendje të tillë. Domethënë mbes me shpresë që drejtoria të merr masa dhe dimrin që po vijmë mos të hyjmë domethënë me një gjendje të tillë për të rregullohet nxemja qendrore në shkollën e fshatit Kobaj. Dhe kam edhe një kërkesë tjetër në lidhje me drejtorinë e urbanizmit edhe shërbimet publike, kam bërë dy kërkesa herën e kaluar, por nuk kam marrë përgjigje as me shkrim, as privatisht, askund. E kam ngritur shqetësimin e tranzitit të ri, domethënë te kufizimi i shpejtësisë, a u bë ndonjë analizë, çfarë u bë në atë tranzit, domethënë nuk kam marrë përgjigje. Ka mbetur ende ai kufizim, kurse te drejtoria e urbanizmit nuk më ka kontaktuar, s'më ka çuar email sa i përket poligonit të stacionit të autobusëve për auto shkolla. Ju po e dini qysh është gjendja domethënë që auto shkollat janë duke punuar me një gjendje të mjerueshme në atë rrugë dhe janë duke bërë kaos nëpër qytet edhe siguria nuk është e duhur sa i përket lëvizjes se ku operojnë auto shkollat për moment. Të gjendet një vend, të më kontaktojnë edhe të dalim bashkë edhe besoj që e bëjmë një zgjidhje, por nuk më kanë kthyer email fare me kërkesën që e kamë bërë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Alban. Për ju fjala zonja Nerimane.

Nerimane Pllana Gashi (LVV): Përshëndetje të pranishëm. I kam dy kërkesa edhe një sqarim sot. Kërkesa e parë është drejtuar Drejtorisë së Arsimit, kam kërkesë nga banorët e Lubizhdës në shkollën fillore Ekrem Rexha, në oborr të shkollës është duke u punuar diçka, mirëpo banorët nuk e dinë se çka po punohet. Nëse ka mundësi drejtoreshë me na informuar çka është duke u punuar? Unë isha në terren më kërkuan me dalë aty, isha në terren edhe pashë që nuk ka asnjë tabelë njoftuese, informuese për projektin që ka me përfunduar aty. Vetëm makinerinë e pashë edhe pashë një tabelë e kompanisë domethënë që qysh me thënë një reklamë e firmës që e ka marrë punën me bë, dhe ajo ishte vendosur në shkallë të shkollës. Banorët e fshatit Lubizhdë kanë dëshirë me e ditë se çka po punohet më gjerësisht aty, se nuk ka kurrfarë përfundimi të atij projekti. Kërkesa tjetër është për drejtorinë e shërbimeve publike. Drejtor i nderuar që nga konstituimi i këtij kuvendi e

kam bërë një kërkesë goxha moti për rrugën që të shpie te shkolla Nazim Kokollari. Ma keni dhënë përgjigjen që si të ndalen të reshurat kemi me vazhdu, rruga është edhe parafolësi e ceku, domethënë për puseta mos të flas është gjendja katastrofë. Fëmijët i kemi nëpër rrugë janë duke ecur me shkuar në shkollë, është duke përfunduar viti shkollor por fëmijët tonë janë pa trotuar. Ju kisha lut, projekte të reja ndoshta s'po kërkojina prej juve me fillu, mirëpo qato s'paku me na i mundësuar fëmijëve që ne si prind të jemi të sigurtë derisa ata shkojnë edhe vijnë prej shkollës. Edhe për parkun Rust Kabashi e ceku më herët edhe parafolësit, deshta një sqarim a ka përfunduar ai park? A ka me vazhduar diçka në atë park? Se nuk po duket që ka përfunduar. Fakt mirë është bërë qysh ka qenë, kemi qenë katastrofë aty, mirë është bërë, mirëpo si përfundim unë nuk po e shoh. Shumica e banorëve po më qasën mua, po më pyesin, a ka përfunduar, nuk jam duke e ditur as çka me ju thënë. Domethënë, nëse ka mundësi me na treguar a ka me pas punime në vazhdim diçka, a ka me pas shtesa edhe normal që ajo rrethoja për rrugën kryesore është e nevojshme shumë. Faleminderit. Drejtori i punës dhe mirëqenies sociale po mungojka, ja kam bërë kaherë një kërkesë as përgjigje me shkrim, as përgjigje këtu nuk më ka dhënë. Për qato 17 familjet e dëshmorëve, ai problemi i banesave të tyre, kisha kërkuar publikisht që drejtori me na dhënë një përgjigje. Është rast shumë i ndejshëm, kemi raste sociale, po pikërisht për 17 familje të dëshmorëve jam tu prit që pesë muaj një përgjigje. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit. Fjala për ju, Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Përshëndetje kryesues, drejtor dhe ju koleg kuvendarë. Kam një çështje që do ta ngris këtu, ka të bëjë rreth një projekti ndërtimi i ujësjellësit Piranë, Zojz, Medvec, deri në komunën e Mamushës. Ky projekt është i investuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, nga hidrosistemi Radoniq dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit. E di që edhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, Komuna e Prizrenit ka investuar me participim 200.000-300.000 euro. I nderuar nënkryetar me që po mungon kryetari, kam qejf që ti me qenë mundësisht. Ky projekt ka filluar para një viti është përfunduar mirëpo uji nuk është lëshuar, banorët e asaj ane një pjesë e fshatit Piran, Zojz, Medvec dhe Komuna e Mamushës, kërkojnë me ditë se pse nuk po lëshohet ky ujë. Ju si participues të këtij projekti është mirë që të kontaktoni me Hidroregjionin, Radoniqin dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe ta shohim qartë se ku është problemi, pse ky ujë nuk po lëshohet. Sipas informatave ne si qytetarë të asaj anë që i kemi, drejtori i sapo zgjedhur i Hidroregjionit i ardhur nga komuna e Malishevës thjesht është duke e neglizhuar këtë proces. Prandaj ju bëj thirrje juve si në këtë rast juve nënkryetar që të mirreni me këtë çështje dhe të dilni para qytetarëve të asaj ane t'i kallëzoni pse nuk po lëshohet uji. Projekti që një vjet ka filluar, është realizuar, është përfunduar, mirëpo uji nuk po lëshohet. Kaq, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Qemal. Fjala për ju Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (GUXO): Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar kolegë kuvendarë. Në javën e kaluar ka qenë shqetësimi i disa agjencive turistike lidhur me qentë endacak në qytetin e Prizrenit, ku për fat të keq ka ndodhur edhe një aksident dhe askush nuk dihet se çka është duke ndodhur me qentë endacak në qytet dhe gjendja e papastërtisë në institucionet të

Komunës së Prizrenit dhe rrugët në Shatërvan, me të vërtetë ka ndodhur një aksident dhe është për të shprehur keqardhje, sepse në momentin që ndodhin aksidente të tilla, qyteti i Prizrenit i bien edhe turistët sepse nuk janë të sigurt me ardh dhe me vizituar. Ne shquhemi për traditë ne shquhemi për kulturë dhe në fakt nuk jemi duke ju siguruar sigurinë turistëve. I nderuari drejtor, edhe drejtori i bujqësisë edhe drejtori i turizmit, çka është duke ndodhur do thotë me këtë sepse turistët dhe me hy dhe me shiku nëpër faqet e tyre të Tik Tok-eve dhe Facebook-eve, me të vërtetë janë duke na paraqitur si një qytet jo i pastër dhe jo i sigurt në këtë Komunë. Çka është duke ndodhur me strehimoren e qeneve endacak në Komunën e Prizrenit dhe çka është duke ndodhur me papastërtinë e sheshit të Shatërvanit?

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Petrit. Nuk kemi diskutues të tjerë që janë lajmëruar. Po, fjala për ju, Eldis. Le të përgatitet Ilir Gashi.

Eldis Abazi (VAKAT):

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zotri kryesues. Drejtor Islam Ukimeri, përse nuk po rregullohen rrugët e dëmtuara brenda në qytet? Disa prej tyre janë bërë gati të pakalueshme nga gropat e mëdha dhe dëmtime të shumta. E ke rrugën Gustav Mayer nga 17 Nëntori, shkolla 17 Nëntori në drejtim të rrugës Zahir Pajaziti te birovit për punësim, pastaj është rruga Tirana emri vjetër nuk po më kujtohet Dervish Shala mos gabofsha që lidh rrugën në fillim të rrugës për Nashec, në drejtim të Jetës së Re. Pastaj është rruga Albrim Fanaj, që lidh rrugën e Ulqinit me rrugën Enver Hadri, po ashtu në lagjen dy Korriku rreth çerdhës Yllka punimet kanë pasur me përfundim vitin e kaluar nga muaji qershor-korrik, po ja kaluan një vjet e më tepër dhe punimet janë ndërprerë, banorët e lagjes janë në hall nga pluhuri dhe nga lloçi, punimet nuk po vazhdojnë pse ka ndërprerje, pse nuk po vazhdojnë punimet dhe pse nuk po ndërhyhet në rrugët e shumta të dëmtuara brenda në qytet? Për drejtorin e urbanizmit në lidhje me lejen për stadiumin e Lirisë që e ka bërë Ministria e kulturës, në çfarë faze është kur pritet të del leja dhe të fillojnë punimet. Me keqardhje pas çdo procesi të vlerësimit të projekteve të kulturës, po duhet me reagu publikisht në lidhje me politizimin e ndarjes së subvencioneve. Edhe sivjet si vitin e kaluar, drejtorja e kulturës nuk po mundet me u shëru nga ky kompleks dhe me ndëshku njerëz që nuk janë të përshtatshëm politikisht me qeverisjen aktuale të Komunës së Prizrenit. Drejtoreshë e nderuar e kulturës, nuk e di a jeni të vetëdijshëm se udhëheqni me drejtorinë e kulturës të një qyteti që njihet si kryeqytet kulturor i Kosovës, që brenda vetit ka festivalet të filmit me nam ndërkombëtar, e ju ndani subvencione minimale për ta. Ka shkrimtarë me emër, me libra shkencor, e me paraqitje mediatike, ligjërues universitar, ka panair libri që mbahet 18 vite, e ju nuk ndani asnjë cent subvencione për ta dhe më e keqja nuk jepni arsien se pse privohen nga kjo edhe pse ne e dimë arsyen është papërshtatshmëria politike, që ju në këtë rast vetëm mund të bëni mjet për kryetarin. Po ashtu edhe organizata të tjera, sikurse ato të bjeshkatarëve, klubet e notit, e klube të tjera, e individë që në rrjetet sociale këto ditë kemi parë jashtëzakonisht shumë reagime. Drejtoreshë e nderuar, ju takon juve që këtë dikaster ta udhëheqni me transparencë dhe me drejtësi dhe kulturën, artin, letërsinë mos ta kthejmë, mos ta politizojmë,

mos ta kthejmë në hakmarrje politike me njerëz që jetën e tyre mund të jenë anëtarë të një partie apo një orientimi tjetër politik. Kulturën ta mbajmë larg politikës dhe ndikimeve partiake. Ju lutem merrni me seriozitet dhe rishikoni këto vendime të komisionit vlerësues. Sepse ata anëtarët e komisionit nuk dua t'i cekim me emër. Krejt me i bëj bashkë nuk vlejnë as një përqind e shumë me thënë, se sa emrat që i përmenda e që janë privuar nga subvencionimi për zhvillimin e projekteve të tyre kulturore e letrare. Ju takon juve që ta përpiloni një rregullore, që mos të mbetet më mëshirën e anëtarëve të komisionit për me vlerësuar se kush sa duhet të merr subvencione. Po të jetë një rregullore e cila përmban në veti kriteret reale për me vlerësuar çdo projekt, të çdo organizate apo të çdo individi, e që mbi të gjitha do të kishte parasysh impaktin që e ka dhe jetëgjatësinë apo edicionet e shumta që i kanë bërë. E shpresoj që këto vendime do t'i rishikoni dhe do të na mundësoni një vlerësim më të drejtë. Faleminderit për dëgjim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues, përshëndetje ekzekutiv, kolegë kuvendarë. Një kërkesë për drejtorinë e arsimit. Drejtoreshë, të kisha sugjeruar me u konsultu edhe me drejtorinë e shërbimeve publike, në shumë shkolla mungon sinjalizimi, sidomos sinjalizimi horizontal që paralajmëron shkollën. Kemi lëvizje të shpeshta me vetura edhe afër shumë shkollave mungojnë këto sinjalizime dhe rrezikohen sigurisht edhe ju kisha sugjeruar, kam pasur kërkesë edhe më herët ti identifikoni ato shkolla. Njëra prej tyre është shkolla në Arbanë, po ka edhe shkolla të tjera. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Liridona Veçgishi. Le të pregadit Sevilaj Apçi.

Liridona Veçgishi (BDP): Përshëndetje kryesues, të nderuar ekzekutiv, kolegë asamblistë dhe ju qytetarë. Pyetja e parë shkon për drejtorin e shëndetësisë. Drejtor, një kohë të gjatë ka disa muaj që në qendrën kryesore të mjekësisë familjare mungojnë analizat bazike, HBA 1-shi dhe gjëndrat tiroide apo ndryshe si njihen në popull diabeti në tre muajt e fundit. Ku qëndron problemi dhe pse është mungesë e këtyre analizave bazike? Duke e ditë që në Komunën tonë të Prizrenit kemi një numër të madh të pacientëve me diabet dhe kosto për t'u bërë privat këto analiza është një kosto e kushtueshme për qytetarët. Mund ta di se pse nuk furnizohet QKMF-ja me këto dy lloje të reagencave që janë më se të nevojshme, ju e dini më mirë se unë në këtë çështje. Dhe pyetja e dytë shkon për drejtorin e shërbimeve publike, një ashtu i përket edhe drejtorisë së inspektorateve. Drejtor, në fshatin Vlashnje, në urë që është në fshatin Vlashnje, në mes të fshatit Vlashnje dhe Maradem, besoj që qytetarët i kam takuar dhe kanë bërë kërkesë edhe në drejtorinë juaj dhe në drejtorinë e inspektorateve po asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje. Një pronë, një biznes privat në atë urë, dalja e të reshurave të shiut nën urë kalon në dy hyrje, njëra nga hyrjet e daljes është e bllokuar nga biznesi privat dhe ai ka bërë qasje nën këmbëzën e urës për të hyrë edhe në biznesin privat edhe nga rruga kryesore edhe në rrugën kryesore. Kam video dhe foto, ku disa nga banorët aty janë mbi 20 familje që kanë nja gjashtë familje kanë edhe sera, komplet janë dëmtuar serat një e reshur e shiut komplet ja merr serat të gjithë pjesës aty të asaj zone. Drejtor, ju kisha lutur me

dërguar një ekip dhe me e pa se në çfarë gjendje është e uzurpuar me komplet njëra në këmbëz e urës. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Liridona, fjala për ju Sevilaj Apçi.

Sevilaj Igci Hapçi (KDTP):

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Diskutuesit tjerë nuk kemi që janë lajmëruar. Po Dafina. Edhe mundësisht ata që kanë marrë fjalën le të lajmërohen me kohë që disa herë po përsëris. Fjala për ju Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Është qe 10 minuta që kam ngritë dorën, po se di pse s'po doni me më pa, apo s'po ju konvenon. Pikë së pari, më vjen keq që kryetari përsëri nuk është në seancë, unë nuk e di pse e ka këtë qasje edhe këtë qëndrim, shkaku që ai në secilën fushatë thirret që ka bashkëpunim me kuvendin, thirret që bashkëpunon e i dëgjon edhe të gjitha kërkesat e kuvendit, është për të ardhur keq se këto qëndrime i ka vetëm për fushatë dhe kur të përfundon fushata e kemi një mungesë të qartë të kryetarit. Kjo vlen të theksohet edhe ta shohin qytetarët. Unë nuk e di pastaj ato poentime kur po bëhen, si ka mundësi që poentohet prezenca e kryetarit në kuvende, sepse dhe aty ka poentime për grantin kryesisht. Këtu i bëj thirrje që të vijë në kuvend dhe t'i dëgjoj kuvendarët sepse ne i përfaqësojmë këtu qytetarët edhe nuk është aspak respekt për kuvendin. Çështja tjetër është Kujtim mirëse ke ardhur, i kemi mungu kësaj pjese meqë pa një dirigjent këtu ishin të koklavitur shumë, kështu që shpresoj që tash me veprimet që i bën si çdo seancë, do ta kesh në kontroll ekzekutivin e tërë. Sa i përket çështjeve, në seancën e kaluar e kam ngritur si shqetësim çështjen e veturave të papërdorura, kryesisht janë të Komunës e që janë mbrapa shtëpisë së bardhë. I kam identifikuar diku tetë vetura që janë me vite aty edhe uzurpojnë vend parkingje. Nuk kanë marrë asnjë masë drejtoritë përkatëse nuk e di kujt t'i takon, por ju kisha lutur, meqë është edhe sezoni i verës dhe ka me pas shumë vizitorë me i liruar edhe ato hapësira meqë janë pa pagesë me u shfrytëzuar. Po ashtu çështja e shkollave, domethënë tek këto oborret, a do të shfrytëzohen edhe këtë vit për parkingjet të mërgimtarëve? A ka ndonjë planifikim të tillë drejtoreshë? Çështja tjetër që ka ankesa shumë të mëdha prej mirëmbajtjes së QKMF-së edhe QMF-ve. Drejtor, papastërtia është në nivel tejet e keqe qoftë për staf, sidomos QKMF, qoftë për staf edhe qoftë për pacienta. Po brenda hapësirave. A është problemi që keni mungesë të stafit, apo nuk keni mjete për me ble këto materiale higjienike? Ju kisha lutur që ta keni këtë sensitivitet meqë është institucion shëndetësor edhe ka tejet me rëndësi higjiena. Edhe një çështje e kam për drejtorinë e shërbimeve publike. Drejtor, sa tender ekzistojnë për ndriçim publik? Edhe sa të tjera keni plan me i hap? Por sa përqindëshi i ndriçimit ka përfunduar në Komunën tonë? Janë disa lagje, s'po di a po tentoni me i bë diskoteka? Po ndalen edhe dhezën non-stop. A ka ndonjë problem të cilët ju e keni identifikuar apo është totalisht mosmirëmbajtja e këtyre pjesëve? Banorët po duan me ditë, domethënë, çka është problemi me këto pjesë. Edhe kur përfundimisht ne kemi me pasur më ndriçim në çdo lagje. Unë mendoj që është një çështje emergjente, të cilët ju vazhdimisht na keni thënë shtatori, tetori, dhjetori, janari, non-stop kemi pasur data ose muaj, por ne ende kemi

probleme me ndriçim publik. Ju kisha lut me bë një analizë edhe me na tregu deri kur më kemi me pas terrin në Prizren. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Dafina. Atëherë kalojmë në kalojmë në përgjigjet e ekzekutivit. Fjala për ju drejtor i kadastrit, Senxhar Karamuço. Atëherë nënkryetari shkurt.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit kryesues. Të nderuar anëtarë të kuvendit, kolegë nga ekzekutivi, përfaqësues të mediave, të nderuar qytetarë të cilët na ndjekin nëpërmjet mediave. Qemal, sa i përket investimeve në rrjetin e ujit të pijes, ka qenë një lajm i mirë kur e kemi nënshkruar marrëveshjen bashkë me KRU Gjakovën edhe Qeverinë e Kosovës. Siç e dini, roli i Komunës këtu është në kuptimin e ndihmës të këtij projekti domethënë ne e kemi ndihmuar projektin, kemi participuar në projekt por nuk kemi asnjë rol në ekzekutimin e projektit dhe me thënë të drejtën nuk kam ndonjë informatë të saktë pse s'ka përfunduar projekti deri tash, por të premtoj që do të marr informata zyrtare nga implementuesit të projektit. Përndryshe Komuna ka qenë participuese edhe ju kemi gëzuar shumë këtij projekti, për shkak se jemi të bindur që e kemi bërë një zgjidhje të mirë bashkë me Qeverinë edhe me KRU Gjakovën, si bashkë investitor në këtë projekt shumë të rëndësishëm për qytetarët e Komunës së Prizrenit. Po besoj që, megjithatë, ky projekt veç është ka fundi, ndoshta për ndonjë problem teknik nuk është analizu, por roli i Komunës në këtë projekt është vetëm financues edhe në kuptimin e asaj që ne kemi kryer procedurat e dokumentacionit ato që na janë kërkuar në bazë të memorandumit të bashkëfinancimit të këtij projekti. Pata një përgjigje për Dafinën por meqë s'është këtu po e përfundoj. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit nënkryetar. Fjala për ju Senxhar Karamuço. Le të përgatitet Luljeta Veselaj.

Senxhar Karamuço: Për problemin ndërkomunal me Suhareken është problem i motshëm. Problemi buron nga aero inçizimet 1970. Atëherë kur kanë bërë inçizimet, një pjesë të pronave është regjistruar edhe në Suharekë edhe në Prizren. Tash ata qytetarë e kanë listë poseduese, tonat e kanë listë poseduese, vetëm pasi që është parcela e njëjtë, nuk janë figuruar me gjendja faktike. Për këto vitin e kaluar me vendimin e kryetarit është formuar një komision ndërkomunal. Ne kemi formuar, e kemi propozuar dy emra, dy emra e ka propozuar Suhareka edhe një kërkuam prej agjencisë kadastrale, pasi ata menaxhojnë me sistemin kadastral. E kanë mbajtur disa mbledhje për shkak se problematikës që aty pronat shumica në Suharekë janë pronësi të pylltarisë. Nuk kemi mundur me pru një dakordim për me pru një marrëveshje na me votuar këtu, ata me votuar. Për atë arsye komisioni e ka propozuar një komision të formohet qeveritar, pasi edhe pylltari është nën menaxhim të Qeverisë, edhe Agjenci kadastrale, edhe ata me bë një zgjidhje. Pasi që në agjenci kadastrale një gjashtë muaj është duke bërë disa ndryshime dhe nuk kemi pasur një mbledhje përmbyllëse për këtë temë. Besoj që kohën e ardhshme besojmë që do të bëhet një zgjidhje për këtë temë.

Agim Muqaj (AAK): Drejtor, faleminderit për sqarimin në mënyrën tuaj, po mendoj se ata qytetarë i vuajnë këto pasoja dhe mendoj se duhet të jeni më të zëshëm si kuvend Komunal dhe të

dilni edhe publik. Këtë punë duhet ta mbani në përgjithësi, qoftë drejtoria kuvend Komunal ose të dilni në media dhe të fajësoni dikënd që nuk i kryen punët e veta, qytetarët donë zgjidhje. Edhe ne kur japim një përgjigje për qytetarët po japim një përgjigje thuajse me dekada edhe me shekuj. Domethënë është një zgjidhje e papërfunduar. Duhet të ketë një afat, mendojmë se këtë vit kalendarik do të përfundon, apo ta merr fajin dikush, qoftë Komuna e Prizrenit, qoftë Qeveria. Në qoftë se i ka fajin Qeveria, ju lutem dilni publikisht dhe leni fajin atij që mos e merrni përgjegjësinë ju, kjo është. Qytetari do përgjigje kur ka mundësi të kryhet, njerëzit kanë nevojë që të ndërtojnë shtëpitë, lista poseduese nuk është e rregulluar, është pronën që e gëzon, i takon Komunës së Tharandës ose të Rahovecit, kështu që nuk ka mundësi të zgjidhë asnjë lloj problem, as ndërtimit, as shitbjerjes, kështu që ata donë zgjidhjen. Ju lutem që të kërkonin një përgjigje më saktësisht edhe nga Ministria në nivel qeveritar dhe dil me një përgjigje para qytetarëve apo a ka një afat, apo vyen 10-20 vjet, le ta dinë qytetarët që t'i bëjnë projektet e veta afatgjata për jetën e tyre. Faleminderit.

Senxhar Karamuço: Unë tregova që problemi është prej 1970-ës. Tash ju po qitni kohë aty të tjerat. Ata, njerëz janë duke mundur me shfrytëzuar që sa vite tash, kadal. T'u japi përgjigje tash, mirë.

Agim Muqaj (AAK): Drejtor sinqerisht, kjo nuk është asgjë, neve s'po na interesojnë vitet e 70-ta edhe para luftës edhe në kohën e Turkisë. Qytetarët duan zgjidhje nga mekanizmat Komunal dhe shtetëror, kjo është ajo çka kërkojnë qytetarët. S'jam duke të pyetur a janë në vitet e 70-ta apo 50-ta. Ju lutem, qytetarë, dojnë zgjidhje. Të lutem.

Senxhar Karamuço: Unë tregova, edhe unë s'jam ai njeri që fajësoj dikënd, pse s'po fajësoj qeverinë ato të tjerat? Kjo është problematika që duhet të zgjidhet edhe kemi me zgjidh. Tash a kryhet sot, a kryhet nesër ato të tjerat ne kemi vullnetin me bë zgjidhje. Na për qato paguhemi, ju çka doni mund me fol kanë të drejtë ato të tjerat. Për Selmanin, varrezat sipas kërkesës së banorëve ne kemi dalë terren. I kemi bë inçizimin, e kemi qitë pikat, aty ka pas uzurpimet edhe ne s'jemi drejtorja që i rrënojmë muret ato të tjerat. Sipas teje, në qoftë se ka vullnet të mirë, besoj që me një procedurë shumë shkurt, të rrënohet ato muret edhe qitet pikat për varrezat. Ndoshta edhe drejtoria e Shërbime Publike mund të ndihmon për me rrethu ato të tjerat. Zgjidhje ka edhe besoj që do të bëhet, nëse ka vullnet në terren, nëse nuk ka, tani është tashmë drejtoria edhe e pronës që mund të zhvillojnë procedurat për uzurpim për largimin e ato mureve për të rrethuar ato varrezat. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Po, Agim Muqaj shkurt? Po kalojmë me drejtorët tjerë.

Agim Muqaj (AAK): Kryesues të lutem, shkurt po mundohemi me qenë, po jemi zë qytetarëve dhe mendoj se prezantojmë dikan edhe s'po mundem me i bajtë këto gjëra. Edhe ky drejtor mu përgjigj njëjtë sikur Albin Kurti që për natë, qet projekte për 100 vjet që nuk ka mundësi me realizu Kosova. 100 vjet hekurudhat deri në Sarandë që Kosova edhe buxheti i Ballkanit s'ka mundësi ndoshta me i pagu, edhe drejtori është duke më dhënë një përgjigje për 50 vjet a 100 vjet Zoti e di

kur bëhet. Po do jna përgjigje konkrete, kryhet për një vjet, katër vjet. Këto janë të pakapshme për logjikën e njerëzve. Du afat drejtor, afat, një vjet, dy vjet, të lutem përgjigje konkrete që le ta dinë. Edhe Albin Kurti le të tregon cilin vit ka me i ndërtu autostradat e ato e hekurudhat për 100 vjet. Nuk shkon kështu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kalojmë në përgjigjen e drejtoreshës së arsimit se ka dhe aktivitete të tjera. Për ju fjala drejtoreshë Luljeta Veselaj Gutaj.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit shumë kryesues, të nderuar kuvendarë, të nderuar kolegë drejtor, media, të gjithë ata të cilët e përcjellin seancën e kuvendit. Sa i përket pyetjes për javën Remzi Ademaj, kanë përfunduar të gjitha procedurat, është lidhur kontrata dhe jemi në proces të fillimit të javës Remzi Ademaj, do të njoftoheni në kohë. Pyetja e dytë për konkurset për bursa për studentë, veç se është shpallur konkursi për bursa për studentë. Sa i përket nxemjes qëndrore në fshatin Vlashnje, disa herë kemi biseduar edhe privatisht zoti Bislimaj, ne e kemi revidu, e kemi shtu edhe një pompë termike vitin e kaluar edhe në proces së tutje do të shohim mundësitë. Përtej asaj ju e dini gjendjen financiare dhe gjakderdhjen financiare që ka ndodhur në Komunën e Prizrenit. Andaj jemi të sfiduar në secilin segment për të operuar dhe vazhduar më tutje. Ne kemi pasur në planifikim një thirrje publike për revidimin e të gjitha problemeve me nxjerrjet qendrore, mirëpo në pamundësi dhe në mungesë të mjeteve që i ka marrë përmbaruesi nga kontrata kolektive, nuk kemi mundësi të hapim thirrje dhe të vazhdojmë më tutje. Megjithatë, në gjithë Evropën dhe gjitha vendet aty ku nuk ka mundësi dhe ka pengesa edhe komuniteti i prindërve dhe njerëzit vullnet të mirë japin nga pak mbështetje. Sa i përket, nuk qenka zonja Nerimane. Dafina, oborret e shkollave si çdo vit, mërgimtarët me nxi i presim edhe ne, kemi familjarë, kemi miq edhe si gjithmonë i kemi hapur dyert edhe të shtëpisë, edhe të shkollave dhe të gjithë me shumë kënaqësi për të gjithë ata që vijnë edhe i shijojnë pushimet në Kosovë. Jo, Nerimanja le të rrin jashtë s'është e interesuar.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues, nuk mora përgjigje te drejtoresha. A mundet me thënë drejtoresha nuk po dua me përgjigj edhe me na tregu për Arben Shalën, trikaxhini e Prizrenit. Personin që del çdo natë pin birra raki nëpër lokale të natës.

Simir Krasniqi (Kryesues): Shukri Quni e ka kërku fjalën.

Shukri Quni (BDP): Drejtoresha nuk bën me dal, sepse pyetja është shumë ishte e shkurtër edhe nuk është mirë me dal kur bëjmë ne këtu pyetje edhe i ngrejmë çështje, sepse për këto kemi ardhur ne këtu. Unë nuk hyra më herët kur e ngrita si çështje në historik. Unë kam këtu ish-drejtor të shkollave që kanë marrë pjesë në manifestim. Përgjigja ishte procedura është ka me u mbajt. Java e Remzi Ademaj, fillojke në fakt me 28, 29, 30 maj. Po ka ndodh edhe me një, e dy, e tre qershor. Ditlindja e komandant Remzi Ademaj është me tre qershor. Domethënë kjo nuk ka filluar ende. Për ilustrim juve patriotëve, që liria ka emër, kqyre Shukri Quni prej 2007-ës, liria ka emër, shiko kur i kam futur unë emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në shkollat e Komunës së Prizrenit, shiko mirë. Këtu kam edhe nxënës që s'është tash, që ka marrë pjesë në këtë aktivitet edhe në këtë

kuiz të diturisë. Vonë ju ka rënë në mend kur ka liria emër, disave. Po ky kuiz, ky manifestim është organizuar prej vitit 2002, kryesues, e di shumë mirë edhe tash nënkryetari Kujtim Gashi, po e dinë edhe shumë mirë edhe të tjerët. Shtatë vjet në opozitë këtë e kemi mbajtur, në mënyrë ta quaj kështu ilegale, se ish drejtorie arsimit i ka kërcënuar dhe drejtorët mos me marrë pjesë në këtë manifestim. Po ka pas drejtor burra që kanë marrë pjesë, duke filluar prej drejtorit Zhurit Ismen Ajazaj, Selajdin Shabanaj. Tash do t'i hyjmë borxh disa drejtorëve që smund do t'i përmend të gjithë, po nuk janë frigu se kanë me i shkarku prej detyrës për me e marrë pjesë në këtë manifestim. Shumë mirë është i njoftuar edhe redaktori i Besës, patrioti, veprimtari Qazim Morina, që ka marrë pjesë dhe e ka përcjellë çdo aktivitet Qazim Thaçi më fal, se s'është problem se tash nuk jam duke fol vetvetja, është duke folur zemra tash. E me u qu drejtoresha veç një pyetje me ma dhënë që unë boll e kam pasur mërzi me e ngrit këtë çështje. Të gjithë e dinë, kurrë s'kam thënë jam themelues, vetë e kam themeluar. Ish-kryetari, profesor doktor Ramadan Muja e ka zyrtarizuar në këtë kuvend edhe e ka marrë nën organizimin ose patronatin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit. E sot, mbas 24 viteve, mos me u organizu edhe me një përgjigje kaq të thjeshtë, unë e di që me ata nuk flas privatisht, zyrtarisht nuk ka qare pa fol, çdonjëri prej jush këtu. Zyrtarisht s'keni qare pa fol. Privatisht kërkujt në rrugë nuk i flas, hiç s'më intereson. Përgjigja është përgjigje! Kërkova pse nuk është mbajtur, nesër ka pas me përfundu ky manifestim. Me tërë atë angazhim që e kanë bërë kur kemi qenë në opozitë Partia Demokratike, ne e kemi organizuar me vetëfinancim këtë, mos i nënçmoni gjërat. Ka ra qekjo tu e keqpërdorur ju, sot mundohemi me i dhënë emër lirisë. Unë prej 2002-ës jam mundu këtë liri me e fut nëpër shkolla. Edhe me i eduku, me i arsimu të rinjtë, që sot mos me ardh kjo kohë e me i qit nëpër nëpër gjykësa ju shenjën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, se gjëja jeni bërë tash patrioti mbas 20-të viteve. Unë e kërkoj prapë që manifestimi Java Remzi Ademaj shtigjeve të lirisë, amani ju qoftë mos më shtini më me bë një kërkesë të tillë. Me ngrit një çështje të tillë, s'ka nevojë. Edhe e dimë kur janë akuzuar njerëzit, nga individë të caktuar, për me ndal manifestimin javën Java Remzi Ademaj. Kanë shiku me i dënuar vetëm me i largu që ky manifestim mos me u organizu. Kur fillon manifestimi? Pyetja a do të mbahet? Procedurat gjithë kanë filluar në mars e në prill, edhe ushtrimet e nxënësve prej muajit prill i kemi filluar, maj, për me marrë pjesë se është kuiz i diturisë. Kështu e ka emrin Liria. Tek ata që s'keni punuar ju me ta. Te ato shkolla që i keni shkatërruar, i keni demolu në tërë anët. Nënkryetar, jeni i njohur rreth këtij problemi shumë edhe ish-organizatorët që i kanë çuar nëpër gjykata. Kërkoj përgjigje pse nuk është organizuar me datën e saktë. Nesër ka pas përmbyllje me u bë. Me 3 qershor gjithnjë është bërë mbyllja e manifestimit Java Remzi Ademaj. Nuk po hyj më tepër, se harrojnë njerëzit që kanë dhënë kontribut për këtë çështje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po fjala për ju nënkryetar i komunës zoti Kujtim Gashi.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit kryesues. La Shuk po të them se gjithmonë kështu të kam thënë, edhe pse në fjalimet formale s'përdoren këto terma, megjithatë po kërkoj falje. Sido që të jetë, arsyeja pse festivali s'është mbajtur me kohë, një prej ngjarjeve më të mëdha për mua edhe kulturore edhe historike kisha me e quajtur, është krejtësisht financiare. Sepse ne jemi të gjithë dëshmitarë që Komunës së Prizrenit deri në maj janë tërhequr nga buxheti 17 milionë euro dhe për

me nisni një procedurë tenderuese, thirrje publike, çka do që lidhet me financa duhet me pasur një letër A4 zotim të mjeteve, qoftë edhe 50 euro qoftë edhe 100 euro, edhe 1000 euro, qato s'kanë qenë. E pa e bë atë zotimin, nuk mundesh me filluar procedurën, nuk ta lejon sistemi. Domethënë ti nuk mundesh në sistem me qit një thirrje publike ose një tender nëse që letra zotimin nuk e ke dhe nuk e kemi pasur. Përkundër kësaj, përkundër që jo vetëm Komuna e Prizrenit, po nja 70-80% të Komunave në Republikë të Kosovës janë në kolaps financiar edhe nëse kishin me qenë institucione, biznese, ato duhet me u mbyll, po meqë janë Komuna s'kanë qysh me u mbyll dhe duhet me funksionuar. Përndryshe, në aspektin financiar, Komuna e Prizrenit është kolaps dhe jo vetëm na si ekzekutiv, por edhe ju si kuvendarë edhe secili qytetar këtë vit duhet me ndihmuar maksimalisht Komunën e Prizrenit në të gjitha format. Nëse dojmë ky institucion që i shërben qytetarëve me qenë funksional. Dhe përkundër që mbi 90% të projekteve këtë vit nuk do të realizohen, megjithatë te pas parasysh që java e Remzi Ademit është prej ngjarjeve më të mëdha kulturore në Prizren, megjithatë ne e kemi filluar procedurën edhe sot e kemi nënshkruar procedurën për shpallje. Edhe e kemi siguruar një pjesë të mjeteve për me nis këtë projekt që është prej projekteve më të mëdha. Në anën tjetër, po flasim patë pyetje edhe për Kulturën që janë reduktuar financimi i disa projekteve, po është e vërtetë sepse ne sot kur po flasim kemi minusat të vitit të kaluar që s'janë financuar organizatat të cilat kanë fituar. Sepse s'mundesh me financuar nëse s'ke pare. Thjesht i ke në xhirollogari 500 euro, ti merr prej kredisë nuk ke asnjë cent me realizu një objektiv tonë edhe personale. Kështu funksionon edhe Komuna, nuk ka mjete në llogari. Edhe kjo është arsyeja pse sot nuk ka përfunduar Java Remzi Ademaj. Megjithatë, kjo do të mbahet, do të mbahet me vonesë. Përkundër që janë reduktuar shumë aktivitete të tjera kulturore, Java Remzi Ademit ka qenë, është dhe mbetet prioritet i qeverisë së PDK-së. Dhe po la Shukë për këtë projekt vlerësimet i ke maksimale, e ke nisur bashkë me dy-tre persona përkundër sfidave edhe ato që i përmende që kanë pasur tendenca me e pengu realizimin e këtij projekti shumë të madh. Sot ky projekt jetësohet edhe normal që edhe qeverisja jonë ka pasur merita që e ka formalizuar dhe e ka zyrtarizuar. Ka vonesa, por do të realizohet. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit nënkryetar. Fjala për ju drejtor i shërbimeve publike Islam Ukimeri.

Islam Ukimeri: Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, kolegë drejtor, të nderuar asambleistë, media dhe të gjithë të pranishëm. Të gjitha pyetjet që më janë bërë nga asambleistët do të mundohem për secilën t'ju kthej përgjigje me ato mundësitë dhe ato dijenitë që i kam në bazë të kërkesave që janë bërë. Shukri Quni më ka bërë dy pyetje. Realisht Shukri, unë edhe të shtunën ditë vikendi kam biseduar me ty për lidhje me pyetjet që ma ke bërë për murin mbrojtjen në Nashec edhe përkundër faktit që e shpjegoj edhe nënkryetari anën financiare të Komunës, unë e kam thirrur operatorin dhe kam biseduar dhe kam kërkuar nga ai që të bëj të pamundurën dhe të bëj atë mur mbrojtës se është shumë i nevojshëm. Ndërsa te pyetja e dytë lidhur me ndotjen e rrugës në Nashec dhe lagjen Jeta e Re gropa skeptike, unë nuk jam i informuar për këtë rast, do ta shoh, do të bisedojmë edhe me inspektoriatin dhe zyrtarët e drejtorisë shërbime publikë të dalin në terren të konstatojnë se çfarë ka problematika në atë vend. Në qoftëse është nevoja për ndonjë kanalizim që

është metrazha e vogël, ne do të intervenojmë, po do të dalim në internet ta identifikojmë si problematikë këto raste, pasi që e thashë që më herët nuk ka pasur problem kjo rrugë me këto me këtë problematikë. Sevil Kazaz, më ka bërë një pyetje lagjja Korilla, kanalizimi të vazhdohet, ne kemi intervenuar në lagjen Korilla me një kanalizim vitin e kaluar dhe besojmë që në qoftë se është edhe aty mundësia që të intervenohet për ndonjë pjesë të vogël do të intervenojmë, por nuk po dua për çdo për secilin asambleist t'ju them që siç e tha edhe nënkryetari anën buxhetore edhe kërkojmë edhe nga ju nga asambleista të gjithë pra një pavarësisht partieve politike që të gjitha kërkesat, unë e di që të gjithë qytetarët qoftë në qytet apo në fshatra kanë nevojë dhe kanë kërkesa që janë shumë të nevojshme dhe janë shumë të arsyeshme, por edhe ju duhet me na ndihmuar që për shkak anës financiare dhe mundësive buxhetore që kemi këtë vit të mirëkuptojmë dhe që mos bëjmë kërkesa t'ju drejtojmë drejt edhe qytetarëve që kërkesat janë shumë minimale dhe qka janë të domosdoshme, jo se ne e kuptojmë që është e nevojshme për secilën rrugë të intervenohet, por mundësitë buxhetore i kemi shumë të vogla. Në Dardani asfalti ende nuk ka vazhduar, mu ka bërë pyetja nga Sevili, po mu ka bërë me sa kuptova me disa asambleistë për në Dardani, ne veç kemi kontaktuar operatorin atje kanë qenë tre lote të kontraktuar në lagjen Dardania dy dhe besoj shumë shpejt që brenda këtij muaji do të vazhdoj të përfundon komplet asfaltimi në dy lotet e mbetura. Në Jeni Mahall veturat janë të parkuar të të largohen, është bërë kërkesa nga Sevili. Veturat, ne do të dalim në terren të konstatojmë që a do të ketë mundësi të bëjmë vija aty me shenjim, por në qoftë se veturat parkohen ka shenjë që është e ndalur ndalë edhe parkingu aty duhet të intervenojë policia, ne s'kemi çka i bëjmë si drejtori, po duhet policia të intervenojë. Meriton Gavazaj, lagja Gurisht e Masar Ferati, mungon infrastruktura. Po e vërtetë ne e dimë këtë rast jemi të informuar edhe vitet e kaluara edhe më herët, ka pasur problem kjo lagje me anë ka faktikisht ka probleme kontestore ligjore me gjykatë dhe ne kemi dalë disa herë në atë lagje dhe kemi parë që a kemi mundësi të intervenojmë në atë lagje, por për shkak të problemeve gjyqësore që i kanë pronësore aty nuk kemi mundësi, derisa të zgjidhet problemi gjyqësor nuk kemi mundësi të intervenojmë. Në momentin që i zgjidhen problemet gjyqësore ne do të vazhdojmë të intervenojmë se është shumë e nevojshme dhe shumë është një akt që është që duhet të intervenohet në atë lagje se ka shumë shtëpia dhe shumë banorë. Onur Kovac, dardania te parku ne kemi intervenuar në atë në atë pjesë te parku në Dardani dhe kemi bërë rregullimin dhe kemi pastruar dhe kemi bërë një intervenim. Ende nuk është përfunduar, do të përfundoj ka mbetë edhe një pjesë pa përfunduar. Janë të parapara dhe disa lojëra për fëmijë, jo shumë, po pak. Ndërsa sa i përket mbylljes, ne nuk do të kemi mundësi ta mbyllni, nuk lejohet të mbyllet ai park, është e vërtetë që ka pasur shumë kërkesa që të mbyllet ai park faktikisht me bërë një farë muri mbrojtës, po jo se e hupë edhe pamjen dhe është e pamundur, nuk do të mbyllet ai park. A lojra do të ketë, do të vazhdohet dhe pjesa tjetër të përfundoj. Në Ortokoll mungon parkingi, është e vërtetë që mungon, jemi shumë të vetëdijshëm që mungon, por ne besojmë shumë shpejt që nga viti i ardhshëm do të planifikojmë një projekt në Ortokoll. Veç që jemi duke punuar në atë drejtim që të krijojmë mundësi të gjejmë edhe parkingun në Ortokoll. Sa i përket banesave që janë të rregullt të ndërtuara aty dhe ato oborret që kanë përpara, ne nuk mund t'i kurorëzojmë dhe t'i ndalojmë aty. Ato janë parking publik dhe secili që e parkon aty ai ka të drejtën e vetë të parkojë dhe nuk mund të intervenojmë aty. Ndërsa

hapësirat publike që janë, jemi duke punuar në atë drejtim që të intervenojmë në Ortakoll, në lagjen Ortakoll, pasi është lagja më e madhe në Kosovë, dhe të krijojmë mundësi për parking dhe pjesë gjelbëruese aty. Nerimanja s'qenka këtu. Po pyetjen e Nerimanës mundem me dhënë përgjigjen, për shkak që është në lagjen Dardania dhe te rruga Nazim Kokollari. Mungojnë trotualet, aty është duke vazhduar dhe besoj që brenda muajit do të përfundojnë edhe trotualet edhe për te parku veç e dhashë përgjigjen edhe për Onurin, po e njëjta vlenë edhe për Nerimanen. Eldis, mu ke bërë pyetjen për asfaltimin e rrugës në Lubinje. Ai projekt është projekt i Ministrisë, nuk është projekt i Komunës, e di që është shumë rast i rëndë pasi që është gërry dhe ka mbetur ashtu i hapur dhe krijohet shumë telashe gjatë lëvizjes së automjeteve, po është projekt i Ministrisë dhe nuk kemi, ne si Komunë nuk kemi qasje fare në atë në atë projekt. Ilir Gashi, i ke bërë pyetjen për gropat në disa rrugë në qytet. Ne veç kemi filluar, janë duke punuar në terren, operatori ka urdhëresat të gjitha gropat që janë të hapura në të gjitha lagjet e qytetit është duke punuar edhe pse me intensitet pak më të ngadalshëm për shkak të anës financiare, por ne kemi dhënë urdhëresë se të gjitha rrugët faktikisht janë në qytet, të gjitha gropat të rregullohen, çka janë me asfalt të mbulohen veç ka marrë disa urdhëresa, veç është në terren duke punuar. Dhe më ke bërë pyetjen për lagjen 2 korriku. Tha edhe nënkryetari po e them edhe unë që ajo kontratë është nënshkruar vitin e kaluar, në lagjen 2 Korriku dhe afati asaj kontratës është deri në vitin 2027. Për shkak mjeteve financiare është ndalur ritmi i punës, është duke punuar por me një ritëm më të ngadalshëm dhe vetëm për shkak mjetet financiare, për shkak që mjetet janë marrë nga përmbaruesi dhe nuk po kemi mjete që t'i bëjmë presion edhe operatorit që të vazhdojë me punu, edhe pse i kam takuar personalisht dhe kam kërkuar që në qoftë se është hapur një rrugë mos të hapet një rrugë e gjatë, të hapet 100 m, që ajo 100 m përfundon, jo të hapet rrugë e gjatë edhe të lehet rruga e hapur për një kohë të gjatë edhe t'ia vështirësojë lëvizjen e qytetarëve dhe banorëve të asaj lagje, por besoj shumë shpejt që ai në ato pjesë ku e ka hapur do ta përfundojë dhe do të vazhdohet mbas mjeteve do të vazhdohet të përfundojë, do të i rregulloj edhe pse kontrata e ka deri në vitin 2027 është e vlefshme. Liridona, fshati në Vlashnje, tek Ura. Unë nuk jam i informuar për këtë rast, do ta nga ky moment do të urdhëroj të zyrtarët e mi të dalin, por është mirë të informohet edhe inspektoriati pasi që ka pengesa këtu si po e shoh unë që ka edhe bllokim të asaj rrugë dhe uzurpim. Unë besoj që duhet të informohet edhe inspektoriati edhe pse drejtoresha s'është këtu, por sa i përket kësaj qasjes, asaj urës aty, do dalin edhe zyrtarët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, por është mirë edhe inspektoriati të del në terren. Dafina Alishani, më është bërë pyetje në lidhje me sa kontrata keni për ndriçim. Ne kemi dy kontrata për ndriçim. Njëra është një linjë për linja të reja të ndriçimit dhe një tjetër që është nënshkruar para dy muaj është për mirëmbajtje dhe jeni të vetëdijshëm që në këto muajt e fundit ka përmirësim të ndriçimit të publik në qytet, nuk domethënë që s'ka përmirësim. E vërtetë që ka pasur ka pasur probleme në ndriçimin, por gradualisht është duke punuar ekipi, por për shkak që ka pasur shumë probleme dhe janë tre ekipe në terren dhe është duke vazhduar. Ne kemi dhënë fokus të veçantë të lagjeve të qytetit, po edhe nëpër fshatra, por do të përfundon shumë shpejt në qytet, brenda pak muajve do të ketë në të gjitha lagjet e qytetit do të ketë ndriçim. Është duke punuar, ka pengesa për shkak sa e kuptova keq po bën si xixëllonja por është një problem te ndriçimi në disa lagje sa rrugë po është i gjatë po lypet me u vazhduar një farë

aparati i veçantë ne e kemi bërë veç kërkesën në KEDS të rrit voltazhin e rrymës për me se bëj për shkak ngarkesa që është dhe një e kemi porositur na ka ardhur e kemi nënshkruar kontratën dhe e kemi bërë pagesën ka qenë pagesa e vogël po u presim shumë shpejt edhe në rrugë tjera ku ka kësi pengesa të intervenohet me atë aparat që të mos ketë pengesa për shkak ngarkesës, ndërsa lagjet tjera është duke punuar që të mbulohet komplet lagje të qytetit të ketë ndriçim. Nuk e di dikujt në qoftë se i kam mbetur borxh, Albanit mos gabosha, Albani ka pasur një kërkesë që ma ka bërë edhe më herët për tranzitin, për shpejtësinë. Albani e di që i ke ata, që i mëson ata nxënësit për patentë shofer, po mirë është me i mësuar me atë shpejtësinë që kemi të kufizuar e të vogël se me ia rritë shpejtësinë edhe fillestar, mund me pas telashe, por për shkak që ajo është unë kam biseduar edhe me zyrtarët e komunikacionit për shkak që ajo lagje është bërë shumë e banueshme dhe ka shumë ndërtesa dhe shumë banorë aty që janë ndërtuar banesat. Andaj është shumë e pamundur që të rritet shpejtësia. Edhe pse edhe mua më pengon personalisht. Por jemi duke këqyrë me bë një zgjidhje që më së paku për një 10 km në orë. Por ato jemi duke pritur përgjigjen nga ekspertët e komunikacionit, deri sa na ktheni përgjigjen, e kemi bërë kërkesën zyrtarisht na njofton se si është e mundur të rritet 10 km në orë, por më mirë është më kadalë se jo shpejt. Dikush që i kam mbet borxh që kam harruar me shënuar mirë me ma thënë.

Petrit Hoxhaj (GUXO): Rreth kësaj shtëpisë së bardhë, do të thotë mbrapa, në oborrin të shtëpisë së bardhë është krijuar do të thotë një deponi. Me të vërtetë është jo dhe e hijshme sepse, sepse ndriçimit publik veç janë duke i paluar aty. Do të thotë kanë mbetur edhe disa makina të vjetra të Komunës. A ka mundësi që me u pastru ky oborri i kësaj shtëpisë, sepse vetë pamja kur vijnë delegacione të huaja dhe e shohin gjendjen se qysh është si oborri i Komunës, kishte me qenë mirë që të pastrohet, sepse shpesh herë edhe njerëz po thonë ka fillu me u bërë sikur këto bizneset që merren me hekra, shporetat, lavatriqet, thjesht gjithçka është tu palu do thotë në këtë mbrapa kësaj, ish kanë mirë që të pastrohet dhe të krijohet mundësia edhe e parkingjeve të cilat vijnë vizitorët ose edhe ne kuvendarët që vijmë në këtë seancë. Faleminderit.

Islam Ukimeri: Faleminderit Petrit. Po më vjen mirë që e the se këto shtyllat e ndriçimit që po vijnë që po punohen realisht nëpër lagje të qytetit dhe nëpër fshatra që po i qesim të reja, po i vendosim këto të vjetra këto, po më vjen mirë që e the. Po është e vërtetë veç jemi në proces dhe jemi në përfundim të asaj, edhe pse nuk është në dikasterin tim, por po jap përgjigje se jam i njoftuar. Jemi në përfundim të procesit që të gjitha ato që janë të panevojshme do të largohen nga mbrapa oborrit të shtëpisë bardhë që është dhe shumë shpejt do të përfundon dhe do të pastrohet ajo pjesë. Faleminderit. Mos gabofsha mbetja e borxhit dhe Dafinës për veturat edhe pse unë te inspektorati por po ja kthej përgjigjen, mbrapa shtëpisë së bardhë parkingu. Po ne veç duhet edhe inspektorati të njoftohet edhe ka shumë vetura që janë edhe të njerëzve që nuk banojnë fare kanë lënë me vite të tëra aty apo me muj të tëra aty. Është mirë sa më shpejt të intervenohet, po unë do të rekomandoj edhe inspektoratin që të del dhe të inspektojë dhe t'ju urdhëroj se sa më shpejt të lihet i lirë ai parking mbrapa shtëpisë së bardhë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor, fjala për ju drejtor i urbanizmit Florent Ukaj.

Florent Ukaj: Faleminderit kryesues, deshta me përgjigj pyetjes së Ilir Gashit për lidhje me lejen e stadiumit të Lirisë. Ne e kemi lëshuar njoftimin për plotësim të dokumentacionit dhe jemi në pritje të që ai dokumentacion të na kompletoj. Në momentin që na vijnë dokumentet ne jemi të gatshëm, jemi në koordinim edhe me ministrinë e kulturës që sa më shpejt ta bëjmë një zgjidhje dhe ta japim atë leje. Po normal që pa i pas disa pëlqime nuk mundemi. Ndërsa për Alban Bislimaj, e ftoj që nesër të vijë në zyrë edhe ta diskutojmë se pasi është një çështje pak më e ndërlikuar. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Fjala për ju drejtor i shëndetësisë Sylejman Baxhaku.

Sylejman Baxhaku: Faleminderit kryesues. Referuar kërkesës së shqetësimit të Liridonës, lidhur me mungesën e reagentave për realizimin e hormoneve, tash po flas me gjuhën e popullit, reagentave që realizohen për konstatimin e nivelit të sheqerit në gjak në tre mujor, është e vërtetë që mungon. Kjo krejt lidhet pa dashur me u stërzgatur me mungesën e fondeve, s'kemi mundur as me siguru mjete, po as me siguruar një fond prej nga mund me bë pagesën në këtë moment. Ka pasur vonesa, por kjo do të realizohet shumë shpejt, ndoshta për tre-katër ditë. Gjithashtu, këtu duhet me cek ose me bë të ditur se ne kemi përveç asaj do t'i sigurojmë edhe disa glukometra që quhen, të cilat kjo deri në moshën 18-vjeçare do t'i sigurojë fëmijëve matjen e sheqerit në gjak në 24 orë, me një sistem digjital që do t'i informojë përveç personave që vuajnë nga ky problematik, përkatësisht fëmijëve edhe prindërit e tyre 24 orë për nivelin e sheqerit në gjak të këtyre fëmijëve. Kjo përveç që do ta lehtësoj kujdesin për fëmijët nga ana e prindërve, kjo do t'i krijoj natyrisht komoditet edhe këtyre fëmijëve, sepse nuk do të kenë këta nevojë pastaj edhe për analizat tre mujore, se kjo do ta kalkulojë automatikisht çdo tre muaj nivelin e sheqerit në gjak. Natyrisht kjo do të kufizohet për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, për shkak se është e pamundur me i furnizu të gjithë për shkak të kostos së lartë. Këtu duhet me falënderu kryetarin e Komunës tek i cili kam hasur mirëkuptim për realizimin e këtij projekti sepse do të jemi një prej Komunave të para, jo një por Komuna e parë që do të realizojmë këtë projekt, është shumë i rëndësishëm natyrisht. Ndërsa referuar kërkesës së zonjushës Dafina për papastërtinë në institucionet dhe përreth tyre natyrisht e gjitha kjo prapë lidhet me mungesën e fondeve dhe pamundësinë për t'u furnizuar me pajisjet dhe materialin e nevojshëm shpenzues. Natyrisht nuk e arsyeton kjo, por është një ana prej e shkaqeve. Me aq sa kemi mundësi ne do të bëjmë të gjithëka duhet për me mbajtë nivelin e pastërtisë në institucion dhe përreth. Natyrisht përreth institucionit i kemi vërejtur disa parregullsi, i kemi diskutuar edhe me drejtorin e Ekoregjionit. Natyrisht edhe me një kompani e cila do të na ndërtojë një deponi të mbyllur ku do t'i fusim kontejnerët. Kjo do ta pengojë përhapjen e mbeturinave përreth QKMF-së dhe do ta pengojë derdhjen e mbeturinave nga banorët përreth dhe lagjeve përreth që nuk i takojnë asaj zone. Shpresoj që ju kam dhënë përgjigje të mjaftueshme. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Fjala për ju, drejtoresha e Kulturës, Ailin Shishko.

Ajlin Shishko: Faleminderit kryesues. I kam dy çështje që është ngritur për mënyrën e shpërndarjes të subvencioneve nga Ilir Gashi dhe Shukri Quni. Dua të theksoj se drejtoria nuk ka bërë përzgjedhje individuale ose politike. Përgjegjësia ime ka qenë të sigurojë zhvillimin e procesit sipas procedurave ligjore dhe administrative, ndërsa pikëzimi dhe vlerësimi është bërë nga ana e komisionit. Siç e ceku edhe kryetari, Prizreni është një ndër Komunat më të dëmtuara nga ana e buxhetit. Pavarësisht shumë kërkesave të shumta që i ka pasur Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, është punuar me një buxhet shumë të reduktuar dhe shumë të kufizuar në krahasim me vitet e mëparshme. Dhe kjo ka qenë arsyeja pse disa organizata dhe klube nuk është mundur me u financu edhe pse projektet e tyre kanë qenë cilësore. Një pyetje e kam prej Mergiton Gavazaj për shtëpinë e Kulturës në Zhur, aty ka mbetur vetëm lidhja e rrymës, ne kërkesën e kemi drejtuar te KEDS-i jemi në procesin e marrjes një përgjigje nga institucioni. E kam një pyetje nga Sevil Kazaz.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoreshë. Po fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Ti drejtoreshë, ti je organi më i lartë aty në atë zyrën ku je ti aty. Ne bëjmë aty kërkesa edhe këtu janë ato që ata nuk i realizojnë, ne këtu me t'i thënë ty. Për politikisht unë vjet vitin e kaluar nuk kam marrë subvencion, e di unë atë. Po unë e thashë se ishte ai drejtori këtu. Atij i kam bërë mirë, por ty s'po di se ty s'të kam bërë mirë hiç. Ty s'ka pasur nevojë me na ndarë neve. E di që e ke komisionin por unë po kërkoj ajo që më takon mua. I takon atij, asaj shoqërie kulturore artistike i takon me ligj ajo. Edhe dëgjo çfarë po të them, po të flas sikur vajzës time, respekto detyrën që e ke marrë. Ne këto përkthyesi i kemi për ata që nuk dinë shqip edhe flasin edhe boshnjakisht edhe turqisht. Ai që di në shqip ne nuk kemi nevojë këtu me i vnu, mos e keqpërdorë detyrën. Shumë mirë e dinë zonja atje, që ajo ku të flet unë menjëherë e vë këtu dëgjuesin për me marrë vesh çka po thotë. Mos se jeni tu e tepru, të reja jeni hala duhet me u mbush me dije. Kritikën kur t'ia japim, merrni kritikën. Ju kam dhënë unë edhe këtyre djemve të rinj të PDK-së shumë kritika. Se keni me u pendu dikur, pendohesh dikur por vonë është atëherë. Me ligj janë këto të garantuar gjuha këtu në asamble, secili e flet gjuhën e vet. Ti në rast se je me kombësi turke atëherë më fal, të kërkoj falje.

Ajlin Shishko: Unë me kombësi turke nuk jam, unë jam shqiptare. Sa i përket ligjit, ligji e parashe dhe mënyrën e shprehjes. Unë mund me u shpreh si të du.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala, fjala për ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Drejtoresh vetëm të qartësohem, do të thotë ka pare me subvencionu festivalin që e ka nxit kryetari të muzikës dhe nuk ka pare për me organizu edicionin e 18 të Panairit të Librit. A është kjo përgjigja juaj, apo?

Ajlin Shishko: Unë e thashë edhe më herët, vlerësimi është bërë nga ana e komisionit. Komisioni është marrë me pikëzimin edhe rekomandimin e projekteve.

Ilir Gashi (LVV): Atëherë, ... subvencion për festivalin muzikor të kryetarit. Me pas këtu e ke shkelje të ligjit me dy këmbë, me dy duar, me krye, me vesh, me krejt e ke. Po nuk i hin...

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoreshë për përgjigjen. Fjala për ju drejtori i bujqësisë Nderim Kadriaj.

Nderim Kadriaj: Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për qytetarët që po na ndjekin. Sa i përket pyetjes së kuvendarit Shukri Quni për dezinfektimin dhe deratizimin e lumit në Nashec. Jemi në fazën e formimit të komisionit domethënë në kuadër të zyrës së prokurimit për vlerësimin e ofertuesëve dhe në moment që përzgjidhet ofertuesi unë i premtoj Shukri Quni që bashkë kemi me dalë me ndjekur prej afër deratizimin dhe dezinfektimin e lumit në fshatin Nashec. Sa i përket strehimores së qenve endacak, ndoshta është përgjigja e tretë ose e katërta që jam duke e dhënë të njëjtën, po garant kur po i shtjerrën pyetjet të kuvendarëve domethënë po drejtohen direkt. Strehimorja e qenve pritet me përfundë këtë vit. Inshallah gjërat shkojnë në rregull në bazë qysh e kemi planifikuar dhe Prizreni do ta ketë strehimoren për qentë. Respekt.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Atëherë, a doni pauzë apo të vazhdojmë menjëherë? Pika që është me renditje është shtjerrë debati. Mundësisht ta kryejmë edhe këtë pikën, i lirojmë edhe këta zyrtarët e shërbime publike. Vazhdojmë apo?

Dafina Alishani (LVV): Kryesues, ju thatë që kjo është pikë e re.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pikë e re është.

Dafina Alishani (LVV): Po tash po thoni që është shtjerrë debati. A po koncentrohemi ju lutem? A është pikë e re apo jo? A bën me marrë pauzë? Pas pauzës shihemi edhe diskutojmë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Na mund t'i pyesim këtu se kanë edhe obligime, janë në fushatë shumica, për ato po i pyes. Atëherë e hedhim në votim sa jemi që të vazhdojmë me pikat e radhës të rendit të ditës. 17 janë për, kundër? Atëherë nuk ka kundër, vazhdojmë me pikën e rendit.

Dafina Alishani (LVV): Veç pak kryesues, rendin e ditës ne e votuam apo jo? Çka është tash ky votimi ekstra? Pse keqpërdor pozitën që e ke? Nëse do me pas bashkëpunim i thirr si qysh është tradicionalisht i fton shëfat e grupeve pesë minuta ja merr deklaratat e atyre edhe vazhdon çka është kjo me shti në rend ditën një send që nuk është.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dëgjo Dafina, koncentroju pak. Shumica janë të angazhuar në fushatë. A dojnë me vazhdu që na mundet.

Dafina Alishani (LVV): Po ju me pas menduar fushatën, nuk i kishit vendosur këtë seancë bash disa ditë para.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ajo është çështja e jemja se qysh e mendoj ti s'ke çka...

Dafina Alishani (LVV): Është çështja e juaj por duhet me pas konsideratë për të gjithë ata që garojnë edhe që i kanë obligime të tjera. Me pas pas. Po e keni hallin tjetër ka, vazhdoni, po ju lutem mos keqpërdorni pozitën. Rend i ditës është votuar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë, vazhdojmë.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban.

A ka diskutime këtu? Po, fjala për ju Agim Muqaj.

Agim Muqaj (AAK): Pikërisht për këtë pikë kam ardhur dhe si ta kryej heci. Kryesues, unë edhe herën e kalume sigurisht se kam qenë pro kësaj pike me një vërejtje të caktuar, po veç një kisha dashur paraprakisht para se ta votoj, atë vërejtjen që kam pasur herën e kalume, kërkoj që ajo vërejtje të mirret serioze, që mbrenda një afati shumë të shkurt të futen edhe fshatrat aty në atë subvencionim, e di që është benefi i gjithë qytetarëve, por një send po ju garantoj, në rast se vitin e ardhshëm nuk kryhet kjo punë me një premtim që do të jetë, po të betohem që me plot qytetarë ka me blloku komplet qytetin. Me votu do ta votoj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju nënkryetari i komunës.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit. Vetëm ta qartësojmë këtë kërkesën se e kishit pas edhe në seancën e kalume. Në fakt kërkesa dhe është legjitime Agim, po duhet me bë një analizë më e thukët, për shkak se janë 74 fshatra, operojnë dhjetra kompani të ndryshme nëpër fshatra edhe ajo që është më e rëndësishme, aktualisht Komuna nuk ka kapacitete buxhetore me mbulu dhe atë pjesë të fshatrave. Edhe një send tjetër që është po mendoj i rëndësishëm, është fakti që kompanitë kryesisht nëpër lokalitete urbane funksionojnë edhe me fitime domethënë kompanitë që janë jashtë qytetit. Kurse kompanitë që operojnë brenda qytetit jo vetëm te ne, por edhe në secilën qytet të Kosovës, madje edhe në shumë qytete të Evropës operojnë me humbje dhe shumë qytete e shtete sot janë detyru me i financuar trafikun brenda qytetit për me krijuar një mundësi më të madhe që qytetarët mos me përdor vetura por me përdorur autobusë më shumë, sidomos në periudhën e sezonit kur jemi të gjithë dëshmitarë që po bëhet kaos urbanistik, jo kaos trafiku. Kështu që për më vonë besoj që do ta shqyrtojmë se ky vendim nuk është prej betoni mundet me ndryshu sa herë që ka ide më të mira edhe sa herë që ka mundësi të tjera financiare. Po për këtë fazë domethënë është vetëm kjo mundësi.

Agim Muqaj (AAK): Veç një sekond të lutem se me të vërtetë që kjo më vonë mua s'më pëlqen shumë. Kam qef pak më konkret me qenë dhe në pyetje dhe në përgjigje. Pro jam edhe po më vjen shumë mirë kjo iniciativë është shumë e mirëseardhur që po bëhet edhe me kënaqësi do ta votoj. Mirëpo sikur që e cekta, të lutem jo më vonë, vitet e ardhshëm mbas dy viteve a ka planifikim Komuna e Prizrenit? Edhe sigurisht se ne sot e kuptuam edhe e kam kuptuar prej shumë kolegëve të Komunave të tjera që të gjitha këto Komuna që nuk i udhëheq Vetëvendosje janë në kolaps nga bllokimi i qeverisë. Për këtë jam i vetëdijshëm dhe nga informata shumë burimore për atë i thashë edhe më herët se nuk do të kam kërkesa të cilat janë me para të mëdhaja. Në mirëkuptim, sigurisht se pasi të rregullohet kjo gjendje do të jem këtu edhe do ta ngris zërin sa herë që ka nevojë. Mirëpo, kërkoj a ka afat që edhe fshatrat përreth sidomos nëpër ato fshatra që janë me vendbanime të mëdhaja, kanë shumë punësime, shumë studenta, që të ketë një afat të lutem nënkryetar, dua

përgjigje të saktë mbas një viti, mbas dy viteve. Por në momentin që dhe ta jepni një afat, sikur që e thashë, do ta bllokoj qytetin në rast se nuk realizohet.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit Agim. Disponimi dhe vullneti i Komunës është për me realizu këtë propozim të juaj, sepse është edhe ide dhe propozim i joni. Për vitin 2026 edhe 2027 kjo punë nuk bëhet, për shkak të mungesës së mjeteve financiare në 2028 nëse ka stabilitet financiar në komunë, gjithçka vjen në binare të vet, përfundon pjesa e kontratës kolektive dhe procedurat përmbartimore edhe normal komuna fillon me një buxhet të ri, pse jo, është e mirëseardhur në bashkëpunim edhe me kompanitë, sepse unë besoj që kosto e këtij projekti nuk është shumë e madhe nëse Komuna do të kishte stabilitet edhe do të funksiononte normalisht, por tash jemi të funksionu në gjendje të jashtëzakonshme.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit nënkryetar. Fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues. Nënkryetar, me një anë thoni nuk kemi buxhet. Në anën tjetër kërkon me u votu kjo edhe kjo do pare pa buxhet edhe kjo nuk bëhet. Thashë s'po di ka po i merrni këtë buxhet edhe ka po do me u rregullu kjo punë kaq shpejt. Unë propozova atë ditë, thashë që le të hyjë edhe një nen, që le të përfshihen edhe viset rurale. Mos t'ju them fshatarë se shumë juve, më falni ti, po shumë këtu, këta të shërit neve, na ka pas thënë njëri këtu në këtë farë kuvendi. Këta hiq po e din që na kanë thënë edhe më herët, që hyni deri në ora 4:00 edhe hecni ju. Po, ne i kemi parë këta dhe në vitet e 90-ta kush janë. Që kanë bashkëpunu me atë armik që kemi luftuar në kundërt të tij. Ne i kemi parë këta dhe kur kanë punu këta dhe me masa të dhunshme. E neve na kanë larguar prej pune. Se dikujt duhet me i bërtit se nuk o ka merrë vesh shqip. A i venë ato me dëgju apo jo nuk e di. Unë a di çfarë kisha propozu? Masi jam fshatarë, se katundarët i kemi prurë në sheher. Me na qit një taks ka 10 euro për me hy në Prizren, sinqerisht e kam edhe në rast se është... t'i quaj burra tash këta të pozitës, e kishin votu edhe ata edhe kjo me hy aty që çdo qytetar që vjen, jo me ja pagu katundarëve biletën, po me ja qit taksa edhe 10 euro me i thënë që ti kur të vjen në Prizren paguaj edhe këtë taksë. Kështu janë duke lyp këta, ka vdekur ajo kohë. Ky kuvend ku janë duke fol këta këtu, ky i ka themelet në gjak. Nuk na kanë krijuar këta ish pushtetarët, ish bashkëpunëtorët e udhasht. Ky kuvend është bërë me gjak, ky shtet jo me luajt këtu. Secilit i garantohet e drejta me ligj, kush e ndin veten që është në atë a është shqiptarë, a është turke, a është boshnjake, a çka do qoftë të gjithë i kanë të garantuar me ligj. Unë kam qenë kundër kësaj, prapë jam. Nuk ka nevojë me shku populli jonë në raste sociale, me ju pague shpenzimet e udhëtimit. Ka nevojë i kemi cekur ata, njerzit që janë me aftësi të kufizuar, pensionerët, njerëz që jetojnë me social, ata që nuk i kanë kushtet, ata që i kanë kushtet nuk ka nevojë me ju pagu atyre bileta. Ne duhet me ju siguru punë, me ju kriju kushtet, me pas rrogën e mirë, ai e nxjerr biletën vet. E jo ne me shkue nga fukarallëki. Ne jemi tu i pri fukarallëkit. Unë jam gjeneratë që kam punuar në vitet 90-ta pa asnjë cent hiç. E di në Kujtim se nxënës të kam pasur, s'ke harruar ndoshta. Edhe nuk kemi ra në raste sociale, kemi qëndruar. Deri kur ka ardhur që kjo kohë sot. Doni me na kthyer në ato gjendje të cilat as nuk bën me i mendu në ato. Populli duhet me ec përpara, jo me kesi far subvencione. Duhet na me ec me projekte të mëdha. Keni me u pendu po ju tregoj, sidomos do kolegë këtu që po votojnë pa e ditë kanë njëherë edhe për çka.

Më vjen më vjen keq që po ju them, e din por politika e detyron. Unë kam dalë të gjithë edhe kundër politikës kur s'ka qenë e drejtë edhe kur s'ka qenë në interes të qytetarit. E kur është interesa personave, ose interesa klanore dora ime nuk ngritet. Kjo nuk është në interes të qytetarit edhe ju kam thënë edhe në Komitet për Politikë e Financa, edhe sot edhe mbledhjen e kaluar, unë nuk kam votë për këtë. Kurrë mos të më voton kërkush pse unë nuk e votoj këtë pikë. Sepse mbesin edhe njerëz të tjerë me këto, mbesin edhe shumica pa punë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kalohet në proces të votimit. Sa jemi prezent? 24 jemi prezent kemi kuorumin. Sa jemi për? 22 për. Kundër? 2 kundër, Abstenim? Nuk ka. Atëherë miratohet pra pika e rendit të ditës shqyrtimi dhe miratimi i propozimit vendimit për subvencionimin e transportit urban.

Kalojmë te pika e radhës. Po vazhdojmë edhe këtë pikë edhe vazhdojmë te pika e pestë.

Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit.

E ftojmë iniciuesin e pikës që ta bëjë prezantimin e rregullore apo drejtori i shërbimeve publike. Mirë, fjala për ju.

Muhamet Bajrami (Zyrtar i Dshp): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Sot jam këtu para jush për të bërë prezantimin e rregullore për menaxhimin e mbeturinave, procedurat e ndjekura dhe respektimin e ligjeve për hartimin e kësaj rregullore. Domethënë ky proces ka filluar me marrjen e vendimit prej kryetarit për formimin e grupit punues për hartim të kësaj rregullore, ku përfaqësuesit e këtij grupi kanë qenë Drejtorisë Shërbime Publike, Drejtorive të tjera të Komunës Prizrenit, Shoqërisë Civile dhe Kompanisë Shërbyese të Grumbullimit të Mbeturinave. Pas marrjes së vendimit është bërë hartimi i draftit dhe memorandumit shpjegues, ku Komuna ka hapur konsultimin publik nga data 27.04.2026 deri me datën 12.05.2026 në përputhje me ligjet për vetëqeverisjen lokale. Njëftimi publik është publikuar në web-faqen e Komunës së Prizrenit, në platformën e konsultimeve publike dhe në rrjete të tjera sociale, ku ka pranuar vërejtjet dhe komentet të qytetarëve në lidhje me këtë rregullore. Ndërsa takimi publik me qytetarët është mbajtur këtu në këtë sallë me datën 5/5/2026 dhe ku ka pasur diskutime, kërkesa, komente prej qytetarëve dhe përfaqësuesve të bashkësive lokale. Kjo rregullore rregullon dhe përcakton mënyrën e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, grumbullimit, të shërbimit, transportit edhe deponimit final të mbeturinave, si dhe përcakton menaxhimin e sistemit. Me këtë rregullore menaxhimi i mbeturinave kalon prej Komunës tek kompania shërbyese, e cila do të marrë përgjegjësitë për shërbim dhe inkasim të të mjeteve. Këto janë pika të shkurta, prezantimi i kësaj rregullore. Faleminderit për vëmendjen. Materialin e keni pasur me siguri e keni lexuar. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. A kemi ndonjë pyetje prej kuvendarëve? Po, fjala për ju Arianit Berisha. Mund të ulesh këtu.

Arianit Berisha (PDK): Më shumë koment se pyetje. Fillimisht e kuptojmë nevojën e kësaj kërkesë, duke pasur parasysh rritjen e çmimeve në të gjitha sferat, mirëpo kjo rritje e çmimeve padyshim që reflekton edhe te punëtorët e kësaj kompanie, të cilët me plot gojë e them që janë heronjtë e ditëve të sotme, për shkak se është një punë që jo çdokush mundet me bë. Prandaj, po dua me shfrytëzu rastin që përmes foltores së kuvendit, me i falenderu për kontributin e tyre, për punën e jashtëzakonshme që e bëjnë për pastërtinë që e jetojmë secili prej nesh dhe gjithashtu me kërku nga bordi dhe nga kryeshefi përveç lëvdatave, përgëzimeve, për punën që e bëjnë në menaxhimin e kësaj kompanie, me kërku që kjo rritje e çmimit të inkasimit të reflektojë drejtpërdrejtë edhe në rritjen e pagave të punëtorëve për shkak se në bazë të informatave nga kolegë, nga shokë që kemi ata janë goxha me punojnë me paga të ulëta dhe e bëjnë një punë shumë fisnike. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. Fjala për ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesues. Përsëritet për ju, për drejtorët, për anëtarët e Kuvendit, media këtu. Pak më parë ne votuam një subvencionim disa kategori, ndërkohë derisa debatohej për subvencionimin e trafikut urban edhe në mbledhjen e parë, por edhe në mbledhjen e fundit të Komitetit për Politikë e Financa, lindi kërkesa që të futen në kategori të subvencionimeve edhe punëtorët e ekoregjionit. Sot na vjen një vendim këtu për me i rritur çmimet. Unë personalisht po më duket u kërkuar edhe nga të tjerët që sot në këtë seancë, kur po debatohet për rritjen e çmimeve, për punën që po bën ekoregjioni do të duhej të ishte prezent një përfaqësues i ekoregjionit këtu dhe të merrte disa zotime konform kërkesave tona. Unë po pajtohem plotësisht sepse kërkesa është e atillë sikurse Arianiti që e bëri, nuk do të duhej me u ndie mirë as Drejtoria e Shërbimeve Publike, e posaçërisht menaxhmenti i Ekoregjionit, kur në seancën të kuvendit kërkohet që punëtorët të tij të futen në kategori sociale për subvencionim si kategori të ndryshme të rangut social në Komunën e Prizrenit. Andaj ne sigurisht që do ta votojmë sepse jemi të vetëdijshëm për koston, për rritjen e çmimeve, në të gjitha sferat, në të gjitha lëmitë. Natyrisht edhe ata kanë nevojë për me i rritur këto çmime, mirëpo do duhej që me u zotuar para nesh, para qytetarëve të Prizrenit që edhe ata duhet të jenë kategori sepse po kryejnë shërbime realisht jemi të kënaqur me me shërbimet që i kryen. Këtë e kam thënë edhe një ndër seancat e kalume, por edhe punëtorët duhet të jenë të kënaqur me menaxhmentin apo me vendimet që i marrim ne. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Haziz, fjala për ju Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues. Ne edhe në Komitet për Politikë e Financa punëtorët e ekoregjionit ju kemi dhënë lavdata, i kemi përgëzuar për punën që e bëjnë por para si kemi dhënë. Se ata janë të nevojshëm për rroga, atë e di. Edhe me ju rrit pagesa është shumë mirë. Po edhe atë propozim që e dha kolegu Haziz Hodaj edhe është shumë mirë që ata duhet me u përfshi, që ata duhet me u përfshi për me ja siguru udhëtimin. Po unë ku nuk u pajtova në mbledhje për Komitet për Politikë dhe Financa, te pagesa, pse pagesa me u heq tash nga kuvendi komunal e me kalu me kry këtë punë e ekoregjioni. Një gjë të tillë e ka bërë dhe hidroregjioni, e kam thashë fjalën edhe

hidroregjioni jugor e ka pasur me diftesa shtëpi për shtëpi. Po kur mbërrinin paret atje, nuk u dinte. Andaj, ne kemi bërë pagesë në kuvend komunal. Pagesa është bërë për tërë vitin, 66 euro edhe ke paguar një euro posta që është aty e ke kryer. Tani nuk ka me qenë kështu. Tani s'ka me qenë kështu. Qytetarët që e kanë pasur më lehtë, le ta rrit, le ta bënë 7.50 nuk ka problem. Po kisha lënë unë pagesën me e bë prapë në kuvend komunal. Jo me shkuar pagesa, sepse edhe hidroregjioni jugor e ka pasur kështu, po shiqo tash taksat ku i ka shti e hidroregjioni jugor. E ka shti taksën, domethënë metri kub i ujit është 57 cent. 19 cent e paguan qytetari për kanalizimin. Pastaj është një tarifë tash çfarë po di çfarë është kjo, plus është TVSH-ja, domethënë krejta qetu hynë, ne jemi tu ngarku qytetarin. Rriteni pagesën, po ta bëjmë ne pagesën në kuvend komunal se besoj që kurgjë s'prish kjo punë hiç. Unë qytetarin nuk e shoh që ne po e lehtësojmë me këtë. Se e nesër ajo kompani krej këto ti qet ai nuk guxon ai ty pa t'i qit këto në fakturë. Patjetër kam me i qit. E qytetarët këtu i rëndohen. A patë sa i ka ngrit aty hidroregjioni jugor? Këto s'di a keni, a keni studiuar mirë? Se nuk e di pse hidroregjionit jugor me i pagu ne 19 cent për kanalizim, për çka? Tash ajo shkon tu rrit. Sa kubik ke shku shkon herë për qatë 19 centin. Domethënë neve dikund afër 70 cent po na bjen me pague kubikën e ujit. Si me pi Coca Cola.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po fjala për ju nënkryetar i komunës.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit kryesues. E para, edhe përkundër një rritje të vogël që po ndodh, prapë Komuna e Prizrenit e ka çmimin më të ulët. Edhe në raport me komunën e Suharekës që ka 7.5 euro. Edhe në takimin që kemi pasur me kryeshefin ekzekutiv të ekoregjionit, domethënë me këtë rritje kanë rritur edhe pagat e punëtorëve në kompani, që është normal një lajm i mirë edhe për punëtorët. Po ashtu rritja prej shtatë euro është tarifë fikse. Nuk ka shtesa, siç po ndodh në rastin e hidroregjionit. Se ne nuk kemi domethënë ndonjë farë impakti të hidroregjionit se është kompania e qeverisë. Menaxhohet nga qeveria drejtpërdrejtë. Kurse ekoregjioni është kompani regjionale që Komuna e Prizrenit ka aksione. Edhe fatmirësisht edhe ky kuvendi i ka aksionet e veta se i keni dy anëtarë të cilët i kemi deleguar aty dhe një anëtar e kemi deleguar ekzekutivi pra është drejtori Bexhat Bytyqi. Sa herë kemi nevojë me pas informata ne duhet me kërkuar prej njerëzve që i kemi dërguar atje si përfaqësues të tanë edhe të kuvendit edhe të ekzekutivit. Përndryshe çmim nuk do të ketë më të madhe në faktura por do të jetë çmimi fiks 7euro. Arsyeja pse sot po e bartim që mjetet me u mbledh prej kompanisë është praktike për shkak se në Komunat përreth kjo tashmë po ndodh që disa vite edhe mbledhja, përqindja e mbledhjes së mjeteve është shumë më e lartë sesa që e kemi mbledhur ne si Komunë. Tash kompania natyrisht që ka me u interesuar më shumë me i mbledhur mjetet e veta. Madje ajo ka dhe një mundësi që palët me i çu në përmbarim, që s'e kemi bërë ne, edhe me arrit maksimalisht me i mbledhur mjetet financiare për mbledhjes mbeturinave. Përndryshe, Komuna edhe kur s'ka arritur me i mbledhur mjetet në atë përqindjen e duhur, ne ekoregjionin e kemi paguar. Domethënë, pa i mbledhur mjetet prej qytetarëve, ne u dasht me pagu për shkak të shërbimeve që i ka kryer si kompani. Këto janë arsye praktike edhe kjo barrë që e ka pasur Komuna, bartet te vetë kompania. Edhe kjo është, me thënë të drejtën, është ndodh thashë edhe nëpër krejt vendet edhe të Evropës, sepse secili institucion i mbledh mjetet e veta financiare. Unë po besoj që ka me qenë më mirë, më praktike

edhe siç e keni parë, kompania tash është në procedurë për me marrë punëtorë të rinj, të cilët do të jenë në terren për me i mbledhë mjetet financiare. Në fund të fundit janë mjetet të tyre, le t'i mbledhin vetë, e ne i kërkojmë shërbimet ashtu qysh i paguajnë fakturat. Në anën tjetër, edhe në informatë për juve si anëtar të kuvendit, kryetari do ta merr një vendim si rezultat i një kërkesë të kahmotshme që e ka fshati Landovic, atje është deponia, është e vendosur edhe ata nuk e përdorin tashmë as ujin e pijes për shkak të kontaminimit të puseve dhe të ujërave që shkojnë drejt fshatit dhe kryetari ka vendosur që me ja subvencionu domethënë këtë shërbim të mbeturinave për fshatin Landovic, aty ku është e vendosur deponia, do të ketë një vendim të kryetarit. E kemi bërë një analizë, kostoja nuk është shumë e lartë. Natyrisht që si fshat e kanë merituar qysh më herët që ata mos me pagu për mbeturina, sepse ata e pësojnë më së shumti prej deponitëve të cilave është e vendosur në këtë lokalitet, që ata në vijë ajrore ndoshta s'e kanë as 400-500 m. Këto përafërsisht janë La Shukë, përndryshe pa shqetësim faktura ka me qenë 7€ asnjë cent më shumë. Për hidroregjionin ne nuk mundemi me dhënë përgjegjësi sepse nuk është kompani që e menaxhojmë ne edhe ne nuk kemi as aksione aty.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit. Derisa ti po bisedoje unë e pyeta Asritin, a keni marrë ndonjë kontakt me Ekoregjionin? Ende nuk janë konsituu, kjo përgjegjësi e kujt është konstituimi i këtyre komisionit të aksionerëve? Këto do duhen ose drejtori i shërbimi publik ose kryesuesi me konsideruar fillimisht me ju treguar rrugën edhe mandej me me vazhduar. Edhe një tjetër, çështja e subvencionimit të mbeturinave për fshatin Landovic. Unë nuk e di që fshati Landovicë ka kërkuar këtë mbështetje, kryetari mirë që e merr. Landovica është duke kërkuar, është shqetësim i jashtëzakonshëm për Landovicën po edhe për edhe për fshatra të tjera për rreth, ekzistenca e asaj deponie. Unë e di shumë mirë që kur është marrë vendim këtu në këtë kuvend për zhvendosjen e deponisë prej pjesës Korishës andej që ka qenë këtu, propozuesi apo nuk e di kush ka qenë hartuesi i projektit që na ka prezantuar projektin, na ka premtuar që aty do të jetë jo veç një deponi, po do të jetë një vend ku do të njerëzit do të kenë mundësi edhe do t'u lindë dëshira me shku edhe me pushu. Do të jetë e pasur, aq do të jetë do të jetë e menaxhuar qysh duhet. Kështu që ajo në radhë të parë do të duhej me e kërku menaxhimin qysh duhet asaj deponie, mos me i lëshuar ujërat vend e pa vend ose kohë e pa kohë me kontaminu edhe ujin e pijes të Landovicës edhe fshatrave të tjera përreth. Kjo mbështetje që ju paskët me e bë, kjo as nuk e zgjedh problemin edhe nuk e di që Landovicën kanë kërkuar një privilegj të tillë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit Haziz. E kanë kërkuar në një takim që kemi qenë, nëse s'gabo, ka qenë dëgjime buxhetore. Edhe normal që nuk e zgjidh problemin e deponisë, por megjithatë nuk ja bën një obligim shtesë si barrë. Përndryshe e dini ju, deponitë nuk i menaxhon Komuna, deponitë menaxhohen prej nivelit qendror. Komuna, qytetarët e Prizrenit paguajnë për me i vendos mbeturinat në atë deponi, deponitë menaxhohen prej nivelit qendror. Përdërisa nuk kemi projekte për riciklim, deponia natyrisht që do të jetë aty. Po kjo është përgjegjësi edhe barrë e nivelit qendror. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme që kemi bërë si Komunë herë pas herë me e largu deponinë prej aty, por po ashtu kemi sjellë edhe shpesh herë investitorë të ndryshëm

me të cilët kanë qenë të gatshëm me investu në riciklim të mbeturina, por këto janë projekte nacionale që ne nuk i bëjmë. Për mos me e keqpërdor tash këtë foltore dhe me thënë që këto besoj që do t'i bëjë një qeveri e ardhshme me Bedri Hamzen.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit nënkryetar. Po ta jap përgjigjen Baca Haziz për takimin e aksionarëve. Sa i përket takimit të aksionarëve, ne e kemi sjellë vendimin na ka ardhur ligjmëria prej Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që jemi në rregull. Takimin e kam thirrë ditën e enjte me aksionarët. Këta do ta zgjedhin kryesuesin aty edhe vazhdojnë punën e më tutjeshme. Nuk mundim t'i thirri unë si kryesues pa e marrë ligjmërinë prej ministrisë. Kjo është, gjithçka është në rregull, këta të enjten takimin edhe vazhdojnë punën më tutje. Fjala për ju Agim Muqaj.

Agim Muqaj (AAK): Faleminderit kryesues. Me të vërtetë, gjithë ato që i tha nënkryetari, me të vërtetë i mbështes edhe mendoj se përgjegjësia dhe inkasimi do të jetë shumë më efikas nga kompania dhe nuk do të kenë probleme më siç kanë pasur deri tash. Inshallah vetëm i mbajnë premtimin që t'u bëhet ngritja e pagave atyre punëtorëve. Mendoj se efikasiteti brenda për brenda kësaj kompanie do të jetë shumë më i mirë dhe do të bëhet një vetëdijësim i qytetarëve që të fillojnë me një mënyrë tjetër të pagesave, po vetëm që të rritet cilësia. Mendoj se kjo pagesë nuk është ngritja e madhe sa mund të jetë e papërballueshme dhe do të jetë shumë më efikas se dhe vetë kompania, ose do t'i marrim përgjegjësitë e caktuara nëse e nënvlerësojnë këtë mirë që po ja bëjmë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Atëherë, sa jemi prezent në sallë? 23 jemi prezent kemi kuorum. E hedhim në votim. Sa jemi për? 23 pra jemi për. Kjo pikë miratohet pra si pikë e rendit të ditës. Ju faleminderit. Tash sa doni pauzë? Atëherë në ora 1:30 në sallë të jemi.

PAS PAUZE

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë fillojmë pra me vazhdimin e mbledhjes. Jemi te pika e gjashtë.

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt planit Komunal për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riadherësuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Prizrenit 2026-2028.

E kemi iniciuesin e pikës këtu, e ftojme që ta prezantoj planin. Vetëm në fillim prezantohesh, kush je që para kuvendarëve këtu.

Islam Elshani: Ju faleminderit. Përshëndetje zotri kryesues, zotri nënkryetar. Për të gjithë ata që s'e dijnë, unë jam Islam Elshani, përndryshe jam zyrtar për të drejta dhe Integrimin e komuniteteve, vijë nga zyra komunale për komunitete dhe kthim. Kjo zyrë përveç kërkesave, çështjeve që i kryen për komunitetet jo shumicë, ajo punon edhe në fushën e riatdhesimit. Për të gjithë ata që nuk kanë pasur rast të dëgjojnë për riatdhesimin, atëherë unë e kisha me përshkruar, domethënë me shpjeguar se kush edhe kush janë personat e riatdhesuar edhe me çka mirret kjo fushë. Atëherë po

e përshëndes kryesuesin e Komunës së Prizrenit, deputetë të nderuar, mediat dhe zyrtarët Komunal si dhe përfaqësuesit qytetarë të Komunës së Prizrenit. E kështu riatdhesimi ka filluar që nga viti 2012 do të thotë pas marrëveshjes së shteteve të Bashkimit Evropian me qeverinë e Republikës së Kosovës për kthimin e gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës, të cilët nuk e kanë të rregulluar do të thotë, vendqëndrimin në shtetet e Bashkësisë Evropiane. E që ka qenë edhe një prej përmbushjes së standardeve për liberalizimin e vizave. Dhe qeveria e Republikës së Kosovës ka angazhuar Ministrinë e Punëve të Brendshme, respektivisht departamentin për riintegrimin e personave të riatdhesuar për implementimin e kësaj marrëveshje në nivel qendror, kurse në nivel lokal ka angazhuar zyret komunale për komunitete dhe kthim, të cilët sipas rregullores së qeverisë Republikës së Kosovës numër 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve do të thotë i ka angazhuar zyret për komunitete dhe kthim, ku sipas rregullores së qeverisë Republikës së Kosovës numër 22/2020, për integrim e personave të riatdhesuar dhe integrim e të huajve, neni 43 i kësaj rregulloreje parasheh të gjitha Komunitatet e Republikës së Kosovës. Për këtë çështje është hartuar strategjia nacionale për integrim e personave të riatdhesuar në nivel të qeverisë së Republikës së Kosovës, kurse nëpër nivele lokale janë hartuar plane Komunale për integrim e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve. Varësisht specifikave të Komunës nëpër nivele lokale janë miratuar këto plane nga ana e asambleve. Sipas rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve, numër 22/2020 është paraparë në bazë të nenit 44, Komunitatet të formojnë komisione komunale për riintegrim. KKR-ja, pra komisioni komunal për riintegrim është i formuar nga nëntë anëtarë, respektivisht zyrtarë nga drejtoritë e fushave të ndryshme si dhe zyrtarë të zyrave. Andaj, anëtarët e KKR-së janë këta siç vijnë. Domethënë kemi nga drejtoria e komunale e arsimit, nga drejtoria e punës në mjedisin social, drejtoria e shëndetësisë, drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor, drejtoria e kadastrit, drejtoria e inspeksionit, mandej nga zyrat për çështje gjinore, zyra për integrim evropiane, zyra komunale për komunitete dhe kthim. Duhet të ceket edhe kjo se kryesuesi i këtij komisioni komunal për riintegrim vjen nga Drejtoria e Punës së Meqenies Sociale. KKR-ja ose komisioni komunal për riintegrim merr vendim sipas nevojave dhe kërkesave të personave të riatdhesuar konform pra rregullores të cilën e përmendëm më lart. Ato ose aprovohen ose refuzohen. Sa i përket personave të riatdhesuar, fluksi më i madh i të kthyerve ka ndodhur në vitin 2014, 2015, 2016 e më pastaj duke ra gradualisht deri në vitin 2023, ku me datën 1 janar të vitit 2024 fillon dalja e qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpër vendet e Bashkimit Evropian pa viza. Tani kemi fluks të vogël të personave të riatdhesuar, për momentin të akomoduar i kemi tre familje, me gjithsej 14 anëtarë, dhe tri individë të cilët nuk kanë të zgjedhur çështjen e banimit dhe janë të akomoduar me vendim të komisionit Komunal për riintegrim. Këto persona janë të akomoduar nëpër shtëpi dhe banesa e që qëranë ua paguan Ministria e Punëve të Brendshme. Prej rasteve që janë të akomoduar kemi nëna vetëqyese, persona të shtyer në moshë pa përkujdesje, persona me probleme shëndetësore dhe persona të kthyer me të kaluarën kriminale. Dy vitet e fundit kemi të kthyer edhe të huaj, domethënë me mbrojtje ndërkombëtare, nga vendet e konfliktit dhe që për ata është kompetente Ministria e Punëve të Brendshme. Respektivisht departamenti për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin të huajve. Kurse ne si zyre vetëm njoftohemi

se ku ndodhen dhe u ndihmojmë në shërbimet sociale për të cilët kanë nevojë. Në Komunën e Prizrenit për momentin i kemi vetëm një familje tetë anëtarësh nga Jordania. Kurse vitin e kaluar kemi pasur edhe një zonjushë e cila ka qenë nga Ukraina, por qysh vitin e kaluar ajo ka kërkuar të transferohet në Prishtinë. Kështu që kemi vetëm një familje tetë anëtarësh nga Jordania. Dhe për fund deshta me e cek se ky plan Komunal për integrim për integrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve për periudhën 2026-2028 nuk ka kosto financiare. Do të thotë nuk buxhetohet nga buxheti i Komunës së Prizrenit, por nga buxheti i qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht nga Ministria e Punëve të Brendshme. Kaq sa i përket riatdhesimit, nëse eventualisht ka dikush ndonjë pyetje, jam i gatshëm të përgjigjem. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit për prezantim. E hapim diskutimin që kanë pyetje. Po, fjala për ju, Haziz Hodaj. Faleminderit.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit zoti Elshani për raportin edhe për punën. Po më bëni përshtypje, kjo kategoria e të kthyerve me të kaluar kriminale që po thoni edhe këtyre të huajve. A keni ju ndonjë raport prej organeve të sigurisë së shtetit për ta? Kush janë ata? Çfarë bëjnë këtu? Në rregull që s'ka kosto, po mund të jetë ndonjë kosto më e madhe, pastaj nëse janë ata përfaqësues ndonjë shërbim sekret apo diçka tjetër. Kështu që a keni ndonjë raport prej organeve të sigurisë shtetërore, kush janë ata, çfarë janë ata? Me të cilët ju merreni? Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Mund t'i përgjigjesh?

Islam Elshani: Zoti Hodaj, me siguri ka ndonjë raport, por ne si zyrë komunale për komunitete dhe kthim nuk kemi kësi lloj raporti, po me siguri Ministria e Punëve të Brendshme besoj që ka kësi lloj raporti për persona të cilët kanë të kaluar kriminale dhe kthehen prej shteteve të perëndimit. Mendoj që ka, ne si zyrë nuk disponojmë me kësi lloj raportesh.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Bajram Kasrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. Zotëri Elshani, në kohën e fundit kemi një numër jo të vogël të lypsarëve, kryesisht janë prezantohen si palestinez, ku ta di unë dhe nuk është numri i vogël. Po më intereson me ditë ku banojnë këta, ku jetojnë, ku janë për momentin, a jeni marrë me këta?

Islam Elshani: Unë edhe më herët gjatë prezantimit e ceka që të huajtë që janë nën mbrojtjen ndërkombëtare, domethënë vetëm me ato persona domethënë njësia e punëve të brendshme edhe departamenti për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve mirret, kurse ne jemi dëshmitarë si qytetarë të Komunës së Prizrenit se kemi shumë persona të cilët frekuentojnë në Komunën tonë, edhe që janë edhe lëmosh kërkues, po me atë kategori ne vërtetë nuk miremi, do të thotë mirremi vetëm me ato persona të cilët Ministria e Punëve të Brendshme i trajton si persona nën mbrojtjen ndërkombëtare. Ne nuk mirremi kjo është çështje që ndoshta me i shtru pyetje policisë apo apo dikujt tjetër.

Simir Krasniqi (Kryesues): Diskutues të tjerë nuk ka. Atëherë, sa jemi prezent? 21 jemi prezent. Kemi kourumin e nevojshëm. Kush është për? Unanimisht pra me 21 për miratohet pika e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikat e radhës, pikën e shtatë.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e rregullores së punës së kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Qëllimi pra i kësaj rregullore është që rregullorja e vjetër e punës së kuvendit pra 2016-ën dhe ka disa udhëzime të reja që ndërkohë disa janë shfuqizuar disa janë në fuqi që duhet të caktohet një grup punues, që të ndërhyjmë aty ku është e nevojshme. Si grup punues ne kemi paraparë që të jetë ky grupi punues. Unë pra kryesuesi i kuvendit, një anëtar nga Partia Demokratike, një anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje, një anëtar nga LDK-ja, një anëtar nga Bashkimi Demokratik për Prizrenin, do të thotë të gjitha këto që i ceka, merren propozimet pra këtu mungojnë por edhe kemi një përfaqësues nga komuniteti boshnjak dhe një përfaqësues nga komuniteti turk kurse nga sektori i kuvendit është Arbër Krasniqi si anëtar, Naim Kukaj nga zyra ligjore e Komunës anëtar dhe Haziz Krasniqi nga njësia për komunikim me publikun anëtar. Këta do të jenë përbërja e anëtarëve të grupit punues për rregulloren e punës së kuvendit. Unë do t'i marr propozimet nga partitë politike pra. Që keni diçka me shtuar rreth rregullores dhe grupit punues, e hapim diskutimin. Që nuk kemi, atëherë i marr propozimet. Pra, së pari shkojmë me Partinë Demokratike të Kosovës.

Ymrane Fusha (PDK): Nga Partia Demokratike e Kosovës e propozojmë Arianit Berishën.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Pra nga Partia Demokratike, nga grupi parlamentar, propozohet Arianit Berisha. Nga Lëvizja Vetëvendosje pra nuk janë prezent këtu, por nga këta do ta kërkoj me shkrim emrin ose anëtarin e tyre të propozuar në grupin punues. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës?

Qemal Krasniqi (LDK): LDK propozon Haziz Hodaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pra nga Lidhja Demokratike do të jetë Haziz Hodaj, anëtar i grupit punues. Po ashtu nga Bashkimi Demokratik nuk janë prezent në sallë. Do ta kërkojmë edhe këtu emrin e tyre që të na përcjellin pranë përmes email adresave të tyre. Nga një përfaqësues nga komuniteti boshnjak.

Dzengis Saliji (SDU): Eldis Abazi

Simir Krasniqi (Kryesues): Eldi Abazi. Nga komuniteti turk.

Sevilay Igci Hapçi: Onur Kovaçi

Simir Krasniqi (Kryesues): Kjo është përbërja pra, nga Partia Demokratike është Arianit Berisha, nga Lëvizja Vetëvendosje thashë do ta kërkojmë me shkrim të na sjellin emrin e tyre, nga Lidhja Demokratike është zoti Haziz Hodaj, nga Bashkimi Demokratik gjithashtu edhe këtu do ta kërkojmë që të na përcjellin me shkrim, një përfaqësues nga komuniteti boshnjak Eldis Abazi dhe një nga komuniteti turk Onur Kovaçi, e thashë Arbër Krasniqi nga sektori i kuvendit anëtar, Naim Kukaj nga zyra ligjore e komunës anëtar, Haziz Krasniqi nga njësia për komunikim me publikun. Atëherë konstatojmë se në sallë jemi? 22 anëtarë të kuvendit, kemi korumin. Sa jemi për që këta anëtarë të jenë pjesë e grupit punues për rregulloren e punës së kuvendit? Unanimisht pra me 22 vota për, miratohet pika e rendit të ditë formimi i grupit punues për hartimin e rregullores së punës së kuvendit.

Kalojmë te pikat e pika e radhës.

Informatë mbi gjendjen e barazisë gjinore dhe realizimin e objektivave të strategjisë komunale për Barazi Gjinore 2024–2026 në Komunën e Prizrenit;

Simir Krasniqi (Kryesues): E kemi iniciuesin e pikës dhe mund ta bëj prezantimin.

Emine Krasniqi: Përshëndetje. I nderuar kryesues i kuvendit, të nderuar anëtarë dhe anëtare të kuvendit komunal, të nderuar pjesëmarrës, sot para jush paraqes informatën mbi gjendjen e barazisë gjinore dhe realizimin e objektivave të strategjisë Komunale për barazi gjinore 2024-2026 në Komunën e Prizrenit. Duke monitoruar zbatimin e strategjisë Komunale dhe planit të veprimit për barazi gjinore, si dhe duke u bazuar në gjetjet e monitorimit të realizuar nga organizata Fol dhe publikimet e gazetës komunale Barazia në Fokus e paraqes këtë informatë lidhur me gjendjen aktuale të barazisë gjinore në Komunën e Prizrenit. Strategjia synon avancimin e pozitës së grave dhe vajzave në jetën publike, ekonomike dhe sociale. Komuna ka bërë progres në krijimin e mekanizmave institucional dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në dokumente strategjike dhe ka sfida në zbatimin praktik të objektivave, sidomos në buxhetimin gjinor dhe monitorimin sistematik. Është rritur përfaqësimi i grave në kuvendin komunal, por jo mjaftueshëm në pozita udhëheqëse dhe ekzekutive. Gratë vazhdojnë të kenë pjesëmarrje më të ulët në tregun e punës dhe në mundësitë ekonomike. Janë realizuar iniciativa pozitive për fuqizimin ekonomik të grave përmes trajnimeve, subvencioneve dhe vetëpunësimit. Në arsim janë organizuar aktivitete sensibilizuese për barazi gjinore dhe kundër dhunës. Stereotipet tradicionale dhe mentaliteti patriarkal vazhdojnë të ndikojnë negativisht në pjesëmarrje të grave. Komuna e Prizrenit ka treguar gatishmëri të vazhdueshme për promovimin e barazisë gjinore dhe për fuqizimin e grave. Kaq, ka pyetje dikush?

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. E hapim debatin. Ka pyetje dikush? Faleminderit për prezantimin. Atëherë kalojmë me propozimin e pikën e nëntë pra që ishte propozimin nga shefi i grupit parlamentar të PDK-së, Arianit Berisha.

Pika e nëntë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-52028 i datës 30 prill 2026, për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026

Simir Krasniqi (Kryesues): Këtu e kemi zyrtarin kryesor financiar, mund ta sqaron detaje në qoftë se është e nevojshme. Le të del ta bën një përshkrim të shkurtër. Fjala për ju.

Lulzim Sylejmani: Faleminderit kryesues, përshëndetje kuvendarë, ekzekutiv, media, të gjithë të pranishëm. Siç e dini me 30 prill ne kemi marrë një vendim për bartjen e të hyrave të pashpenzuara të vitit 2025 në vitin 2026, po ndërkohë me datën 28 prill jemi njoftuar nga Ministria e Financave që ka qenë një kthim i një ekzekutimi të vitit të kaluar dhe ai kthim ka rezultuar të jenë të hyra nga shëndetësia. Sipas ligjit nenit 21, domethënë të hyrat duhet të rikthehen në pozicionin ku janë krijuar këtë rast domethënë shëndetësisë edhe arsimit, ne nuk mundem me ja marr të hyrat për me i shpenzu në drejtori të tjera, ato që janë kryer si participim i qytetarëve për shërbime. Faktikisht ne duhet ta respektojmë ligjin numër 03/L-049 të financat pushtetit lokal, nenin 21. Dhe në këtë rast, domethënë, jemi detyruar që nenin 3 të vendimit ekzistues ta ndryshojmë në dy pozicione në mallra, në Drejtorinë e Financave dhe në Drejtorinë e Tatimit të Pronave t'i zvogëlojmë dhe vlerën prej 53.320.37 të bartet në mallra në shëndetësi, aty edhe ku janë krijuar të hyrat. Kjo ka qenë ajo që neve na ka detyruar që ta bëjmë plotësim, ta biem si propozim plotësim ndryshimin e vendimit të datës 30 prill, për me mund që ato mjete të shpenzohen aty ku janë krijuar faktikisht në drejtorinë e shëndetësisë. Kaq.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Lulzim. A kemi ndonjë pyetje? Atëherë që nuk kemi pyetje të tjera, konstatojmë se në sallë jemi? 22 anëtarë të kuvendit. Kemi korumin e nevojshëm. Sa jemi për? 22 për. Pra kjo pikë kalon unanimisht, pra miratohet unanimisht dhe këtu e mbyllim seancën, shihemi në seancat e radhës. Ju faleminderit për pjesëmarrjen.

**Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi**

Mbledhja përfundoi në ora: 14:00



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 320/26 Dt. 15.07.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 58 pika h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 18 të Ligjit Nr.04/L-097 për Bibliotekat, nenit 7 paragrafi 6 dhe nenit 8 paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-245 për Artin dhe Kulturën dhe nenit 50 shkronja I, të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15 tetor 2008, i propozoj Kuvendit të Komunës së Prizrenit miratimin e këtij:

VENDIM PËR EMËRTIMIN E BIBLIOTEKËS KOMUNALE TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë vendim biblioteka komunale (e qytetit) me seli në Prizren emërtohet me emrin biblioteka “Zahadin Shemsidini”.

Neni 2

Biblioteka është institucion në shërbimin publik, në kuadër të Komunës së Prizrenit dhe veprimtaria e saj dhe organizimi i brendshëm do të bëhet konformë akteve ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.

Neni 3

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe organet tjera relevante që të i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryetari i Komunës

Shaqir Totaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi i Komunës së Prizrenit

Nr. 001-011-

Më: __ korrik 2026

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1 dhe 2 pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 14 të Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 12/2014 Për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësit dhe Funksonimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe të Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit si dhe nenit 27 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më __ korrik 2026, miratoi këtë:

PROPOZIM-VENDIM
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË
QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Neni 1

Anëtarë të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit emërohen:

Nga Shoqëria Civile:

1. Veron Tara,
2. Elmedina Shkurti Haxhifazliu,
3. Gjeni Krasniqi,

Nga Bashkësitë Fetare:

1. Dr. Orhan Bislímaj, nga Bashkësia Islame;
2. Lorenc Shala, nga Kisha Katolike;
3. Svetlana Hadžić, nga Kisha Ortodokse Serbe;

Nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim:

1. Islam Elshani.

Neni 2

Këshilli zgjedh Kryesuesin e Këshillit nga radhët e anëtarëve të tij. Kryesuesi zgjidhet me votim të fshehtë nga shumica e anëtarëve të Këshillit.

Neni 3

Anëtarët e emëruar sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohen për mandat tre (3) vjeçar. Në rast të dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit, zëvendësimi bëhet në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 4

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit përcaktohen me Ligjin Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 12/2014 dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



**Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Skupština opštine Prizren

Br. 001-011-

Dana: __ jula 2026

Na osnovu člana 12 stav 1 i 2 tačka d) Zakona br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, člana 14 Zakona br. 04/L-066 o Istorijskom centru Prizrena, odredbi Administrativnog Uputstva Ministarstva zaštite životne sredine i prostornog planiranja br. 12/2014 o osnivanju, izboru, odgovornostima i funkcionisanju Saveta za kulturno nasleđe Prizrena i Kancelarije za istorijski centar Prizrena, kao i člana 27 stav 1 Statuta opštine Prizren, Skupština opštine Prizren, na sjednici održanoj __ jula 2026 godine, odobrila je ovu:

**PREDLOG-ODLUKU
ZA IMENOVANJE ČLANOVA SAVETA ZA KULTURNO
NASLEĐE ISTORIJSKOG CENTRA PRIZRENA**

Član 1

Imenuju se članovi Saveta za kulturno nasleđe Istorijskog centra Prizrena:

Iz civilnog društva:

1. Veron Tara,
2. Elmedina Shkurti Haxhifazliu,
3. Gjeni Krasniqi

Iz vjerskih zajednica:

1. Dr. Orhan Bislimaj, iz Islamske zajednice;
2. Lorenc Shala, iz Katoličke crkve;
3. Svetlana Hadžić, iz Srpske pravoslavne crkve;

Iz Opštinske Kancelarije za Zajednice i Povratak:

1. Islam Elshani.

Član 2

Savet bira predsjedavajućeg Saveta iz redova svojih članova. Predsjedavajući se bira tajnim glasanjem većinom glasova članova Saveta.

Član 3

Članovi imenovani u skladu s članom 1 ove odluke imenuju se na mandat od tri (3) godine. U slučaju ostavke ili razrješenja člana, zamjena će se izvršiti u skladu s važećim zakonom.

Član 4

Dužnosti, ovlaštenja i odgovornosti Saveta utvrđene su Zakonom br. 04/L-066 o historijskom centru Prizrena, Administrativnim Uputstvom MAPP br. 12/2014 i drugim važećim zakonskim i podzakonskim aktima.

Član 5

Ova odluka stupa na snagu nakon što bude dostavljena nadzornom organu, u smislu člana 8 u vezi sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 za Administrativno Razmatranje Opštinskih Akata i sedam (7) dana nakon objavljivanja na službenoj web stranici opštine.

Predsedavajući Skupštine
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Prizren Belediye Meclisi
No: 001-011-
Tarih: ____ Temmuz 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kosova Cumhuriyeti Yerel Özyönetim Hakkında 03/L-040 sayılı Kanun'un 12. maddesinin 1. ve 2. fıkrası (d) bendi, Prizren Tarihi Merkezi Hakkında 04/L-066 sayılı Kanun'un 14. maddesi, Prizren Kültürel Miras Konseyi ile Prizren Tarihi Merkez Ofisinin Kurulması, Seçilmesi, Görevleri ve İşleyişi Hakkında ÇŞPB İdari Talimatı No. 12/2014 hükümleri ile Prizren Belediyesi Statüsü'nün 27. maddesinin 1. fıkrası uyarınca, Prizren Belediye Meclisi, ____ Temmuz 2026 tarihinde yapılan toplantısında aşağıdaki kararı kabul etmiştir:

PRİZREN TARİHİ MERKEZİ KÜLTÜREL MİRAS KONSEYİ ÜYELERİNİN ATANMASI HAKKINDA ÖNERİ KARAR

Madde 1

Prizren Tarihi Merkezi Kültürel Miras Konseyi üyeleri aşağıdaki şekilde atanmıştır:

Sivil Toplum Temsilcileri:

1. Veron Tara,
2. Elmedina Shkurti Haxhifazliu,
3. Gjeni Krasniqi.

Dini Topluluk Temsilcileri:

1. Kosova İslam Birliği adına Dr. Orhan Bislimaj,
2. Katolik Kilisesi adına Lorenc Shala,
3. Sırp Ortodoks Kilisesi adına Svetlana Hadžić.

Belediye Topluluklar ve Geri Dönüş Ofisi Temsilcisi:

1. İslam Elshani.

Madde 2

Konsey, Başkanını kendi üyeleri arasından seçer. Başkan, Konsey üyelerinin çoğunluğunun gizli oyu ile seçilir.

Madde 3

Bu kararın 1. maddesi uyarınca atanan üyeler üç (3) yıllık bir görev süresi için atanırlar. Üyenin istifa etmesi veya görevden alınması halinde, yerine yeni üyenin atanması yürürlükteki mevzuata uygun olarak yapılır.

Madde 4

Konseyin görev, yetki ve sorumlulukları, Prizren Tarihi Merkezi Hakkında 04/L-066 sayılı Kanun, ÇŞPB İdari Talimatı No. 12/2014 ile yürürlükte bulunan diğer yasal ve ikincil mevzuat hükümleriyle belirlenir.


Madde 5

Bu karar, Belediye İşlemlerinin İdari İncelenmesi Hakkında 08/L-284 sayılı Kanun'un 8. maddesi ile bağlantılı olarak 9. maddesi uyarınca denetim makamına gönderildikten sonra ve belediyenin resmî internet sayfasında yayımlanmasını takip eden yedi (7) günün sonunda yürürlüğe girer.

Belediye Meclisi Başkanı
Simir Krasniqi

RAPORT PËRMbledhës

Mbi ecurinë e përzgjedhjes së Anëtarëve të
Këshillit për Trashëgimi Kulturor të
Qendrës Historike të Prizrenit



Komisioni *Ad-Hoc* për Përzgjedhjen e
Anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturor
të Qendrës Historike të Prizrenit

PËRMBATJA

Hyrja	3
Ecuria e Procesit	4
Komisioni AdHoc, për për zgjedhjen e Anëtarëve të KTKQHP	4
Vlerësimi Teknik	5
Vlerësimi me Shkrim	6
Vlerësimi me Gojë	7
Rezultatet e Procesit të Përzgjedhjes – tre (3) me më së shumti poena	8
PËRFUNDIM	9
Lista e plotë - për emërimin e Anëtarëve të KTKQHP	9

RAPORT PËRMBLEDHËS

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit

I. HYRJE

Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, qëllimi i të cilit është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë, të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar, udhëzon për themelimin e një mekanizmi këshillëdhënës të quajtur “Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit”.

Roli i Këshillit është të vëzhgojë dhe këshillojë rreth aktiviteteve në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë së saj kulturore.

Ky këshill duhet të themelohet nga Komuna e Prizrenit dhe përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

- tre (3) anëtarë nga shoqëria civile
- një (1) anëtar përzgjidhet nga Bashkësia Islame;
- një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Ortodokse Serbe dhe
- një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Katolike;
- anëtari i shtatë do të jetë përfaqësues i Zyrës Komunale përgjegjëse për Komunitete dhe Kthim.

Anëtarët e Këshillit emërohen prej Kuvendit të Komunës për periudhë (tri) 3 vjeçare, përmes procedurës e cila përfshin ftesë publike duke i përcaktuar kushtet për konkurrim dhe anëtarësim. Asambleja Komunale emëron anëtarët e Këshillit të përzgjedhur nga Kisha Katolike, Bashkësia Islame dhe nga Kisha Ortodokse Serbe për këtë mandat.

¹ KTKQHP -Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit

II. ECURIA E PROCESIT

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të cilat derivojnë nga Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Udhëzimi Administrativ MMPH – Nr. 12/2014 për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funksionimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe të Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit me 26 shkurt 2026, merr vendim për themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe iniciimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të tij, ku në kuadër të atij vendimi është vendosur që të bëhet thirrja publike dhe janë përcaktuar kriteret për konkurrim dhe anëtarësim në KTKQHP.

Komisioni AdHoc, për përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit.

Më datën 30 prill 2026 Kuvendi i Komunës së Prizrenit merr vendim për formimin dhe caktimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, i cili përbëhej prej 5 anëtarëve: dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës dhe tre (3) anëtarë nga shoqëria civile. Nga Kuvendi i Komunës ishin Dea Gavazaj dhe Onur Kovaçi. Ndërsa nga shoqëria civile ishin Valon Xhabali, Fatmir Menekshe dhe Katarina Kajtazi.

Më datën 11 qershor 2026 nga Kryesuesi i Kuvendit është thirrur mbledhja konstituive e komisionit ad hoc, ku në rend dite ishte konstituimi i komisionit dhe zgjedhja e kryesuesit të komisionit ad-hoc. Në këtë takim ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit ad-hoc. Me vota unanime kryesues i komisionit u zgjodh z.Valon Xhabali. Në të njejtën takim Kryesuesi i Kuvendit njoftoi se do të bëhet publikimi i ftesës publike dhe për ftesën publike do të njoftohen të gjitha Bashkësitë Fetare, Kryetari i Komunës dhe Zyra Komunale përgjegjëse për Komunitete dhe Kthim. Ftesa ishte e hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes, përkatësisht deri më 26 qershor 2026 dhe aplikimet e kandidatëve do të pranoheshin në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit.

Komisioni ad-hoc kishte për detyrë të bënte zgjedhjen e kandidatëve që kanë konkurruar për anëtar të Këshillit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së skadimit të afatit për aplikim. Për zbatimin e vendimit do të kujdeseshin anëtarët e Komisionit *ad-hoc* dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Detyrat e komisionit ad-hoc, sipas vendimit të Kuvendit ishin: të verifikojë a është bërë aplikimi nga kandidatët brenda afatit kohor; të verifikojë a i plotësojnë kandidatet kriteret e selektimit; të bëjë intervistimin e kandidatëve si dhe të ushtrojë detyrat e tjera të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ MMPH - Nr. 12/2014; të dërgoj listën e zgjedhur të kandidatëve për votim në Kuvendin Komunal.

○ Vlerësimi teknik:

Më datën 26 dhe 29 qershor 2026, Komisioni ad-hoc trajtoi dosjen e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët, në raport me kriteret e kërkuara sipas ftesës publike.

Procesi: Në këtë fazë vlerësimi, gjithësejt njëmbëdhjetë (11) aplikacione ishin dorëzuar brenda afatit kohor (shtatë (7) shoqëria civile, tre (3) bashkësitë fetare dhe një (1) zyra komunale për komunitete dhe kthim). Pas procedurës së vlerësimit teknik, është konstatuar se nga shoqëria civile: gjashtë (6) aplikacione i kanë përmbushur kriteret e ftesës publike duke u kualifikuar në fazën e dytë vlerësuese, ndërsa një (1) aplikant kishte dosje të pa kompletuar. Në këtë fazë nga Komisioni ad-hoc është vendosur edhe 02 korrik 2026 data e mbajtjes së testit me shkrim dhe është kërkuar nga zyra e kryesuesit që të bëhet njoftimi tek të gjithë kandidatët që i kanë përmbushur kriteret si dhe të dërgohet njoftimi për kandidatin që nuk ka kaluar në fazën tjetër.

Nga tre (3) bashkësitë fetare dhe zyra komunale për komunitete dhe kthim në këtë fazë kanë përcjellur vetëm letër delegimin e të përzgjedhurve. Nga Komisioni ad-hoc sipas legjislacionit në fuqi, iu është kërkuar edhe dokumentacioni përcjellës i kërkuar në thirrje publike për të konstatuar se a i plotësojnë kriteret e selektimit të përzgjedhurit e tyre *(të përzgjedhurit e tyre nuk i nënshtrohen testit me shkrim dhe intervistës)*. Të gjitha dokumentacionet e sipas thirrjes publike janë dërguar dhe komisioni ka konstatuar se të përzgjedhurit e tyre i plotësojnë kriteret.

○ Vlerësimin me shkrim:

Niveli i vlersimit me shkrim, trajtoi njohuritë paraprake të aplikantëve në raport me ambientin ligjor, dhe zhvillimet rreth Qendrës Historike të Prizrenit.

Për këtë qëllim është hartuar një pyetësor me dhjetë (10) pyetje, dy (2) të formës së hapur, dhe tetë (8) me opzione. Secili nga anëtarët e Komisionit ad-hoc do të propozonte nga dy (2) pyetje, propozimet e të cilëve do të silleshin një orë para mbajtjes së vlerësimit me shkrim, dhe do të vendoseshin në pyetësor. Vendosja e pyetjeve në pyetësor u aprovua unanimisht nga të gjithë anëtarët e Komisionit AdHoc. Secila nga pyetjet e pyetësorit do të përcillej me notë pikësimi deri në dhjetë (10) poena. Testi me shkrim u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe filloi në ora 15:00. Koha në dispozicion e aplikantëve për plotësimin e pyetësorit ishte gjashtëdhjetë (60) minuta. Të gjithë anëtarët e ftuar gjashtë (6) iu nënshtruan testin me shkrim. Nga komisioni ad-hoc u mor vendim që vlerësimi i testit me shkrim të bëhet menjëherë pas përfundimit të testit nga kandidatët. Pas përfundimit të vlerësimit, komisioni ka dorëzuar dokumentacionin tek zyra e kryesuesit dhe ka kërkuar që të njoftohen të gjithë kandidatët me rezultatin e arritur në këtë fazë si dhe njëkohësisht të njoftohen për mbajtjen e intervistës me gojë për datën 07 korrik 2026.

○ Vlerësimin me gojë:

Niveli i vlerësimit me gojë kishte për qëllim që të identifikonte njohuritë e përgjithshme të aplikantëve në raport me trashëgiminë kulturore, dhe kreativitetin për tu përballur me sfidat e menaxhimit të proceseve për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë, të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Secili nga anëtarët e Këshillit ad-hoc do të propozonte nga një (1) pyetje, propozimet e të cilëve do të silleshin një orë para mbajtjes së vlerësimit me gojë. Vendosja dhe koordinimi rreth pyetjeve dhe poentimi u aprovua unanimisht nga të gjithë anëtarët e Komisionit ad-hoc. Intervistimi me gojë u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe filloi nga ora 11:00 deri më 14:00.

Koha në dispozicion e aplikantëve për tu përgjigjur ishte tridhjetë (30) minuta.

Procesi: Në këtë fazë finale të vlerësimit nga gjashtë (6) aplikant sa ishin gjithsej, tre (3) nga ta u kualifikuan për tu përzgjedhur Anëtarë të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, për një mandat tre (3) vjeçar. Përzgjedhja u realizua duke i mbledhur pikët e aplikantëve nga të dyja fazat e vlerësimit; me shkrim dhe me gojë, dhe të njetat më pas të pjestuara për dy (2). Nga Komisioni ad-hoc u vendos që kandidatët të njoftohet veçmas për pikët e tyre të totalit të të 2 vlerësimeve si dhe të njoftohen për listen finale të të përzgjedhurve nga të dyja fazat. Pas përfundimit të vlerësimeve dhe punimeve, dokumentacioni u dorëzua në zyrën e kryesuesit.

III. REZULTATET E PROCESIT TË PËRZGJEDHJES

Anëtarët e komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit, bazuar në rezultatet e dala nga procesi i ftesës publike për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturor të Prizrenit, rekomandon si në vijim:

Titulli i pozitës: Anëtarë i Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit.

Numri i përzgjedhjes në bazë të arritjes më të larta të pikëve: **tre (3)**

